



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1523/8 prot

Datë 16.10.2023

V E N D I M

Nr. 1050/2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 16.10.2023 me

Objekt: “Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Egian Med” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-66562-04-19-2023, me objekt: Loti 5 “*Shërbim Dezinsektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Qarku Fier*”, me fond limit 21.673.080 lekë (pa Tvsh), zhvilluar në datë 13.06.2023 nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.

Ankimues: Operatori ekonomik “NRG” SHPK me NIPT (L13426006B), me adresë: Rruga “Eduart Mano”, Pallatet Nr.10, Kopshti Zoologjik, Selitë, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nd.1, 1001, Tiranë

Subjekte të Interesuara: “Egian Med” SHPK me NIPT (L71715003C), me adresë: Njësia Bashkiake Nr.7, Rruga e Kavajës, Godina “Condor Centre”, Kati 4, Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e*

rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 20.04.2023 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-66562-04-19-2023, me objekt: Loti 5 “Shërbim Dezinsektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Qarku Fier”, me fond limit 21.673.080 lekë (pa Tvsh), zhvilluar në datë 13.06.2023 nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.

II.2. Në datën 13.06.2023 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 20.06.2023, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Kastriot Likaj” SHPK	12.609.600	skualifikuar
2. “Egian Med” SHPK	17.317.200	kualifikuar
3. “NRG” SHPK	20.556.000	kualifikuar
4. “Air” SHPK	21.084.000	kualifikuar

II.4. Në datën 27.06.2023, në Sistemin e Prokurimit Elektronik është publikuar Njoftimi i Fituesit Paraprak të procedurës së prokurimit.

II.5. Në datën 03.07.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është paraqitur ankesa me nr. 1523 prot., datë 03.07.2023 e operatorit ekonomik “NRG”, i cili kundërshton kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Egian Med” SHPK. Konkretisht operatori ekonomik ankimues në ankesën e tij pretendon:

“Kërkesat e vecanta për kualifikim, janë të detyrueshme për tu përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

Një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai i barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

Specialistët e ISHP që hartuan specifikimet teknike sipas V.K.M. nr. 933 datë 25.11.2020 E. R dhe Z.S qëllimisht nuk e kishin përcaktuar shtamin e produktit bti në dokumentat e tenderit madje nuk kishin vendosur asnjë kriter kualifikimi teknik për produktin. Themë qëllimisht pasi vetëm në këtë mënyrë do të favorizonin duke marrën guximin të kualifikonin OE Egian Med shpk edhe pse produkti i tij është i pavleshëm pasi nuk është në listën e përbërësve aktivë të miratuar në Republikën e Shqipërisë. Jo më kot është E.R që përgatit specifikimet teknike të tenderit dhe merr pjesë gjithashtu në grupin që lëshon Autorizim importi. Të dy këta punonjës të ISHP-së në bashkëpunim me njëri-tjetrin kanë shpërdoruar detyrën duke ndihmuar OE Egian Med shpk të regjistrojë produktet Aquabac dhe për këto veprime shoqëria jonë do të kërkojë përgjegjësi penale pranë institucioneve kompetente. Shembull i shpërdorimit të detyrës dhe favorizimit të OE Egian Med shpk është edhe demaskimi publik që u bëri emisioni investigativ Stop në TV Klan këtyre dy punonjësve (emisioni i datës 27.06.2023).

Por të dy këta punonjës harruan se në fletoren zyrtare nr. 210 të datës 02.12.2020 është botuar VKM nr. 933 datë 25.11.2020 “Për përcaktimin e rregullave për kriteret e vlerësimit të produkteve biocide dhe të procedurës së dhënies së autorizimit të vendosjes së tyre në treg” ku përcaktohen rregulla për të cilat një product biocid mund të regjistrohet në territorin e Republikës së Shqipërisë. Pjesë e këtij V.K.M është edhe Shtojca V “Lista e lëndëve Vepruese të Miratuara” pra lista e lëndëve vepruese që përmban produkti biocid, referuar bazës së të dhënave të ECHA-s (bashkëlidhur ankesës).

Në këto kushte kemi arsye të forta të mendojmë që Egian Med SHPK ka përdorur si dokumentacion për produktin bti në këtë procedurë prokurimi Autorizimin e importit dhe jo Certifikatën e regjistrimit në një nga vendet që parashikon ligji i biocideve. Vetëm në këtë mënyrë ai mbulon më së miripaligjshmërinë dhe mos plotësimin e specifikimeve teknike të produkteve Aquabac.

OE “Egian Med” SHPK ka regjistruar ose produktin e kompanisë amerikane Becker Microbial Products ose atë të kompanisë franceze Cera. Për këtë analiza si më poshtë:

*Rasti i parë: Regjistrimi është bërë duke paraqitur dokumentacionin amerikan të regjistrimit në EPA (Agjencia Amerikane e Mbrojtjes së Mjedisit). Në këtë rast, duke analizuar regjistrimin e pranishëm në EPA dhe duke kontrolluar dokumentet e regjistrimit dhe etiketën, është shumë e qartë se shtami i produktit Aquabac është BMP 144. Basliküngjitur janë kopjet e regjistrimit të EPA. Nëse ky është rasti me të cilin është marrë regjistrimi, procedura është e paligjshme dhe duhet mbajtur menjëherë qëndrim ligjor ndaj personave përgjegjës me qëllim mbrojtjen e ligjit shqiptar. **Ligji flet shumë qartë dhe është lehtësisht e dallueshme që Bacillus Thuringensis Israeliensis BMP 144 nuk figuron në listën e përbërësve aktivë të regjistruar në Republikën e Shqipërisë si PT18 (Lloji i produktit).** Autorizimi i importit i lëshuar në këtë rast është i pavlefshëm dhe do të ishte një shkelje shumë e rëndë e ligjeve shqiptare, duke regjistruar kështu një produkt dhe duke lëshuar lejen e importit në mënyrë të paligjshme. Ligji nr. 95/2015 “Pëi shërbimet dhe produktet biocide në shëndetin publik” parashikon sanksione si tërheqjen nga tregu të produktit dhe kthimin e tij tek furnizuesi i huaj.*

*Ekuivalenca e shtamit të Bacillus Thuringensis Israeliensis AM65-52 nuk është e vlefshme me BMP 144, pasi EPA (Agjencia e Mbrojtjes së Mjedisit) në SHBA si përgjegjëse për regjistrimin/miratimin e biocideve, ka pasqyruar në të gjitha dokumentet e miratuara dhe publikuara nga vet ajo të tilla si: Çertifikatat e regjistrimit (që zoterohen nga kompania amerikane Becker Microbial Products), etiketat, skedat e sigurisë, skedat teknike, dokumentacioni tekniko-shkencor flasin qartë se shtami BMP144 i Aquabac I Bacillus Thuringensis Israeliensis njihet si një shtam i ndryshëm nga çdo lloj tjetër. Ky diversitet del qartë dhe njihet edhe nga OBSH, e cila shprehet se **dy Shtamet BMP144 dhe AM65-52 janë të ndryshëm dhe nuk pranohet asnjë lloj ekuivalence.** Pra, nëse procedura e lëshimit të Autorizimit të importit nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është bërë në bazë të Çertifikatës së regjistrimit të lëshuar nga EPA në SHBA të produkteve Aquabac, duhet të anulohet urgjentisht dhe duhet të vazhdojmë të kuptojmë se kush e ka lejuar këtë shkelje Ligji, pasi **Bacillus Thuringensis Israeliensis BMP144 nuk figuron në listën e përbërësve aktivë të***

regjistruara në Republikën e Shqipërisë si PT18 (Lloji i produktit) dhe nuk mund të konsiderohet ekuivalencë përderisa SHBA nuk pranon.

Akoma më keq është nëse regjistrimi amerikane I Aquabac **përzihet qëllimisht** me ato evropiane të Aquabac (regjistrim që zotërohet nga kompania franceze CERA) për të shfrytëzuar ekuivalencën të cilën e konsideron vetëm ECHA (Agjensia Europiane e Kimikateve) dhe që është një ekuivalencë e limituar që pasqyrohet në të meta të rëndësishme në efikasitetin e produkteve të regjistruar nga CERA. Nga ana shkencore dhe ligjore kjo nuk është e pranueshme se po flasim për një regjistrim në SHBA që me të drejtë nuk njeh dhe nuk pranon ekuivalencën, dhe konsideron mjedisin dhe tippet e larvave të mushkonjave në SHBA dhe që për më shumë nuk është në listën e lëndëve biocide të miratuara në Shqipëri.

Për ta shpjeguar më mirë nga ana shkencore sjellim shembullin e Covid-19 ku të gjithë kemi qënë dëshmitarë sesa në vitet e fundit të pandemisë nga një shtam fillestar mikroorganizmi kemi kaluar në variacione të ndryshëm, me diferencë sinjifikante me zona të ndryshme të botës. Në fakt, koncepti se pse OBSH e konsideron çdo shtam jo ekuivalent dhe përcakton një numër specifik për secilin, e tregon qartë shembulli i mëposhtëm:

Le ta mendojmë "shtamin" si diçka e "natyrës" kundrejt "ushqimit". Megjithëse të gjithë jemi Homo Sapiens, historia jonë njerëzore dhe mjedisi diktuan ndryshimet që shohim midis njerëzve. Nuk është vetëm gjenetika, por mjedisi në të cilin gjenetika vepron dhe rritet (për shembull prodhues të ndryshëm microbial / larvicide). Në fakt, edhe kur materiali gjenetik është identik (si në rastin e binjakëve identikë), nëse njëri binjak rritet në Çikago dhe tjetri në Shqipëri, ata do të jenë dy njeirëz shumë të ndryshëm pavarësisht se ndajnë të njëjtin kod gjenetik. E njëjta gjë vlen edhe për mikroorganizmat. Autoritetet rregullatore anembanë botës (duke përfshirë Organizatën Botërore të Shëndetësisë) e njohin këtë fakt biologjik dhe pët këtë arsye përcaktojnë numra "mjedisor" (numurin e shtamit) për secilin prodhues microbial.

Rasti i dytë: Kur për lëshimin e Autorizimit të importit përdoret regjistrimi i kompanisë Cera, certifikatat e regjistrimit dhe gjithë dokumentacioni që e shoqëron, sqarojmë edhe njëherë se Aquabac Bacillus Thuringensis Israeliensis BMP144 nuk është i listuar në listën e përbërësve aktivë të regjistruar në Republikën e Shqipërisë si PT18 (Lloji i Produktit). Në dosjen ECHA të produkteve biocide të markës Aquabac (Aquabac 3000 DF dhe Aquabac 200 G dhe Aquabac XT), bazuar në Bacillus Thuringensis Israeleinsis (Bti) si PT18 (lloji i produktit 18 në ECHA), është raportuar disa herë në emrin e shtamit "Bti BMP 144" referuar gjithmonë produkteve Aquabac.

Sjellim në vëmendjen tuaj se regjistrimi fillestarë i vitit 2016 produkteve të kompanisë franceze Cera është çregjistruar në ECHA dhe Republikën e Shqipërisë në bazë të vendimit të Gjykatës së Apelit të Francës me kërkesë të kompanisë Sumitomo Chemical Agro Europe SAS për të cilën kompania jonë është distributor ekskluzivë në Shqipëri.

Sumitomo Chemical Agro Europe SAS deklararon se në bazë të njohurive shkencore që zotëron, se shtami AM65-52 për të cilin kjo kompani zotëron të drejtën industrial dhe regjistrimin, është I ndryshëm nga shtami BMP 144 në pronësi të kompanisë Cera.

EPA (Agjencia Amerikane e Mbrojtjes së Mjedisit) e SH.B.A nuk e konsideron ekuivalente Shtamet e Bt1: BMP144 dhe AM65-52 dhe kjo është arsyeja që tregon pse numrat e shtameve duhet të specifikohen në etiketat për produktet mikrobiale/larvicide.

Për të mbrojtur pronësinë industrial të shtamit AM65-52 kundër deklarimeve të rreme apo dëmtimin e imazhit të këtij produkti kompania Sumitomo ka ndërmarrë dhe do të ndërmarrë të gjitha hapat e duhura të tilla si proceset gjyqësore dhe kërkesën për dëmshpërblim.

Sumitomo Chemical Agro Europe SAS ka ndërmarrë tashmë hapat ligjore për të mbrojtur pronësinë e saj industriale në Gjykatë dhe siç edhe deklaroi rezervon të drejtën e ligjshme të kërkojë dëmshpërblimin autoriteteve Europiane dhe Shqiptare.

Nëse do të donim ta shpërfillnim këtë fakt dhe të konsideronim konceptin e ekuivalencës, në bazë të dosjeve të regjistrimit (ju lutem gjeni bashkëlidhjen ankesës me pjesët e theksuara të nënvizuara) të biocideve me bazë Bti nën markën Aquabac ato flasin qartë.

"Raporti I vlerësimit të një produkti biocid për aplikimin e ndryshimeve madhore" përmbajn të gjitha testet, provat në terren, testet laboratorike në lidhje me aspekte të shumta të produktit, dhe padyshim fokusohen në:

1. Efektivitetin
2. Organizmat e synuara dhe rrjedhimisht llojet e mushkonjave për të cilat është autorizuar
3. Dozat e përdorimit
4. Kohëzgjatja e aktivitetit në luftimin e mushkonjave/larvave

Duke marrë në konsideratë atë që ka regjistruar ECHA, e cila është themelore dhe bazë për lëshimin e Autorizimit të Importit shqiptar sipas Ligjit nr. 95/2015 "Për shërbimet dhe produktet biocide në shëndetin publik" dhe V.K.M. nr. 933 datë 25.11.2020 "Për përcaktimin e rregullave për kriteret e vlerësimit të produkteve biocide dhe të procedurës së dhënies së autorizimit të vendosjes së tyre në treg", mund të themi se të gjitha autorizimet në ECHA tregojnë se produktet e markës Aquabac të kompania CERA (Aquabac 3000 DF, aquabac 200 G, Aquabac XT), nuk plotësojnë kërkesat teknike të produktit të nevojshëm për luftën larvicide në Shqipëri dhe qartësisht të kërkuara në "Specifikimet Teknike" të tenderit në fjalë.

Në fakt, duke lexuar tërësisht dosjen e regjistrimit në ECHA dhe përmbledhjen relative të karakteristikave teknike (SPC) dhe etiketën e autorizuar, është e qartë se produktet e markës Aquabac nuk janë autorizuar (për shkak të mungesës së testeve të efikasitetit) në kontrollin e gjinisë së mushkonjave Anophele, pra gjinisë bartëse të plazmodiumit të malarisë, për

luftimin e të cilave filloi piojekti në 2013, si dhe gjinisë së pranishme në shumë zona bregdetare të Shqipërisë.

Gjinia Anopheles dhe kontrolli I tyre janë pjesa më e rëndësishme e DST, e saktësuar mirë në specifikimet teknike të tenderit”, ku listohen llojet e larvave për tu kontrolluar në të gjitha zonat bregdetare të vendit (inspektimi I nevojshëm në çdo grup).

Thjesht duam tju kujtojmë rrezikun e gjinisë Anopheles, duke marrë të dhëna nga faqja e internetit e OBSH-së që thotë se në vitin 2021 janë diagnostikuar 240 milionë raste në mbarë botën, me 620,000 vdekje dhe prej tyre rreth 450,000 fëmijë nën moshën 5 vjeç.

Për më tepër ka edhe dy informacione të tjera të rëndësishme në dosje dhe etiketë që ngrenë dy çështje themelore:

Dozat e përdorimit, për të marrë të njëjtin rezultat dozimi i produkteve të markës Aquabac janë 6 deri në 8 herë më të mëdha në varësi të formulimit sesa ato të produktit konkurrent Vectobac.

Duke lënë mënjanë koston e rritur, mbi të gjitha duhet llogaritur ndikimi në mjedis, edhe kjo është një temë për tu marrë seriozisht pasi flitet për tu përdorur tonelata më shumë product për të patur të njëjtin rezultat (përfshijë efektivitetin në anofele), tonelata që do të lëshohen në natyrë, me ndikimin e tyre negative. Për çdo 1 ton Vectobac ËG do të duhet të përdoret 8 ton Aquabac 3000 DF.

Kohëzgjatja e efikasitetit: Testet e kryera pas pesë, shtatë dhe pesëmbëdhjetë ditësh në ujërat me nivele të larta të lëndëve organike, (të tilla si ujërat e lagunave dhe kënetave shqiptare), nuk tregojnë një kohëzgjatje të efikasitetit (aktivitetit luftues).

Sa më sipër oferta e këtij OE duhet të skualifikohet pasi produkti Bacillus Thuringensis Israeliensis H14 BMP144 (I ofertuar nga OE Egian Med shpk):

- nuk renditet në listë e produktet të lëjuara për regjistrim dhe importin në Shqipëri.
- Nuk plotëson kërkesat e specifikimeve teknike të tenderit, sepse nuk kontrollon gjininë më të rrezikshme të mushkonjave në botë, anopheles, të cilat janë arsyeja e këtij projekti, ka dozim të rritur që shkakton ndotje të ambientit, dhe nuk plotëson specifikimet teknike për kohëzgjatjen e aktivitetit luftues.

Për sa parashtruar kërkojmë të vihet në dispozicion dosja e aplikimit në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale për pajisjen e operatorit Egian Med Shpk me autorizim importi për lëndët biocide. Kështu do të tregohet qartësisht se në rastin më të mirë kemi të bëjmë me paligjshmëri në lëshimin e këtij autorizimi dhe në rastin më të keq mosplotësimi I specifikimeve teknike, rreziku për të dalë nga tregu si product Aquabac e mosrealizim të kontratës dhe për më shumë kërkesa e dëmshpërblimit ndaj autoriteteve shqiptare të dëmshpërblimit ndaj autoriteteve shqiptare të dëmshpërblimit nga një kompani multinacionale si Sumitomo.

Për çdo paqartësi kërkojmë gjithashtu zhvillimin e një takimi ballafaques midis përfaqësuesve të shoqërisë tonë dhe specialistëve të fushës.

Në dokumentat e tenderit është kërkuar:

Shënim: Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike-financiare (nënpika 1 e seksionit 2.2 të kriterëve të veçanta për kualifikim0 si dhe kapacitetet teknike (nënpika 1) të kriterëve të veçanta për kualifikim), sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku. Në këtë rast, operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të paraqesë një deklaratë ku të listohen dokumentet e paraqitura në përmbushje të kriterëve kumulative për Lotin konkret. Në rast se dokumentacioni I deklaruar dhe I dorëzuar në përmbushje të kriterëve kumulative nuk plotëson kapacitetet ekonomik-financiare dhe kapacitetet teknike për të gjitha lotet ku operatori ekonomik ka ofertuar, do të kualifikohet vetëm në atë lot ku oferta e tij është ekonomikisht më e favorshme.

Nga klasifikimi I ofertave rezulton se OE “Egian Med” SHPK ka marrë pjesë në procedurën e prokurimit me:

- Nr. REF-66559-04-19-2023, me objekt Loti 4- me objekt “Shërbim Dezinsektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Qarku Durrës”, me fond limit 15.479.671 lekë pa TVSH.
- Nr. ReF- 66562-04-19-2023, me objekt Loti 5 – me objekt: “Shërbim Dezinsektimi zonat bregdetare dhe urbane, Qarku Fier”, me fond limit 21.673.080 lekë pa TVSH.
- Nr. REF-66564-04-19-2023, me objekt Loti 6- me objekt: “Shërbim Dezinsektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Qarku Vlorë”, me fond limit 46.165.933 lekë pa TVSH.

Duke qënë se ky OE ka ofertuar në më shumë se një lot duhet të paraqiste në ofertë një deklaratë ku të listoheshin dokumentet e paraqitura në përmbushje të kriterëve kumulative për lotin konkret, deklaratë e cila është paraqitur nga ky OE në secilin lot ku ka ofertuar.

Në dokumentat e tenderit parashikohet se “Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim”.

Sa më sipër oferta e këtij OE duhet të skualifikohet për mospërmbushjen e këtij kriteri kualifikimi.

Në dokumentat e tenderit është kërkuar:

1.Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 39 % e vlerës së fondit limit të këtij loti. Këto shërbime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë;

- Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimet e lëshuara nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara.
- Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen data, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara.

Vlera e fondit limit të 3 loteve ku ka ofertuar ky OE është 80.318.684 lekë pa TVSh. Bazuar në kriterin e mësipërm të kualifikimit ky OE duhet të paraqiste dëshmi për shërbime të mëparshme të ngjashme në vlerën jo më pak se 31 324 286.76 lekë pa TVSH.

Ky OE ka dështuar në plotësimin e këtij kriteri kualifikimi pasi nuk ka paraqitur dëshmi për shërbime të ngjashme në vlerën minimale prej 31 324 286.76 lekë pa TVSH.

Provë e qartë që vërteton pretendimet tona është refuzimi I ofertës së këtij OE të paraqitur në Lotin 4 – me objekt: “Shërbim dezinfektimi në zonat bregdetar dhe urbane, Qarku Durrës”.

Sa më sipër oferta e këtij operatori ekonomik duhet të skualifikohet për mospërmbushjen e këtij kriteri kualifikimi.

Në dokumentat e tenderit është kërkuar:

1.Operatori ekonomik për kryerjen e shërbimit, objekt prokurimi duhet të ketë të punësuar staf si më poshtë:

a) 1 (një) drejtues Teknik, për drejtuesin Teknik të paraqitet:

- kontratë punë përkatëse

-Diplomë me profil agronom/shëndet publik/biologji/kimi.

b) Minimalisht 4 (katër) punonjës, për punonjësin të paraqitet:

- kontratë pune përkatëse

Numri I punonjësve për lotin objektin ankimimi është 4 (katër).

Por ky OE ashtu sikurse e theksuam edhe më sipër ka marrë pjesë ne lotin me:

- Nr. Ref-66559-04-19-2023, me objekt Loti 4- me objekt: “Shërbim dezinfektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Qarku Durrës”, me fond limit 15.479.671 lekë pa TVSH ku kërkohen 2 (dy) punonjës shërbimi.*
- Nr. REF-66562-04-19-2023, me objekt Loti 5- me objekt: “Shërbim dezinfektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Qarku Fier”, me fond limit 21.673.080 lekë pa TVSH ku kërkohen 2 (dy) punonjës shërbimi.*

Pra kriteri kumulativ është që ky OE duhet të ketë minimum 8 (tetë) punonjës shërbimi. Duke qënë se si kriter kualifikimi është kërkuar staf për kryerjen e shërbimit, operatorët ekonomikë kishin detyrimin të paraqisnin kontratat e punës në mënyrë kumulative për aq punonjës sa kërkoheshin për lotet ki kishin ofertuar por edhe dokumentet provues (listëpagesat e muajit të fundit me kodin përkatës për punonjës shërbimi DDD ose dëshmi përkatëse për Teknik DDD).

Nuk mund të quhet e vlefshme vetëm kontrata e punës me një punonjës kur nuk provohet se ai është punonjës shërbimi DDD.

Në objektin e veprimtarisë së tij OE “Egian Med” shpk ka disa aktivitete të tjera përveç shërbimit DDD por kjo nuk do të thotë që të kualifikohet duke paraqitur kontrata fictive punonjësish që nuk kanë të bëjnë me shërbimin – objekt prokurimi.

Ajo që provon se këta punonjës janë vërtetë punonjës shërbimi DDD e vërteton ose dëshmia/certifikata e specializimit si Teknik DDD ose listëpagesa e muajit të fundit me kodin korrespondues të punonjësit të shërbimit Teknik DDD.

Ky OE ka dështuar në paraqitjen e dokumentacionit provues për disponimin e 8 (tetë) punonjësve shërbimi të pajisur me certifikatë DDD ose të siguruar në listëpagesën e muajit të fundi me kodin përkatës si Teknik shërbimi DDD.

Sa më sipër oferta e këtij OE duhet të skualifikohet për mospërmbushjen e këtij kriteri kualifikimi.

Si përfundim kërkojmë refuzimin e ofertës së OE “Egian Med” shpk si ofertë që nuk plotëson të gjitha kriteret e kualifikimit dhe specifikimet teknike të dokumentave të tenderit.

II.5.1. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 1523/2 prot., datë 04.07.2023, duke publikuar kriteret për të cilat operatori ekonomik ankimues “NRG” SHPK, pretendon se nuk përmbushen nga operatorët ekonomikë “Egian Med” SHPK, pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

II.5.2. Në datën 10.07.2023, protokolluar pranë KPP me nr.1523/3 prot., operatori ekonomik “Egian - Med” SHPK, si operator ekonomik i interesuar në këtë procedurë prokurimi, ka dorëzuar argumente në përputhje me parashikimet në nenin 113 të LPP-së.

II.5.3. Me anë të shkresës nr.927/2 prot., datë 11.07.2023, protokolluar me tonën me nr.1523/4 prot., datë 14.07.2023, me objekt “Vënie në dijeni mbi zgjatjen e afatit për shqyrtimin e ankesës”, duke informuar se “[...] Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara ju vë në dijeni se nisur nga nevoja për një verifikime lidhur me pretendimet e ngritura në ankesën e protokolluar me tonën me nr. Prot. 926, datë 03.07.2023, e regjistruar në KPP me nr. Protokolli 1523/2023, datë 03.07.2023, nga operatori ekonomik “NRG” SHPK; ankesës protokolluar me tonën me nr. Prot. 927, datë 03.07.2023, e regjistruar në KPP me nr. 1524/2023, datë 03.07.2023, për vlerësimin e procedurës së prokurimit, “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar-Shërbime”, me objekt “Shërbim dezinfektimi” me nr. REF-66549-04-19-2023, ka ndërprerë afatin për shqyrtimin e ankesave [...]”.

II.5.4. Me anë të shkresës nr. 1523/5 prot., datë 24.08.2023 me objekt “Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni KPP-së lidhur me ankesat e paraqitura për

procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-66549-04-19-2023, me objekt: “Shërbim Dezinsektimi” ndarë në 6 (gjashtë) Lote”, me fond limit 120.278.204 lekë (pa tvsh), parashikuar për tu zhvilluar në datë 22.05.2023 nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara”, Komisioni i Prokurimit Publik, i është drejtuar autoritetit kontraktor duke kërkuar informacion në lidhje me procedurat e prokurimit, konkretisht:

“[...]Pranë Komisionit të Prokurimit Publik janë administruar ankesa për 5 nga 6 lotet e procedurës së prokurimit “Shërbim Dezinsektimi”, konkretisht:

- Për Lotin 1 “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF- 66552-04-19-2023, me objekt: Loti 1 “Shërbim Dezinsektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Qarku Shkodër”, me fond limit 8.717.160 lekë (pa TVSh), zhvilluar në datë 13.06.2023 nga autoriteti kontraktor, kanë paraqitur ankesë operatorët ekonomik “NRG” SHPK dhe “Euromed” SHPK.
- Për Lotin 2 “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-66555-04-19-2023, me objekt: Loti 2 “Shërbim Dezinsektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Qarku Lezhë”, me fond limit 9.903.240 lekë (pa TVSh), zhvilluar në datë 13.06.2023 nga autoriteti kontraktor, kanë paraqitur ankesë operatorët ekonomik “NRG” SHPK, “Pastrime Silvio” SHPK dhe “Euromed” ShPK.
- Për Lotin 4 “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF- 66559-04-19-2023, me objekt: Loti 4 “Shërbim Dezinsektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Qarku Durrës”, me fond limit 15.479.671 lekë (pa TVSh), zhvilluar në datë 13.06.2023 nga autoriteti kontraktor, kanë paraqitur ankesë operatorët ekonomik “NRG” SHPK dhe bashkimi i operatorëve ekonomikë “Egian Med” SHPK & “Vlera” SHPK.
- Për Lotin 5 “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-66562-04-19-2023, me objekt: Loti 5 “Shërbim Dezinsektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Qarku Fier”, me fond limit 21.673.080 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 13.06.2023 nga autoriteti kontraktor, ka paraqitur ankesë operatori ekonomik “NRG” SHPK.
- Për Lotin 6 “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-66564-04-19-2023, me objekt: Loti 6 “Shërbim Dezinsektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Qarku Vlorë”, me fond limit 43.165.933 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 13.06.2023 nga autoriteti kontraktor, kanë paraqitur ankesë operatorët ekonomikë “NRG” ShPK dhe “AIR” ShPK.

Në përputhje me parashikimet e nenit 112 pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” me marrjen e ankesave janë publikuar në bazën e të dhënave të KPP-së, për secilën ankesë, informacionet e më poshtme: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës). Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar edhe Formularin për Publikim, për secilën nga ankesat në lidhje me:

- arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;
- pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.

Komisioni i Prokurimit Publik është vënë në dijeni nga autoriteti kontraktor Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara, me shkresat e mëposhtme:

Me shkresën nr. 927/2 protokollin datë 11.07.2023, administruar pranë KPP me nr. 1523/4 protokollin datë 14.07.2023 se autoriteti kontraktor ka ndërprerë afatin e shqyrtimit të ankesave për lotet:

Loti 5 “Shërbim Dezinsektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Qarku Fier”.

Loti 6 “Shërbim Dezinsektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Qarku Vlorë”.

Me shkresën nr. 948/3 datë 13.07.2023 administruar pranë KPP me nr. 1580/4 protokollin datë 19.07.2023 se autoriteti kontraktor ka ndërprerë afatin e shqyrtimit të ankesave për lotet:

Loti 1 “Shërbim Dezinsektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Qarku Shkodër”;

Loti 2 “Shërbim Dezinsektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Qarku Lezhë”;

Loti 4 “Shërbim Dezinsektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Qarku Durrës”;

Me shkresën nr. 925/5 protokollin datë 13.07.2023, administruar pranë KPP me nr. 1524/6 protokollin datë 19.07.2023 me objekt “Dërgim dokumentacioni për procedurën e prokurimit me objekt: Loti 6 “Shërbim Dezinsektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Qarku Vlorë”, ku ndër të tjera, bashkëlidhur gjendet “Vendimi mbi shqyrtimin e ankesës së ankimesit “NRG” SHPK”, nr.925/2 prot., datë 11.07.2023, ku konstatohet se ankesa e këtij të fundit është refuzuar.

Me shkresën nr. 965/1 protokollin datë 17.07.2023, administruar pranë KPP me nr. 1610/3 protokollin datë 20.7.2023, se autoriteti kontraktor ka ndërprerë afatin e shqyrtimit të ankesave për lotet:

Loti 1 “Shërbim Dezinsektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Qarku Shkodër”

Loti 2 “Shërbim Dezinsektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Qarku Lezhë”

Loti 4 “Shërbim Dezinsektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Qarku Durrës”

Me shkresën nr. 965/5 protokollin datë 24.07.2023, administruar pranë KPP me nr. 1610/4 protokollin datë 27.07.2023 me objekt “Dërgim dokumentacioni për procedurën e prokurimit me objekt: Loti 4 “Shërbim Dezinsektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Qarku Durrës”, ku ndër të tjera, bashkëlidhur gjendet “Vendimi mbi shqyrtimin e ankesës së ankimesit “Egian Med” SHPK”, nr.965/3 prot., datë 21.07.2023, ku konstatohet se ankesa e këtij të fundit është refuzuar.

Në neni 114 pika 2 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” parashikohet se: “Në rastin kur për shqyrtimin e ankesës autoriteti ose enti kontraktor ka nevojë të kryejë verifikime pranë organeve të tjera, afati i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni ndërpritet dhe rifillon pasi të ketë siguruar informacionin e kërkuar. Në çdo rast, për pritjen e informacionit të kërkuar afati nuk duhet të tejkalojë 30 ditë.”

Autoriteti kontraktor ka ndërprerë afatin e shqyrtimit të ankesave (sipas shkresave të mësipërme) lidhur me nevojën për kryerjen e verifikimeve për shqyrtimin e tyre.

Në datën 16.08.2023 dhe datën 17.08.2023, përmes komunikimit elektronik, në adresën Kpp_info@kpp.gov.al, ka mbërritur nga autoriteti kontraktor, informacion në lidhje me trajtimin e ankesave të operatorëve ekonomikë ankimes për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF- 66549-04-19-2023, me objekt: “Shërbim Dezinsektimi” ndarë në 6 (gjashtë) Lote”, ku ndër të tjera citohet “[...] Dokumentacioni i sipër cituar, është dërguar pranë autoritetit tuaj, në rrugë shkresore, me shkresën nr. 927/9 date 16.08.2023. Bashkëlidhur attach do të gjeni Vendimet e sipër cituara”. Referuar nenit 114 “Trajtimi i ankesës nga autoriteti kontraktor ose enti kontraktor” të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “Në rastet e ankesave

për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet për ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit kohor në dispozicion të operatorëve ekonomikë të interesuar, sipas parashikimeve në nenin 113 të këtij ligji, për paraqitjen e argumenteve të tyre.

3. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës sipas parashikimeve në këtë nen, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë: a) pranimin e plotë të ankesës; b) pranimin e pjesshëm të ankesës; c) refuzimin e ankesës. 4. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.

Aktualisht, nga ana e autoritetit kontraktor ende nuk është dërguar në rrugë shkresore apo nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, informacioni në lidhje me procedurën e prokurimit për lotet e ankimuar, aktet e trajtimit të ankesave të operatorëve ekonomikë ankimues, si dhe verifikimet e kryera nga autoritetit kontraktor.

Sa më sipër, me qëllim shqyrtimin e ankesave të operatorëve ekonomikë ankimues, së pari, kërkojmë nga ana juaj të paraqisni të gjithë informacionin e hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit, për të gjitha lotet e ankimuar, ku të pasqyrohet procesi i shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave të paraqitura në këtë procedurë prokurimi, aktet e trajtimit të ankesave të operatorëve ekonomikë ankimues, si dhe të gjitha verifikimet e kryera nga institucioni juaj për shqyrtimin e ankesave.

Së dyti, në zbatim të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” si dhe Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon të nevojshëm të kërkojë nga ana juaj paraqitjen e informacionit, se cilët nga subjektet e interesuar, kanë dorëzuar argumente pranë autoritetit tuaj kontraktor për këtë procedurë prokurimi, për secilin lot, në përputhje me nenin 113 të Ligjit për Prokurimin Publik. A janë njoftuar këto subjekte të interesuar, në lidhje me aktet e trajtimit të ankesave të operatorëve ekonomikë ankimues, nëse janë prekur nga kjo vendimmarrje?

Nëse po, lutemi na vini në dispozicion dokumentacionin provues lidhur me njoftimin nga ana juaj të operatorëve ekonomikë të interesuar mbi aktet e trajtimit të ankesave të operatorëve ekonomikë ankimues.

Sa më sipër, me qëllim vijimin e gjyqimit të ankesave pranë KPP-së në përputhje me nenin 114 të LPP-së, autoriteti kontraktor të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e kësaj shkrese, të gjithë informacionin e kërkuar si më sipër.”

II.5.5. Me anë të shkresës Nr.926/2 prot., datë 16.08.2023, protokolluar me tonën me nr. 1523/6 prot., datë 29.08.2023, autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik “Vendim mbi shqyrtimin e ankesës së ankimuesit “NRG” SHPK”, ku konstatohet, se ankesa e këtij të fundit është refuzuar. Gjithashtu, bashkëlidhur autoriteti kontraktor ka paraqitur dokumentacion në lidhje me procedurën e prokurimit.

II.6. Me anë të shkresës nr.1523/7 prot., datë 30.08.2023 me objekt “Vënie dijeni”, KPP njofton operatorët ekonomikë pjesëmarrës si dhe autoritetin kontraktor, si më poshtë:

“Lidhur me procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-66562-04-19-2023, me objekt: Loti 5 “Shërbim Dezinsektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Qarku Fier”, me fond limit 21.673.080 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 13.06.2023 nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara, Komisioni i Prokurimit Publik, referuar nenit 115, pika 5 e ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku përcaktohet se: “5. Në rastin kur për shqyrtimin e ankesës Komisioni i Prokurimit Publik ka nevojë të kërkojë ekspertizë nga palë të treta ose të kryejë verifikime pranë organeve të tjera, afati i përcaktuar në pikën 4 të këtij neni ndërpritet dhe rifillon pasi të ketë siguruar informacionin e kërkuar. Afati për marrjen e vendimit nuk duhet të tejkalojë 30 ditë. Në çdo rast Komisioni i Prokurimit Publik ka detyrimin të vërë në dijeni palët”, ju bën të ditur të gjitha palëve të mësipërme, se për shkaqe të nevojshme për verifikim, në përputhje me dispozitën e sipërcituar, nuk është e mundur dalja me një vendim përfundimtar brenda afatit të parashikuar në ligjin e prokurimit publik.”

II.7. Me anë të shkresës nr. 714/1 prot., datë 25.07.2023, protokolluar pranë KPP-së me nr.1610/7 prot., datë 28.07.2023, Instituti i Shëndetit Publik na vendos në dijeni se: “[...] Sqarojmë se z.R nuk është pjesë përbërëse e Komisionit për Autorizimin e Produkteve Biocide. Bazuar ne VKM nr.933, datë 25.11.2020, Instituti I Shëndetit Publik nuk ka të drejtë vendimmarrje për dhënie e Autorizimeve të Produkteve Biocide, por I jep mendim MSHMS në bazë të një vlerësimi që kryhet nga specialistet përkatës për çdo produukt biocid. Ky mendim më pas shqyrtohet nga Komisioni për Autorizimin e Produkteve Biocide në MSHMS. Z. E.R nuk kryen vlerësimin e PB insecticide (PT 18) në kuadër të procedurës së autorizimit të produkteve biocide. Në lidhje me specifikimet teknike për këtë procedurë, nuk ka patur kërkesa për sqarime apo ankimime lidhur me këto specifikime pas publikimit të procedurës. Në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt Shërbim dezinfektimi në zonat bregdetare dhe urbane, të kryer nga Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara, Z. Rnuk është pjesë e Komisionit të Vlerësimit të Ofertavr për këtë procedurë.”

II.8. Me anë të shkresës nr.53 prot., datë 11.07.2023 me objekt “Mbi regjistrimin e kudraligjshëm të produktit Aquabac me dokumente të falsifikuara të EPA amerikane”, protokolluar pranë KPP-së me nr.1665 prot., datë 12.07.2023, operatori ekonomik “NRG” SHPK, i është drejtuar KPP-së, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Agjencisë Shtetërore të Prokurimeve të Përqendruara, Institutit të Shëndetit Publik, Ambasadës së SHBA-së në Shqipëri, Ambasadës Italiane në Shqipëri, ku ndër të tjera pretendon: “[...] Në vazhdim duam të bëjmë prezent një fakt shqetësues në lidhje me regjistrimin e produktit Aquabac nga ana e shoqërisë “Egian Med” SHPK. Kërkesa për regjistrimin e këtij produkti pranë MSHMS-së nga ana e shoqërisë “Egian Med” SHPK është paraqitur në bazë të regjistrimit amerikan, të prodhuesit Becker – SHBA, me dokumente nga EPA (Agjencia e Mbrojtjes së Mjedisit), ku saktësohet qartë se bëhet fjalë për shtamin Bacillus Thuringensis Israeliensis H14 BMP 144. Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës cdo produkt mikrobial ose bakterial i përdour si produkt biologjik insekticid konsiderohet unik dhe për këtë arsye caktohet një numër shtami dhe nuk ka ekuivalenca. Bacili Thuringensis H14 BMP144 nuk është në listën e produkteve të MSHMS-së

dhe nuk mund të kërkohet as regjistrimi dhe as ekuivalenca e tij. (Bashkëlidhur shkresës është Certifikat EPA e Aquabac 200g, por e njëjta gjë është edhe për Aquabac df3000. Certifikata EPA ka bashkëngjitur etiketën e miratuar, si dhe SPC (specimen) origjinale që Egianmed shpk e ka përdorur si etiketë duke falsifikuar ekuivalencën). Shoqëria “Egian Med” SHPK ka paraqitur në dosjen e regjistrimit të këtij produkti pranë MSHMS-së etiketën amerikane që shoqëron Certifikatën, e përkthyer në shqip, por të falsifikuar. Konkretisht është shtuar fjalia “teknikisht ekuivalent me shtamin AM65-52”, (Bashkëlidhur shkresës është etiketa e sajuar e paraqitur nga “Egian Med” SHPK. Falsifikimi është i qartë pasi:

- Siç sqaruar më sipër EPA nuk e njeh ekuivalencën e produkteve biocide;
- Në SPC origjinale e përdorur si etiketë kjo fjali nuk ekziston;
- Vetëm duke shtuar këtë fjali mund të justifikonte regjistrimin e këtij produkti.

Por kjo nuk do të realizohej pa ndihmën e disa zyrtarëve të papërgjegjshëm të cilët me paramendim dhe qëllimisht kanë regjistruar në mënyrë kundraligjshme produktin Aquabac. Njëri nga këta punonjës është E.R punonjës i Institutit të Shëndetit Publik i cili për ne është personi kryesor përgjegjës për këtë mashtrim (është personi përgjegjës për mos-haitimin e specifikanieve të duhura teknike si dhe personi që programi investigativ “STOP” e nxorri përgjegjësin kryesor të situatës së krijuar, program i cili na mundësoi dokumentacionin e falsifiloiar të regjistrimit të produkteve Aquabac).

Ky person shikon detajet më të vogla kur bëhet fjalë për shoqëinë tonë duke na kthyer autorizimet e importit për të korrigjuar vetëm një fjalë ndërkohë që tek rasti i “Egian Med” shpk nuk ka kryer qëllimisht verifikimet duke lëshuar një autorizim të paligjshëm me shkelje ligjore administrative dhe penale.

Sjellim në vëmendjen tuaj se me këtë regjistrim operatori ekonomik “Egian Med” shpk ka paraqitur ofertë dhe është kualifikuar për prokurimin e shërbimit të dezinfektimit të bregdetit pra pretendon të fitojë kontrata publike dhe thuajse ja arriti qëllimit pasi Komisioni i Vlerësimit të Ofertave e ka kualifikuar dokumentacionin e këtij operatori edhe pse këto probleme i kemi parashikuar ligjërisht përpara shumë kohësh por pa menduar që mund të përdoreslin dokumenta të falsifikuar.

E.R, vetëm ose në bashkepunim me persona të tjerë, ka pranuar dokumentet e falsifikuara të EPA amerikane edhe pse bëhet fjalë për dokumenta të publikuara dhe që gjithsecili mund të ketë akses lehtësisht. Këtë e ka bërë që Egian med mund të rregjistronte produktin duke patur avantazhet e etiketës amerikane, që është studiuar për një kontinent tjetër jo Europa.

Duke vepruar kështu, ata kanë marë 9fcarë u duhet nga regjistrimi i EPA, theksojmë edhe njëherë duke paraqitur dokumente të prodhuesit Becker, d.m.th. regjistrim në EPA, ku legalisht nuk mund njihet ekuivalenca midis Bacillus Thuringensis Israeliensis H14 BMP144 dhe Bacillus Thuringensis Israeliensis H14 AM65-52.

Konfirmojmë dhe deklarojmë se EPA e cila është përgjegjëse për regjistrimin e biocidëve në SHBA në të gjitha dokumentet e depozituara pranë saj dhe të publikuara si etiketat, skedat e të dhënave të sigurisë, dokumentacioni tekniko-shkencor, flitet gjithmonë për produktet Aquabac 200 G, Aquabac DF 3000 të Bacillus Thuringensis Israeliensis H14 BMP144, shtami i të cilit nuk është i pranishëm në listën e miratuar shqiptare dhe që njihet nga legjislacioni amerikane si një “shtam” i ndryshëm nga AM65-52. Ju lutem gjeni bashkangjitur Regjistri Federal i SHBA-së në lidhje me Kërkesat e të Dhënave për Pesticidet Biokimike dhe Mikrobiale (Federal Register / Vol. 72, No. 207 / Friday, October 26, 2007 / Rules and Regulations) Ky është një

dokument voluminoz me kërkesa shumë të forta ku theksohet se "Cdo izolim i ri i një pesticidi mikrobial trajtohet si një shtam i ri dhe duhet të regjistrohet në mënyrë të pavarur nga çdo lloj shtami i ngjashëm i pesticidit mikrobial të regjistruar dhe i mbështetur nga të dhënat e kërkuara në këtë nënpjesë".

Ky ndryshim i qartë njihet edhe nga O.B.SH., e cila ka pranuar se dy shtamet (BMP144 dhe AM65-52) janë të ndryshem dhe jo ekuivalent.

ECHA vetëm për arsye të mos përsëritjes së testeve të toksicitetit mbi kafshët dhe mjedisin ka dhënë një ekuivalencë për të dy shtamet (ekuivalencë për të cilën ka process gjyqësore në zhvillim nga Sumitomo mbajtësi i pronësisë industriale të shtamit AM65-52). ECHA ka konsideruar ekuivalencen vetëm për toksicitetin por për efikasitetin kërkoi të gjitha provat e efikasitetit të Aquabac të cilat rezultuan me probleme. Mbajtësi i rregjistrimit në Evropë është kompania franceze CERA dhe jo Becker, ligjërisht duhet ta kishte lëshuar CERA autorizimin e prodhuesit për t'u regjistruar në Shqipëri me dokumentacionin ECHA. Vet ECHA e ka të rregjistruar Aquabac me shtamin e Sumitomo AM65-52 pasi shtami BP 144 nuk është në listën e ECHA (po ashtu të Shqipërisë)

<https://echa.europa.eu/it/informayion-on-chemicals/biocidal-products/-/disbp/factsheet/FR-0008703-0000/authorisationid>

Ndërkohë Autorizimi shqiptar i importit për Aquabac është lëshuar me shtamin BP 144 i cili nuk është në listen e inëratuar. Një mënyrë e rafinuar e përdorimit të shkencës për të shkelur ligjin.

Pra me dokumentacionin e CERA të rregjistruar në ECHA për produktet Aquabac 200g dhe df3000, do të binte menjëherë në sy se produktet nuk janë të përshtatshme dhe nuk plotesojnë DST e tenderit kundër mushkonjave në Shqipëri për disa arsye:

1) nuk lufton gjininë e mushkonjave Anopheles, te cilat mbartin malarien dhe janë të pranishme ne territorin shqiptar (shumë e qartë në dosjen e regjistrimit të depozituar në ECHA dhe në etiketë)

2) nuk ka rezultuar të jetë efektiv në dozat e treguara në regjistrimin amerikan, por nevojitet deri në 8 herë më shumë produkt duke ndikuar negativisht në mjedis (shumë e qartë në dosjen e regjistrimit të depozituar në ECHA dhe në etiketë)

3) nuk ka qëndrueshmërinë prej 15 ditësh siç kërkohet në specifikimet tekniketë dokumentave të tenderit (shumë e qartë në dosjen e regjistrimit të depozituar në ECHA).

Pra opetatori ekonomik që e ka rregjistruar në bashkëpunim me disa punonjës të administratës shtetërore ka marrë regjistrimin duke përdorur dokumentet Becker sepse ato favorizojnë dozat dhe larvat e mushkonjave që ajo lufton (duke deklaruar një ekuivalencë të paligjshme për BMP144).

Duke qënë se MSHMS ka rregjistruar produktet Aquabac 200G dhe Aquabac DF3000 me dokumentacion dhe regjistrim të këtij produkti në SHBA, me një letër autorizimi nga kompania Becker, në të cilën janë dorëzuar dokumenta të falsifikuara nga ana e "Egian Med" shpk, kërkojmë:

- anulimin e menjëhershëm të regjistrimit të këtyre produkteve

- përgjegjësinë administrative dhe penale të shoqërisë "Egian Med" shpk si dhe të punonjësve të administratës shtetërore që kanë mundësuar regjistrimin e këtyre produkteve (E.R dhe bashkëpunëtorët e tij).

II.9. Me anë të shkresës nr.59 prot., datë 09.08.2023 me objekt “Sqarime mbi shkresën e studios së avokatit të shoqërisë CERA”, protokolluar pranë KPP-së me nr.1982 prot., datë 10.08.2023, operatori ekonomik “NRG” SHPK, i është drejtuar KPP-së, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Agjencisë Shtetërore të Prokurimeve të Përqendruara, Institutit të Shëndetit Publik, Ambasadës së SHBA-së në Shqipëri, Ambasadës Italiane në Shqipëri, si dhe Dhomës Amerikane të Tregtisë në Shqipëri, ku ndër të tjera pretendon:

“[...] Aspekti i parë ka të bëjë me mënyrën e paisjes me Autorizim importi për një produkt biocid në Shqipëri Ligji nr. 95/2015 “Për shërbimet dhe produktet biocide në shëndetin publik” dhe VKM Nr. 933 datë 25.11.2020 “Për përcaktimin e rregullave për kriteret e vlerësimit të produkteve biocide dhe të procedurës së dhënies së autorizimit të vendosjes së tyre në treg” përcaktojnë rregullat e qarta sipas të cilave një produkt biocid mund të regjistrohet në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Konkretisht përcaktojnë që Autorizimi për vendosjen në treg të produkteve biocide lëshohet për:

1) Produktet biocide të prodhuara në Shqipëri

2) Produkte biocide të autorizuara në një nga vendet e Bashkimit Evropian, në Zvicër, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Kanada, Japoni, Tuiqi, Izrael dhe Australi.

Ndërsa VKM nr. 933 datë 25.11.2020 “Për përcaktimin e rregullave për kriteret e vlerësimit të produkteve biocide dhe të procedurës së dhënies së autorizimit të vendosjes së tyre në treg” liston përbërësit aktivë të pranuar për regjistrim në Shqipëri, (e cila çuditërisht është bashkangjitur edhe nga avokati i kompanisë Cera).

“Egian Med” shpk ka paraqitur pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale aplikimin për regjistrim në Shqipëri të produkteve biocide Aquabac duke dorëzuar dosjen dhe dokumentacionin e regjistrimit amerikan në EPA (Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit) mbajtës i të cilës është kompania Becker Micorbial Products.

Dokumentet e paraqitura janë:

- Autorizim prodhuesi*
- Certifikata e regjistrimit në EPA e vitit 2021 (?)*
- Etiketa e produktit, MSDS,*

Dokumentat që ne disponojmë tregojnë shumë qartë se regjistrimi i përdorur për tu pajisur me Autorizim importi është i kompanisë Becker-SHBA dhe nuk ka lidhje me regjistrimin e kompanisë franceze CERA edhe pse kjo përmendet si distributor në BE (kjo është përpjekja e parë e “Egian Med” Shpk për të krijuar konfuzion).

Duke analizuar dokumentat zyrtare të regjistrimit Aquabac të publikuara nga EPA si certifikata e regjistrimit me etiketën e aprovuar, është shumë e qartë shtami i produkteve Aquabac është BMP 144 (ku BMP do të thotë Becker Microbial Products).

Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës çdo produkt mikrobial ose bakterial i përdorur si produkt biologjik insekticid konsiderohet unik dhe për këtë arsye caktohet një numër shtami dhe ekuivalenca nuk egziston, me fjalë të tjera ekuivalenca është jo ligjore në SHBA. Bacillus Thuringensis Isrcielinesi.s H14 BMP 144 nuk është në “listën e lëndëve aktive biocide” të miratuara për lëshimin e Autorizimit të Importit në Shqipëri sipas VKM nr. 933 datë 25.11.2020 “Për përcaktimin e rregullave për kriteret e vlerësimit të produkteve biocide dhe të procedurës së dhënies së autorizimit të vendosjes së tyre në treg”. Dhe për ta bërë ligjore këtë

aplikim për autorizim importi “Egian Med” shpk apo kushdoqofte ka bërë fallsifikimin e dokumentave të miratuara dhe të publikuara nga EPA.

Pse letra e avokatit nuk na tregon (qëllimisht) pjesën e poshtme të etiketës së përdorur, e cila tregon qartë numurin e rregjistrimit në EPA të kompanisë Becker? “Egian Med” shpk me eksperiencë të madhe në fallsifikime, krijon tymnajë dhe shkakton konfuzion, ai ka vendosur në dispozicion të avokatit vetëm gjysmën e faqes së etiketës ku shfaqet formulimi i shtuar/fallsifikuar “teknikisht ekuivalent me shtamin AM65-52”, gjë e cila përben fallsifikim të dokumentave të miratuara të EPA amerikane. Sic e kemi theksuar më së shumti ky pohim është i rremë për EPA dhe për dokumentet amerikane të paraqitura. Qëllimisht ai tenton të përfshijë CERA dhe ECHA (të cilat nuk kanë asnjë lidhje me dokumentacionin EPA të cilat janë përdorur për të kërkuar rregjistrimin shqipëtarë).

Theksojmë se të gjitha dokumentet e paraqitura janë dokumente të regjistrimit të EPA amerikane, ku nuk është e ligjshme të deklarohet ekuivalenca me Bacillus Thuringensis Israeliensis H14 AM65-52, e cila i përket një kompanisë ValentBioScience të cilën ne përfaqësojmë. Në SHBA si agjencia e mbrojtjes së mjedisit EPA, përgjegjës për regjistrimin e biocideve, në të gjitha dokumentet e aprovuara dhe publikuar, etiketat, skedat e të dhënave të sigurisë, dokumentacioni tekniko-shkencor i produkteve Aquabac bazuar në Bacillus Thuringensis Israeliensis H14 BMP144, njihet si një “shtam” i ndryshëm nga çdo lloj tjetër shtami.

Ky diversitet i qartë njihet edhe nga OBSH, përkatësisht se dy shtamet (BMP144 dhe AM65-52 janë të ndryshme dhe jo ekuivalente).

Duke iu rikthyer dokumenteve të paraqitura nga “Egian Med” shpk lindin disa pyetje:

- *pse dokumenti i regjistrimit amerikan është i vitit 2021, kur produkti është detyrim ligjor që të rinovohet çdo vit?*
- *pse dozat e raportuara në etiketë të regjistruara në Shqipëri janë të ndryshme nga ajo EPA?*
 - *pse vazhdon të përfshijë CERA-n (dhe avokatët e tij) që është distributori evropian i produkteve Becker, kur përdor dosjen e regjistrimit të EPA-s në pronësi të Becker-it? (Sqarojmë se Cera franceze është distributor i produkteve Aquabac në BE por e bën në bazë të një regjistrimi të ndryshëm nga ai i prodhuesit Becker-SHBA).*

Këto pyetje kanë një përgjigje të qartë: “Egian Med” shpk duhet të tregojë se regjistrimi i tij është edhe EPA edhe ECHA kështu që ai ka bërë përzierje duke marrë nga të dyja regjistrimet çfarë duhet për ta bërë të përshtatshëm Aquabac për tenderin e kontrollit të mushkonjave. Duke përdorur një nga regjistrimet e Aquabac (atë USA apo BE francez) për të aplikuar për Autorizim Importi, në bazë të Ligji nr. 95/2015 “Për shërbimet dhe produktet biocide ne shëndetin publik” produktet nuk rezultojn Ligji nr. 95/2015 “Për shërbimet dhe produktet biocide ne shëndetin publik” të përshtatshëm për tenderin e mushkonjave në Shqipëri pasi:

- *Rregjistrimi USA shtami BMP144 i kompanisë Becker-SHBA nuk ka ekuivalent në EPA dhe nuk ekziston i regjistruar në listën e produkteve biocide të lejueshme për tu përdorur në Republikën e Shqipërisë.*
- *Rregjistrimi Francezë atë që ka autorizuar ECHA, sipas nr. 95/2015 “Për shërbimet dhe produktet biocide në shëndetin publik” dhe V.K.M. nr. 933 datë 25.11.2020 “Për përcaktimin e rregullave për kriteret e vlerësimit të produkteve biocide dhe të procedurës së dhënies së autorizimit të vendosjes së tyre në treg”, del qartë se të gjitha autorizimet në*

ECHA tregojnë se produktet e markës Aquabac të kompania CERA (Aquabac 3000 DF, Aquabac 200 G, Aquabac XT), nuk plotësojnë kërkesat teknike të produktit të neYojshëm për luftën kundër larveidit në Shqipëri. Është e qartë se produktet e markës Aquabac nuk janë autorizuar në kontrollin e gjinisë së mushkonjave Anophele, pra gjinisë bartëse të plazmodiumit të maladies , gje që e bën të rëndësishme në një vend më histori malarike si Shqipëria. Për më tepër dozat e përdorimit, janë 6 deri në 8 herë më të mëdha. Pra do të duhen tonelata më shumë produkt për të patur të njëjtin rezultat, tonelata që do të lëshohen në natyrë, me ndikimin e vet negativ. Për çdo ton Vectobac EG ata do të duhet të përdorin 8 ton nga Aquabac 3000 DC. Po ashtu kohëzgjatja e efikasitetit është më e shkurtër nga ajo që kërkohet në tender.

Mesa duket deri diku Egian Med ia arriti qëllimit pasi duke krijuar konfuzion, duke llogaritur faktin se teknikisht nuk ka shumë njerëz që mund të kuptojnë dallimet dhe fallcifikimin që ka bërë dhe me ndihmën e zyrtarëve të papërgjegjshëm të shtetit arriti ta regjistrojë produktin e tij pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Regjistrimi i marrë në këtë mënyrë është një shkelje e rëndë e ligjeve shqiptare. Ligji nr. 95/2015 “Për shërbimet dhe produktet biocide në shëndetin publik” parashikon sanksione, tërheqjen nga tregu të produktit dhe kthimin e tij tek furnizuesi i huaj.

Ky regjistrim duhet të anulohet nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Republikës së Shqipërisë sepse përbërës aktiv nuk është në listën shqiptare të përberësve aktivë dhe nuk është në listën evropiane si Bacillus Thuringensis Israeliensis H14 BMP144. Kërkojmë ndërhyrjen tuaj për skualifikimin nga çdo tender publik i “Egian Med” shpk i cili ka dëshmuar prej vitesh e vazhdimisht se arsyeton dhe vepron vetëm me mashtrim dhe kundër interesave të qytetarëve dhe shtetit shqiptar.”

II.10. Me anë të shkresës nr.62 prot., datë 18.08.2023 me objekt “Mbi kthimin e përgjigjeve të ankesave tona”, protokolluar pranë KPP-së me nr.892/11 prot., datë 21.08.2023, operatori ekonomik “NRG” SHPK, i është drejtuar KPP-së, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Agjencisë Shtetërore të Prokurimeve të Përqendruara, Institutit të Shëndetit Publik, Ambasadës së SHBA-së në Shqipëri, duke ngritur pretendime mbi aktet e trajtimit të ankesave të tij nga ana e autoritetit kontraktor për Lotin 1; Lotin 2 dhe Lotin 5.

II.11. Me anë të shkresës nr.2686/1 prot., datë 25.07.2023, protokolluar me tonën me nr.1610/6 prot., datë 28.07.2023, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale na vë në dijeni se, me shkresën drejtuar operatorit ekonomik “NRG” SHPK, me përmbajtje:

“Në përgjigje të shkresës tuaj nr. 53 prot, datë 11.07.2023, protokolluar në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me nr. 2686 plot, datë 12.07.2023, me lëndë: “Mbi regjistrimin e kundraligjshëm të produktit Aquabac me dokumenta të falsifikuaia të EPA amerikane”, ju bëjmë me dije si më poshtë vijon:

Produktet biocide Aquabac 2000 dhe Aquabac DF 3000 janë pajisur nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë me autorizimin nr. 1 datë 17.01.2023 dhe me autorizimin nr. 2 datë 17.01.2023, në përputhje me kriteret e përcaktuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 933 datë 25.11.2020 “Për përcaktimin e rregullave për kriteret e vlerësimit të produkteve biocide dhe të procedurës së dhënies së autorizimit të vendosjes në treg”, Sipas përcaktimeve të VKM-së së sipërcituar, në Shtojcën I, Kreu III “Përmbajtja e dosjes së aplikimit për

autorizim” pika 1 shkronja a dhe dh, shoqëria “Egian Med” SHPK në dosjen e aplikimit, ndër dokumentet e tjerë ka dorëzuar letrën e autorizimit dhe letrën e aksesit të lëshuar nga prodhuesi BECKER MICROBIAL PRODUCTS Inc, të përkthyer dhe të noterizuara në gjuhën shqipe.

Në letrën e autorizimit të lëshuar nga prodhuesi BECKER MICROBIAL PRODUCTS Inc, SHBAm i cili është pronar i regjistrimit të produkteve të sipërcituara dhe përbërësve aktivë në SHBA, pas vlerësimit të EPA të SHBA, është cituar që kompania CERA S.A.S Francë shpërndan dhe regjistron produktet e sipërcituara dhe aktivet sipas rregullores së BE-së për produktet biocide, si dhe është autorizuar shoqëria “Egian Med” SHPK për marrjen e autorizimit për tregtimin e produkteve biocide në përputhje me legjislacionin në Republikën e Shqipërisë, si distributor ekskluziv i CERA-s për këtë territor.

Nga verifikimi në faqen zyrtare të Agjencisë Europiane për Kimikatet (ECHA) ka i rezultuar se produktet biocide Aquabac 200G dhe Aquabac DF 3000 janë autorizuar në disa vende të BE (perkatësisht produkti biocid Aquabac DF 3000 nr Itali, Francë, Spanjë dhe produkti biocid Aquabac 200G ne Belgjikë, Francë, Greqi, Itali, Spanjë) duke plotësuar kështu edhe më tej kriterin e përcaktuar në pikën 4 te Nenit 8 të Ligjit nr. 95/2015. Produktet biocide janë përfshirë në bazën e të dhënave të Agjencisë Evropiane të Kimikateve (ECHA) për produktet biocide të autorizuar. Në ëb-site-n e ECHA-s gjendet gjithashtu Raporti i Vlerësimit të Produkteve Aquabac të sipërpërmendura, kryer nga ANSES Agjencia Franceze për ushqimin, mjedisin, sigurinë dhe shëndetin në punë. Në këto vlerësime specifikohet se lënda aktive e dy produkteve biocide Aquabac DF 3000 dhe Aquabac 200 G është *Bacillus thuringiensis* nënspecia *israelensis* shtami BMP 144. Në tabelën 1.5.3 të këtij vlerësimi rezulton se: Shtami CERA SAS i nëngrupit *Bacillus thuringiensis israelensis* (Shtami BMP 144) është ekuivalent me shtamin Valent BioSciences, nënspecia *Bacillus thuringiensis israelensis* (Shtami AM65-52), i cili është dorëzuar dhe përfshirë në Aneksin I të Direktivës së produkteve biocide (98/8/EC).

Linku: https://echa.europa.eu/information-on-chemicals/biocidal-products?p_p_id=dissbiocidalproducts_ËAR_dissbiocidalproductsportlet&p_p_lifecycle=1&p_p_state=normal&p_p_mode=view&_dissbiocidalproducts_ËAR_dissbiocidalproductsportlet_javax.portlet.action=dissBiocidalProductsAction

Shtami Bti AM 65-52 është në listen e lëndëve vepruese të miratuara në shtojcën V të VKM nr.933. date 25.11.2020 “Për përcaktimin e rregullave për kriteret e vlerësimit të produkteve biocide dhe të procedurës së dhënies së autorizimit të vendosjes së tyre në treg”.

Në dosjen e aplikimit për autorizim për produktet biocide Aquabac 200G dhe Aquabac DF 3000, pjesë përberëse e dokumentacionit janë edhe etiketat e produkteve biocide sipas përcaktimit në shkronjën “ë”. të Shtojcës I, Kreu III “Përmbajtja e dosjes së aplikimit për autorizim” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 933 date 25.11.2020 “Për përcaktimin e rregullave për kriteret e vlerësimit të produkteve biocide dhe të procedurës së dhënies së autorizimit të vendosjes së tyre në treg” ku parashikohet se etiketa e produktit biocid duhet të jetë në përputhje me përcaktimet e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 487, date 29.06.2016 “Për klasifikimin e produkteve biocide”.

Gjithashtu, pas administrimit të shkresës suaj, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale bëri kërkesë nëpërmjet postës elektronike prodhuesit të produkteve biocide Becker Microbial Products Inc. për verifikimin e autenticitetit të Etiketës të lëshuar nga kjo kompani për produktet Aquabac 200G dhe Aquabac DF3000.

Kompania Becker Microbial Products Inc. konfirmoi nëpërmjet postës elektronike autenticitetin e etiketës për produktet e sipërcituara të lëshuara prej saj, për kompaninë Egian Med shpk.”

II.12. Me anë të shkresës nr.1580/8 prot., datë 30.08.2023 me objekt “Kërkesë për informacion”, KPP i është drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale duke kërkuar informacion si më poshtë: “Komisioni i Prokurimit Publik, është duke shqyrtuar ankesat e paraqitura në lidhje me procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-66549-04-19-2023, me objekt: “Shërbim Dezinsektimi” ndarë në 6 (gjashtë) Lote”, me fond limit 120.278.204 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 22.05.2023 nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.

Bazuar në nenin 24 pika 1 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit dhe kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me këtë ligj dhe akte të tjera ligjore brenda fushës së kompetencave të tij.

Referuar shkresës suaj nr. 2686/1 prot., datë 25.07.2023, protokolluar pranë institucionit tonë me nr. 1610/6 prot., datë 28.07.2023, ju na vini në dijeni në lidhje me shkresën “Kthim përgjigje”, që i jeni drejtuar shoqërisë “NRG” SHPK, duke informuar ndër të tjera se “[...] Në dosjen e aplikimit për autorizim për produktet biocide Aquabac 200G dhe Aquabac DF 3000, pjesë përbërëse e dokumentacionit janë edhe etiketat e produkteve biocide sipas përcaktimit në shkronjën “ë”, të Shtojcës I, Kreu III “Përmbajtja e dosjes së aplikimit për autorizim” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.933 datë 25.11.2020 “Për përcaktimin e rregullave për kriteret e vlerësimit të produkteve biocide dhe të procedurës së dhënies së autorizimit të vendosjes së tyre në treg” ku parashikohet se etiketa e produktit biocif duhet të jetë në përputhje me përcaktimet e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 478, datë 29.06.2016 “Për klasifikimin e produkteve biocide”. Gjithashtu, pas administrimit të shkresës tuaj, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale bëri kërkesë nëpërmjet postës elektronike prodhuesit të produkteve biocide Becker Microbial Products mc. për verifikimin e autencitetit të Etiketës të lëshuar nga kjo kompani për produktet Aquabac 200G dhe Aquabac DF3000. Kompania Becker Microbial Products Inc konfirmoi nëpërmjet postës elektronike autenticitetin e Etiketës për produktet e sipërcituara të lëshuara prej saj, për kompaninë “Egian Med” shpk.”

Referuar sa më sipër, me qëllim shqyrtimin e ankesave dhe pretendimeve të ankimuesve, kërkojmë nga ana juaj informacion si më poshtë:

1.Cila është procedura që është ndjekur për regjistrimin e produkteve biocide Aquabac 200G dhe Aquabac DF3000 në Republikën e Shqipërisë?

2.Ju lutemi na vini në dispozicion të gjithë procedurën e verifikimit së bashku me të gjitha komunikimet, që ju keni kryer me Kompaninë Becker Microbial Products Inc, në bazë të kërkesës së autoritetit kontraktor Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara dhe operatorit ekonomik “NRG” SHPK, për produktet Aquabac 200G dhe Aquabac DF3000.

3.Gjithashtu, kërkojmë nga ana juaj të na vini në dispozicion, dosjen e aplikimit për autorizim për produktet biocide Aquabac 200G dhe Aquabac DF 3000, të shoqërisë “Egian Med” SHPK, të paraqitur pranë institucionit tuaj, për të cilin ju keni lëshuar dokumentat “Akt i Autorizimit

të Produktit Biocid”, Nr.1, datë 17.01.2023 dhe “Akt i Autorizimit të Produktit Biocid”, Nr.2 datë 17.01.2023.”

II.13. Me anë të shkresës nr.2686/4 prot., datë 01.09.2023, protokolluar pranë institucionit tonë me nr.1580/9 prot., datë 06.09.2023, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik dosjen e plotë me dokumentacionin për dhënien e autorizimit, për vendosjen në treg në Republikën e Shqipërisë të produkteve biocide Aquabac 200G dhe Aquabac DF3000, nga operatori ekonomik “Egian Med” SHPK, shoqëri e regjistruar në Republikën e Shqipërisë.

II.14. Në kushtet kur nga ana e operatorit ekonomik ankimes ngrihen pretendime në lidhje me paraqitjen e dokumentacionit të rremë për qëllime kualifikimi, të dokumenteve të lëshuara nga institucione të një shteti të huaj, me anë të shkresës nr. 1580/10 prot., datë 19.09.2023, me objekt “*Kërkesë për informacion*”, me qëllim shqyrtimin e të gjithave fakteve dhe rrethanave, Komisioni i Prokurimit Publik iu drejtua Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shqipëri për të kërkuar informacion pranë institucioneve në SHBA si më poshtë:

“Pranë Komisionit të Prokurimit Publik janë paraqitur disa ankesa nga operatorë ekonomikë, në lidhje me disa lote të një procedure prokurimi.

Një ndër objektet e shqyrtimit administrativ të ankesave të paraqitura lidhet me origjinalitetin e dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “Egian Med” SHPK në kuadër të procedurës për pajisjen me autorizim importi për lëndët DDD (dezinfektuese, deratizuese, dezinfektuese dhe/ose lëndët për trajtimin e ujit të pijshëm) dhe të marrjes pjesë në procedurat e prokurimit publik në Republikën e Shqipërisë, si dokumentacion i shoqërisë Becker Microbial Products Inc, shoqëri e regjistruar në regjistrat tregëtarë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës me zyrë në 111 46 N.E 69th Place, Parkland, FL 33076 SHBA.

Dokumentacioni është dorëzuar për produktet Aquabac 200G dhe Aquabac DF3000, që nevojiten për dezinfektim të mjedisit.

Në kuadër të kryerjes së hetimit administrativ në lidhje me procedurën e mësipërme të prokurimit, referuar objektit të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik ka kërkuar me anë të shkresës nr.1580/8 protokollit datë 30.08.2023 nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale vënien në dispozicion të dokumentacionit, ndër të tjera, citojmë: “...Referuar sa më sipër, me qëllim shqyrtimin e ankesave dhe pretendimeve të ankimesve, kërkojmë nga ana juaj informacion si më poshtë:

[...]

Gjithashtu, kërkojmë nga ana juaj të na vini në dispozicion, dosjen e aplikimit për autorizim për produktet biocide Aquabac 200G dhe Aquabac DF 3000, të shoqërisë “Egian Med” SHPK, të paraqitur pranë institucionit tuaj, për të cilin ju keni lëshuar dokumentat “Akt i Autorizimit të Produktit Biocid”, Nr.1, datë 17.01.2023 dhe “Akt i Autorizimit të Produktit Biocid”, Nr.2 datë 17.01.2023. [...]”

Me anë të shkresës nr.2686/4 prot., datë 01.09.2023, protokolluar pranë institucionit tonë me nr.1580/9 prot., datë 06.09.2023 Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik dosjen e plotë me dokumentacionin për dhënien e autorizimit për vendosjen në treg në Republikën e Shqipërisë të produkteve biocide Aquabac

200G dhe Aquabac DF3000, nga operatori ekonomik “Egian Med” SHPK, shoqëri e regjistruar në Republikën e Shqipërisë.

Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se shoqëria “Egian Med” SHPK, ka dorëzuar pranë autoriteteve publike Shqiptare, dokumentacion se kjo e fundit është e autorizuar nga kompania Becker Microbial Products Inc, shoqëri e regjistruar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, (sipas autorizimit datë 11/4/2022) citojmë: “për të përdorur fletët tona të të dhënave si MSDS, pSDS, etiketa etj”, për marrjen e autorizimit për komercializimin e produkteve biocide të listuara në përputhje me ligjin për Shërbimet dhe Produktet Biocide në Shëndetin Publik të Shqipërisë dhe VKM-në e tij (vendimet e Këshillit të Ministrave), si distributor ekskluziv i CERA për këtë territor.”

Gjithashtu, operatori ekonomik “Egian Med” SHPK, ka dorëzuar pranë autoriteteve publike Shqiptare, Letrën e aksesit, datë 11/4/2022 të lëshuar nga shoqëria Becker Microbial Products Inc, ku rezulton se autorizimi është dhënë për produktet AQUABAC® 200G dhe AQUABAC® DF3000, për dezinfektimin e mjedisit.

Referuar letrës së mësipërme shoqëria deklaron se, citojmë: “Ne, Becker Microbial Products Inc, me zyrat tona në 111 46 NË 69th Place, Parkland, FL 33076 SHBA, prodhues i produkteve bio-larvicide bazuar në përbërësin aktiv *Bacillus thuringiensis israelensis* dhe pronar i regjistrimit të produkteve dhe përbërësit aktiv të listuar më poshtë në SHBA, pas vlerësimit të EPA (Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit):

1. “BMP144 (200G)” Emri alternativ i markës “AQUABAC® 200G”, përbërës aktiv *Bacillus thuringiensis israelensis* H14 shtame BMP144, 2,86% ë/ë

- Numri i regjistrimit të EPA: 62637-3
- Linku i regjistrimit të EPA: [...]

2. “BMP144 DF3000” Emri alternativ i markës “AQUABAC® DF3000”, përbërës aktiv *Bacillus thuringiensis israelensis* H14 shtame BMP144, 43,00% ë/ë

- Numri i regjistrimit të EPA: 62637-14
- Linku i regjistrimit të EPA: [...]

[...]

Bashkëlidhur këtij dokumentacioni ndër të tjera, janë dorëzuar etiketat e produkteve AQUABAC® 200G dhe AQUABAC® DF3000 nga prodhuesi Becker Microbial Products Inc.

Referuar objektit të aneksave të paraqitura pranë Komisionit të Prokurimit Publik ngrihen pretendime se etiketat e dorëzuara nga operatori ekonomik “Egian Med” SHPK për këtë procedurë prokurimi dhe në procesin e lëshimit të autorizimit për tregëtim nuk janë të njëjta me ato të regjistruara në regjistrat të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Ndaj, për këtë arsye Komisionit të Prokurimit Publik i nevojitet informacion zyrtar nga institucionet në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Në mbështetje të nenit 115 pika 5 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, nenin 103 pika 2 të Vendimit Nr. 285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 30 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, na shfaqet i nevojshëm informacioni për sa më poshtë vijon:

1. Cili është legjislacioni në Shtetet e Bashkuara të Amerikës për regjistrimin e produkteve biocide? Cili është institucioni/et përgjegjës/e i cili regjistron këto produkte dhe lëshon autorizim/ miratimin për tregëtim ose dokumentacion ekuivalent me këtë?
2. A është produkti AQUABAC® 200G i regjistruar pranë EPA (Agjencia e Mbrojtjes së Mjedisit) në Shtetet e Bashkuara të Amerikës me nr. Regjistrimi të EPA 62637-3?
3. Cila është etiketa e regjistruar pranë EPA në shtetet e Bashkuara të Amerikës për produktin AQUABAC® 200G?
4. A është produkti AQUABAC® DF3000 i regjistruar pranë EPA (Agjencia e Mbrojtjes së Mjedisit) në Shtetet e Bashkuara të Amerikës me nr. Regjistrimi të EPA 62637-14?
5. Cila është etiketa e regjistruar pranë EPA në shtetet e Bashkuara të Amerikës për produktin AQUABAC® DF3000?
6. Referuar legjislacionit në fuqi në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në rast të ndryshimit të përmbajtjes së etiketës, a duhet këto të fundit të regjistrohen në EPA?
7. A janë etiketat për produktet AQUABAC® 200G dhe AQUABAC® DF3000 bashkëngjitur kësaj shkrese të regjistruara/ miratuara në EPA në datën 10.12.2022 datë e aplikimit pranë institucioneve shqiptare të shoqërisë “Egian Med” SHPK për paisjen me autorizim importi për lëndët DDD (dezinfektuese, deratizuese, dezinsktuese dhe/ose lëndët për trajtimin e ujit të pijshëm) ?

Për vetë rëndësinë, që ka shqyrtimi në kohë i ankesave të operatorëve ekonomikë në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni i prokurimit publik, si dhe për një shqyrtim transparent të plotë dhe objektiv të ankesave, do të vlerësonim bashkëpunimin Tuaj për kryerjen e verifikimit pranë institucioneve përgjegjëse në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe/ose dhënien e një informacioni në lidhje me kërkimet e mësipërme.

Bashkëngjitur kësaj shkrese lutem të gjeni etiketat të dorëzuara pranë institucioneve shqiptare të shoqërisë “Egian Med” SHPK për paisjen me autorizim importi për lëndët DDD:

1. Etiqueta për produktin AQUABAC® 200G
2. Etiqueta për produktin AQUABAC® DF3000

Do të vlerësonim dërgimin e një informacioni të detajuar në një kohë sa më të shpejtë.”

II.15. Në datën 26.09.2023, me anë të komunikimit elektronik, Komisioni i Prokurimit Publik është informuar nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shqipëri, në lidhje me trajtimin e kërkesës së Komisionit të Prokurimit Publik nga institucioni përgjegjës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Me nr.1580/14 prot., datë 27.09.2023, u nënshkrua kontrata “Kontratë - shërbimi”, mes Komisionit të Prokurimit Publik dhe përkthyesit z.E.B., pjesë e listës së përkthyesve të licencuar të miratuar nga Ministria e Drejtësisë. Kthimi i përgjigjes u përkthye nga gjuha angleze në gjuhën shqipe dhe u administrua pranë Komisionit të Prokurimit Publik me procesverbalin me nr. 1580/15 prot., datë 27.09.2023, “Procesverbal i dorëzimit të materialit, për përkthimin e materialit të ardhur me email në datë 26.09.2023, sipas urdhërit nr.1580/13, datë 27.09.2023”.

II.16. Në kthim përgjigjen e institucioneve përgjegjëse në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (EPA) rezulton trajtimi i kërkesës së Komisionit të Prokurimit Publik si më poshtë vijon:

"Ju lutemi të gjeni më poshtë përgjigjet e EPA-së lidhur me pyetjet që na keni drejtuar. Përgjigjet e EPA-së për pyetjet tuaja janë të shënuara me ngjyrë të kuqe më poshtë, për lehtësi referimi. Shpresoj që këto përgjigje të jenë me dobi për ju.

[...]

Nga EPA-ja:

Ju lutemi të vini re se kjo çështje i është referuar edhe Zyrës sonë të Ekzekutimit dhe Sigurimit të Përbushjes, duke qenë se ka pasur pretendime të pamiratuara për këto etiketa të veçanta të dy insekticideve të Becker Microbial Products. Me poshtë po ju japim përgjigje pyetjeve të Komisionit të Prokurimit Publik:

1. Çfarë legjislacioni ka për regjistrimin e biocideve në Shtetet e Bashkuara (Shënim: Adresat ku mund të gjejnë informacionin mjaftojnë. Fundi i Shënimit)? Cili është emri i institucionit/institucioneve përgjegjëse për regjistrimin e këtyre produkteve (emri dhe adresa e internetit e institucionit/agjencisë mjafton)? Cili është emri i institucionit që lëshon autorizimet (ose dokument të barasvlershëm) për produktet që hidhen në treg (emri dhe adresa e internetit e institucionit mjafton)?

- Në kuadër të Aktit Federal për Insekticidet, Fungicidet dhe Helmet kundër Brejtësve (FIFRA), EPA normon lëndët që përdoren si pesticide (40 CFR § 152.15). Pesticidi është (1) çdo lëndë (ose përzierje lëndësh) me qëllim parandalimin, shkatërrimin, largimin, ose zbutjen e dëmtuesve; (2) çdo lëndë (ose përzierje lëndësh) që përdoren si rregullator bimësh, si zhveshës gjethesh, ose tharës; dhe (3) çdo stabilizues azoti. Përpara se një pesticid të shitet ose të shpërndahet në SHBA, ai duhet të regjistrohet nga EPA-ja.*

2. A është i regjistruar AQUABAC®200G nga EPA-ja në Shtetet e Bashkuara me numër regjistrimi EPA 62637-3? Ju lutemi na siguroni adresën e internetit për regjistrimin.

3. Çfarë etikete është regjistruar me EPA-në në Shtetet e Bashkuara për produktin AQUABAC®200G? Ju lutemi na siguroni adresën e internetit ku mund të gjejnë etiketën.

- Në përgjigje të pyetjeve 2 dhe 3, po, produkti është aktualisht i regjistruar me EPA-në. Etiketa kryesore më e fundit e pranuar mund të gjendet duke kërkuar Sistemin tonë publik të Produkteve Pesticide dhe Etiketave (PPLS) me numër regjistrimi EPA 62637-3 (jepet adresa e internetit për etiketën kryesore më të fundit të pranuar). Do të vini re se emri kryesor tregtar është BMP 144 (200G), megjithatë, për qartësi Aquabac (200G) është emër tregtar alternativ i pranueshëm.*

- Etiketa përfundimtare në treg lejohet të jetë pak më ndryshe nga etiketa kryesore e pranuar (p.sh. etiketa përfundimtare tregtare mund të përfshijë një pjesë të çka përfshihet në etiketën kryesore të pranuar).*

- Megjithatë, me sa jam në dijeni, EPA nuk ka miratuar pretendimin e barasvlershmërisë së variantit në deklaratën e përbërësve për insekticidin BMP 144 (200G) të Becker Microbial Products. Kështu, etiketa e produktit Aquabac (200G) që na keni vënë në dispozicion nuk është kopje e vërtetë dhe e saktë e etiketës së produktit të miratuar nga EPA-ja.*

4. A është regjistruar AQUABAC® DF3000 me EPA-në me numër regjistrimi EPA 62637-14? Ju lutemi na siguroni adresën e internetit për regjistrimin.

5. Çfarë etikete është regjistruar me EPA-në në Shtetet e Bashkuara për produktin AQUABAC®DF3000? Ju lutemi na siguroni adresën e internetit ku mund të gjejnë etiketën.

- Në përgjigje të pyetjeve 4 dhe 5, produkti aktualisht i regjistruar me EPA-në si Regjistrim EPA # 62637-14 është i miratuar me emër parësor tregtar "BMP 144 DF 3000" (emri alternativ tregtar "AQUABAC ĘDG 3000"). Si në rastin e produktit të mësipërm, mund ta gjeni duke kërkuar PPLS-në me numër regjistrimi 62637-14 (jepet adresa e internetit për etiketën kryesore më të fundit të pranuar).

- Në këtë rast, Aquabac DF3000 nuk duket të jetë emër alternativ tregtar i miratuar sipër dokumentacionit tonë. Megjithatë, ata mund të mos përdorin të njëjtin emër në SHBA dhe miratimi përkatës është proces i thjeshtë.

- Edhe në këtë rast, EPA nuk ka miratuar pretendimin e barasvlershmërisë së variantit në deklaratën e përbërësve për insekticidin BMP 144 DF 3000 të Becker Microbial Products. Kështu, etiketa e produktit Aquabac DF3000 që na keni vënë në dispozicion nuk është kopje e vërtetë dhe e saktë e etiketës së produktit të miratuar nga EPA-ja.

6. Bazuar në legjislacionin në fuqi në Shtetet e Bashkuara, nëse përmbajtja e etiketës ndryshon, a duhet shoqëria të regjistrojë këtë ndryshim me EPA-në?

- Po, zakonisht nëse regjistruesi dëshiron të bëjë ndryshime në etiketë ose formulim, ata duhet të njoftojnë EPA-në lidhur me ndryshimet e propozuara. Vetëm disa ndryshime shumë të vogla mund të bëhen pa njoftuar EPA-në. Megjithatë, shumica dërrmuese e ndryshimeve të propozuara kërkojnë që regjistruesi t'i nënshtrohet procesit të njoftimit ose ndryshimit të EPA-së.

7. A janë regjistruar dhe miratuar ETIKETAT e bashkëngjitura të produkteve AQUABAC®200G dhe AQUABAC® DF3000 nga EPA më 10 dhjetor 2022, datë në të cilën këto dokumente janë dorëzuar nga një shoqëri shqiptare në autoritetet shqiptare për përfitim të autorizimit për import? NËSE PO, ju lutemi na dërgoni adresën e internetit ku mund të gjejmë këto etiketa.

- Megjithëse Regjistrimi i EPA-së # 62637-3 dhe Regjistrimi i EPA # 62637-14 janë produkte të regjistruara (etiketat kryesore më të fundit të miratuara për secilin mund t'i shihni në adresat e internetit më sipër), etiketat në fjalë përfshijnë pretendime barasvlershmërie që nuk janë miratuar.”

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur më pretendimet e operatorit ekonomik “NRG” SHPK për skualifikimin e operatorit ekonomik “Egian Med” SHPK, para shqyrtimit në themel të pretendimeve të operatorit ekonomikë ankimues, (*thema decidendum*) KPP sqaron, se procedura e shqyrtimit administrativ të ankesës së operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik rregullohet nga ligji nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” si edhe lex specialis, ligji nr.162/2020 “Për prokurimin publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik referuar pretendimeve me shkrim të operatorit ekonomik “NRG” SHPK për skualifikimin e operatorit ekonomik “Egian Med” SHPK, rezulton, se pretendimet për kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Egian Med” SHPK, lidhen me elemente të dokumentacionit të pretenduar të rreme për qëllime kualifikimi.

III.1.2. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik nënvizon faktin, se në interpretim të *lex specialis*, autoritet kompetent për kryerjen e verifikimeve, hetimeve dhe më pas marrjen e masave të përjashtimit të operatorëve ekonomikë që kanë paraqitur dokumentacion të rremë për qëllime kualifikimi, është e Agjencisë së Prokurimit Publik, ndërkohë që verifikimi, referuar nenit 76 pika 5 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” mund të kryhet edhe nga ana e autoritetit kontraktor. Kështu, ligjvënësi ka parashikuar një diskrecion më të lartë të autoritetit kontraktor, për të kryer veprimet procedurale të skualifikimit të ofertës së operatorit ekonomik edhe pas përfundimit të vlerësimit fillestar, nëse konstatohet se ky i fundit ka dorëzuar dokumentacion të rremë për qëllime kualifikimi. Nga ana tjetër, megjithëse dy procedura të veçanta dhe regjime të posaçme juridike, ai i shqyrtimit të ankesave pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe ai i shqyrtimit të dokumentacionit të pretenduar si të dorëzuar të rremë nga ana e operatorit ekonomik, Komisioni vlerëson se në kuadër të procedurës së prokurimit në tërësi janë të lidhura me njëra-tjetrën. Ky fakt lidhet me vendimmarrjen të Komisionit të Prokurimit Publik, pasi në vlerësim të KPP për efekt të ekonomisë së shqyrtimit administrativ dhe integritetit, besimit publik dhe transparencës në procedurat e prokurimit publik, këto dy momente janë të lidhura, pasi një operator ekonomik, në rast se verifikohet me dokumentacion të rremë për qëllime kualifikimi nuk mund të vijojë as me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit dhe as të marrë pjesë në procedura prokurimi, nëse konstatohet nga institucioni përgjegjës (APP) që këto dokumente janë të rreme. Ashtu si edhe, Komisioni i Prokurimit Publik, vlerëson, se në momentin që pretendohet se në një procedurë prokurimi janë paraqitur dokumente të rreme nuk mund të investohet të gjykojë çështjen në themel, por i lind e drejta t’i kërkojë bashkëpunim institucioneve kompetente për të provuar ose jo pretendimet e operatorëve ekonomikë, kjo në kuadër të një procesi të rregullt ligjor. Nga ana tjetër, një ndër parimet kryesore të shqyrtimit administrativ është ai i efikasitetit që përfshin njëherazi shpejtësinë në vendimmarrje, sa më pak kosto për organin publik dhe palët dhe mbi të gjitha të arrihet çfarë është e nevojshme për një rezultat të ligjshëm. Kjo, merr një vlerë tjetër të posaçme në procedurat e prokurimit publik. Kështu, *lex specialis* i ka vendosur kufij ligjor Komisionit për t’u shprehur, ndërkohë që Kodi i Procedurave Administrative rregullon institutin e hetimit, duke vendosur po kështu edhe kufij maksimalë të afateve kohore të institucioneve të tjera.

Në lidhje me legjitimitimin (*locus standi*) për vënien në lëvizje të Komisionit të Prokurimit Publik, KPP vlerëson se në nenin 94 pika 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” rregullon të drejtën e operatorëve ekonomikë për të vënë në lëvizje (*locus standi*) autoritetin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik në kuadër të shqyrtimit të ankesave në procedurat e prokurimit publik. Në këtë kontekst, parë në interpretim literal dhe teologjik dhe sistematik, një operator ekonomik do gëzojë interes të ligjshëm për të kundërshtuar vendimin e autoritetit

kontraktor nëse ky i fundit është dëmtuar ose rrezikon të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor i marrë në kundërshtim me ligjin për prokurimin publik. Parë në dritën e Direktivës mbi Mjetet e rishikimit administrativ, KPP që një operator ekonomik të legjitimohet për të dorëzuar një ankesë në kuadër të procedurës së prokurimit duhet njëherazi të ketë interes për të fituar kontratën dhe që ka qenë ose rrezikon të dëmtohet nga një shkelje e pretenduar.

Në nenin 76 pika 5 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar parashikohet se: *“Autoriteti ose enti kontraktor skualifikon çdo kandidat ose ofertues, që paraqet të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi, në çdo kohë, deri në momentin e lidhjes së kontratës dhe raportin në Agjencinë e Prokurimit Publik, për qëllimet e parashikuara në nenin 78 të këtij ligji.”* Në rastin konkret, ligjvënësi ka parashikuar një pozitë të veçantë të trajtimit të rastit kur operatori ekonomik ka dorëzuar dokumentacion të rremë për qëllime kualifikimi, akoma më tej, kjo përcaktuar edhe në nenin 78 të ligjit për prokurimin publik ku parashikohet se : *“1. Agjencia e Prokurimit Publik përjashton një operator ekonomik nga e drejta për të fituar kontrata publike për një periudhë nga 3 muaj deri në 3 vjet për: a) keqinformim dhe dorëzim të dokumenteve, që përmbajnë të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi;”* Në këtë mënyrë, të drejtës për të skualifikuar një operator ekonomik për paraqitjen e dokumentacionit të rremë për qëllime kualifikimi, i është dhënë një pozitë e veçantë juridike, duke e shtrirë në çdo moment para lidhjes së kontratës, për vetë faktin se ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit janë ato të mosdiskriminimit, trajtimit të barabartë të ofertuesve, ndërkohë që vetë ligji në tërësi ndër qëllimet kryesore ka atë të nxitjes së konkurrencës, por edhe të sigurimit të integritetit, besimit publik dhe transparencës në procedurat e prokurimit publik, të cilat cenohen në rast se një operator ekonomik paraqet në përmbushje të kritereve të veçanta të kualifikimit dokumentacion të rremë për qëllime kualifikimi.

Për këtë qëllim, Komisioni vlerëson të ndalet në dy momente të veçanta në arsyetimin e vendimit, atë të pretendimeve të një operatori ekonomik për dorëzimin e dokumentacionit të rremë për qëllime kualifikimi nga ana e një operatori tjetër ekonomik, si edhe atë të këtij të fundit, në lidhje me kundërshtimin e vendimit të autoritetit kontraktor për skualifikimin e ofertës së tij.

III.1.3. Referuar bazës ligjore të sipërcituar, si dhe marrë shkas nga pretendimet e ngritura nga operatori ekonomik “NRG” SHPK mbi paraqitjen nga ana e operatorit ekonomik “Egian Med” SHPK të dokumentacionit të rremë në procedurën e prokurimit objekt - ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik njëherazi, me pezullimin e shqyrtimit administrativ të çështjes për hetim, për përshpejtim të procesit dhe lehtësi të hetimit me shkresën Nr. 1580/10 prot., datë 19.09.2023, i është drejtuar Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës duke kërkuar nga kjo e fundit verifikimin pranë institucioneve përgjegjëse në Shtetet e Bashkuara të Amerikës të dokumentacionit të dorëzuar në procedurën e prokurimit nga operatori ekonomik “Egian MED” SHPK. Konkretisht është kërkuar verifikimi i *etiketave të produkteve AQUABAC® 200G dhe AQUABAC® DF3000 nga prodhuesi Becker Microbial Products Inc, të paraqitura nga operatori ekonomik “Egian Med” SHPK.*

III.1.4. Në vijim të sa më sipër, lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “NRG” SHPK për skualifikimin e operatorit ekonomik “Egian Med” SHPK me argumentin, se “Kërkesat e vecanta për kualifikim, janë të detyrueshme për tu përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarres ne procedurat e prokurimit.

Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

Një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai i barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vleresohen ato.

Specialistët e ISHP që hartuan specifikimet teknike sipas V.K.M. nr. 933 datë 25.11.2020 E.R dhe Z.S qëllimisht nuk e kishin përcaktuar shtamin e produktit bti në dokumentat e tenderit madje nuk kishin vendosur asnjë kriter kualifikimi teknik për produktin. Themi qëllimisht pasi vetëm në këtë mënyrë do të favorizonin duke marrën guximin të kualifikonin OE Egian Med shpk edhe pse produkti i tij është i pavleshëm pasi nuk është në listën e përbërësve aktivë të miratuar në Republikën e Shqipërisë. Jo më kot është E.R që përgatit specifikimet teknike të tenderit dhe merr pjesë gjithashtu në grupin që lëshon Autorizim importi. Të dy këta punonjës të ISHP-së në bashkëpunim me njëri-tjetrin kanë shpërdoruar detyrën duke ndihmuar OE Egian Med shpk të regjistrojë produktet Aquabac dhe për këto veprime shoqëria jonë do të kërkojë përgjegjësite penale pranë institucioneve kompetente. Shembull i shpërdorimit të detyrës dhe favorizimit të OE Egian Med shpk është edhe demaskimi publik që u bëri emisioni investigativ Stop në TV Klan këtyre dy punonjësve (emisioni i datës 27.06.2023).

Por këta punonjës harruan se në fletoren zyrtare nr. 210 të datës 02.12.2020 është botuar VKM nr. 933 datë 25.11.2020 “Për përcaktimin e rregullave për kriteret e vlerësimit të produkteve biocide dhe të procedurës së dhënies së autorizimit të vendosjes së tyre në treg” ku përcaktohen rregulla për të cilat një product biocid mund të regjistrohet në territorin e Republikës së Shqipërisë. Pjesë e këtij V.K.M është edhe Shtojca V “Lista e lëndëve Vepruese të Miratuara” pra lista e lëndëve vepruese që përmban produkti biocid, referuar bazës së të dhënave të ECHA-s (bashkëlidhur ankesës).

Në këto kushte kemi arsye të forta të mendojmë që Egian Med SHPK ka përdorur si dokumentacion për produktin bti në këtë procedurë prokurimi Autorizimin e importit dhe jo Certifikatën e regjistrimit në një nga vendet që parashikon ligji I biocidëve. Vetëm në këtë mënyrë ai mbulon më së miripaligjshmërinë dhe mos plotësimin e specifikimeve teknike të produkteve Aquabac.

OE “Egian Med” SHPK ka regjistruar ose produktin e kompanisë amerikane Becker Microbial Products ose atë të kompanisë franceze Cera. Për këtë analiza si mëposhtë:

Rasti i parë: Regjistrimi është bërë duke paraqitur dokumentacionin amerikan të regjistrimit në EPA (Agjencia Amerikane e Mbrojtjes së Mjedisit). Në këtë rast, duke analizuar regjistrimin

e pranishëm në EPA dhe duke kontrolluar dokumentet e regjistrimit dhe etiketën, është shumë e qartë se shtami i produktit Aquabac është BMP 144. Baslikungjitur janë kopjet e regjistrimit të EPA. Nëse ky është rasti me të cilin është marrë regjistrimi, procedura është e paligjshme dhe duhet mbajtur menjëherë qëndrim ligjor ndaj personave përgjegjës me qëllim mbrojtjen e ligjit shqiptar. **Ligji flet shumë qartë dhe është lehtësisht e dallueshme që Bacillus Thuringensis Israeliensis BMP 144 nuk figuron në listën e përbërësve aktivë të regjistruar në Republikën e Shqipërisë si PT18 (Lloji i produktit).** Autorizimi i importit i lëshuar në këtë rast është i pavlefshëm dhe do të ishte një shkelje shumë e rëndë e ligjeve shqiptare, duke regjistruar kështu një produkt dhe duke lëshuar lejen e importit në mënyrë të paligjshme. Ligji nr. 95/2015 “Pëi shërbimet dhe produktet biocide në shëndetin publik” parashikon sanksione si tërheqjen nga tregu të produktit dhe kthimin e tij tek furnizuesi i huaj.

Ekuivalenca e shtamit të Bacillus Thuringensis Israeliensis AM65-52 nuk është e vlefshme me BMP 144, pasi EPA (Agjencia e Mbrojtjes së Mjedisit) në SHBA si përgjegjëse për regjistrimin/miratimin e biocidëve, ka pasqyruar në të gjitha dokumentet e miratuara dhe publikuara nga vet ajo të tilla si: Çertifikatat e regjistrimit (që zoterohen nga kompania amerikane Becker Microbial Products), etiketat, skedat e sigurisë, skedat teknike, dokumentacioni tekniko-shkencor flasin qartë se shtami BMP144 i Aquabac I Bacillus Thuringensis Israeliensis njihet si një shtam i ndryshëm nga çdo lloj tjetër. Ky diversitet del qartë dhe njihet edhe nga OBSH, e cila shprehet se **dy Shtamet BMP144 dhe AM65-52 janë të ndryshëm dhe nuk pranohet asnjë lloj ekuivalence.** Pra, nëse procedura e lëshimit të Autorizimit të importit nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është bërë në bazë të Çertifikatës së regjistrimit të lëshuar nga EPA në SHBA të produkteve Aquabac, duhet të anulohet urgjentisht dhe duhet të vazhdojmë të kuptojmë se kush e ka lejuar këtë shkelje Ligji, pasi **Bacillus Thuringensis Israeliensis BMP144 nuk figuron në listën e përbërësve aktivë të regjistruara në Republikën e Shqipërisë si PT18 (Lloji i produktit)** dhe nuk mund të konsiderohet ekuivalencë përderisa SHBA nuk pranon.

Akoma më keq është nëse regjistrimi amerikan i Aquabac **përzihet qëllimisht** me ato evropiane të Aquabac (regjistrim që zotërohet nga kompania franceze CERA) për të shfrytëzuar ekuivalencën të cilën e konsideron vetëm ECHA (Agjencia Evropiane e Kimikateve) dhe që është një ekuivalencë e limituar që pasqyrohet në të meta të rëndësishme në efikasitetin e produkteve të regjistruar nga CERA. Nga ana shkencore dhe ligjore kjo nuk është e pranueshme se po flasim për një regjistrim në SHBA që me të drejtë nuk njihet dhe nuk pranon ekuivalencën, dhe konsideron mjedisin dhe tippet e larvave të mushkonjave në SHBA dhe që për më shumë nuk është në listën e lëndëve biocide të miratuara në Shqipëri.

Për ta shpjeguar më mirë nga ana shkencore sjellim shembullin e Covid-19 ku të gjithë kemi qënë dëshmitarë sesi në vitet e fundit të pandemisë nga një shtam fillestar mikroorganizmi kemi kaluar në variacione të ndryshëm, me diferencë sinjifikante me zona të ndryshme të botës. Në fakt, koncepti se pse OBSH e konsideron çdo shtam jo ekuivalent dhe përcakton një numër specifik për secilin, e tregon qartë shembulli i mëposhtëm:

Le ta mendojmë "shtamin" si diçka e "natyrës" kundrejt "ushqimit". Megjithëse të gjithë jemi Homo Sapiens, historia jonë njerëzore dhe mjedisi diktuan ndryshimet që shohim midis njerëzve. Nuk është vetëm gjenetika, por mjedisi në të cilin gjenetika vepron dhe rritet (për shembull prodhues të ndryshëm microbial / larvicide). Në fakt, edhe kur materiali gjenetik

është identik (si në rastin e binjakëve identikë), nëse njëri binjak rritet në Çikago dhe tjetri në Shqipëri, ata do të jenë dy njeirëz shumë të ndryshëm pavarësisht se ndajnë të njëjtin kod gjenetik. E njëjta gjë vlen edhe për mikroorganizmat. Autoritetet rregullatore anembanë botës (duke përfshirë Organizatën Botërore të Shëndetësisë) e njohin këtë fakt biologjik dhe pët këtë arsye përcaktojnë numra "mjedisor" (numurin e shtamit) për secilin prodhues microbial.

Rasti i dytë: Kur për lëshimin e Autorizimit të importit përdoret regjistrimi i kompanisë Cera, çertifikatat e regjistrimit dhe gjithë dokumentacioni që e shoqëron, sqarojmë edhe njëherë se **Aquabac Bacillus Thuringensis Israeliensis BMP144 nuk është i listuar në listën e përbërësve aktivë të regjistruar në Republikën e Shqipërisë si PT18 (Lloji i Produktit)**. Në dosjen ECHA të produkteve biocide të markës Aquabac (Aquabac 3000 DF dhe Aquabac 200 G dhe Aquabac XT), bazuar në Bacillus Thuringensis Israeleinsis (Bti) si PT18 (lloji i produktit 18 në ECHA), është raportuar disa herë në emrin e shtamit "Bti BMP 144" referuar gjithmonë produkteve Aquabac.

Sjellim në vëmendjen tuaj se regjistrimi fillestarë i vitit 2016 produkteve të kompanisë franceze Cera është çregjistruar në ECHA dhe Republikën e Shqipërisë në bazë të vendimit të Gjykatës së Apelit të Francës me kërkesë të kompanisë Sumitomo Chemical Agro Europe SAS për të cilën kompania jonë është distributor ekskluzivë në Shqipëri.

Sumitomo Chemical Agro Europe SAS deklaroi se në bazë të njohurive shkencore që zotëron, se shtami AM65-52 për të cilin kjo kompani zotëron të drejtën industriale dhe regjistrimin, është i ndryshëm nga shtami BMP 144 në pronësi të kompanisë Cera.

EPA (Agjencia Amerikane e Mbrojtjes së Mjedisit) e SH.B.A nuk e konsideron ekuivalente Shtamet e Bt1: BMP144 dhe AM65-52 dhe kjo është arsyeja që tregon pse numrat e shtameve duhet të specifikohen në etiketat për produktet mikrobiale/larvicide.

Për të mbrojtur pronësinë industriale të shtamit AM65-52 kundër deklarimeve të rreme apo dëmtimit e imazhit të këtij produkti kompania Sumitomo ka ndërmarrë dhe do të ndërmarrë të gjitha hapat e duhura të tilla si proceset gjyqësore dhe kërkesën për dëmshpërblim.

Sumitomo Chemical Agro Europe SAS ka ndërmarrë tashmë hapat ligjore për të mbrojtur pronësinë e saj industriale në Gjykatë dhe siç edhe deklaroi rezervon të drejtën e ligjshme të kërkojë dëmshpërblimin autoriteteve Europiane dhe Shqiptare.

Nëse do të donim ta shpërfillnim këtë fakt dhe të konsideronim konceptin e ekuivalencës, në bazë të dosjeve të regjistrimit (ju lutem gjeni bashkëlidhjen ankesës me pjesët e theksuara të nënvizuara) të biocidëve me bazë Bti nën markën Aquabac ato flasin qartë.

"Raporti i vlerësimit të një produkti biocid për aplikimin e ndryshimeve madhore" përmbajnë të gjitha testet, provat në terren, testet laboratorike në lidhje me aspekte të shumta të produktit, dhe padyshim fokusohen në:

1. Efektivitetin
2. Organizmat e synuara dhe rrjedhimisht llojet e mushkonjave për të cilat është autorizuar
3. Dozat e përdorimit
4. Kohëzgjatja e aktivitetit në luftimin e mushkonjave/larvave

Duke marrë në konsideratë atë që ka regjistruar ECHA, e cila është themelore dhe bazë për lëshimin e Autorizimit të Importit shqiptar sipas Ligjit nr. 95/2015 "Për shërbimet dhe produktet biocide në shëndetin publik" dhe V.K.M. nr. 933 datë 25.11.2020 "Për përcaktimin e rregullave për kriteret e vlerësimit të produkteve biocide dhe të procedurës së dhënies së

autorizimit të vendosjes së tyre në treg”, mund të themi se të gjitha autorizimet në ECHA tregojnë se produktet e markës Aquabac të kompania CERA (Aquabac 3000 DF, aquabac 200 G, Aquabac XT), **nuk plotësojnë kërkesat teknike të produktit të nevojshëm për luftën larvicide në Shqipëri dhe qartësisht të kërkuara në "Specifikimet Teknike" të tenderit në fjalë.**

Në fakt, duke lexuar tërësisht dosjen e regjistrimit në ECHA dhe përmbledhjen relative të karakteristikave teknike (SPC) dhe etiketën e autorizuar, **është e qartë se produktet e markës Aquabac nuk janë autorizuar (për shkak të mungesës së testeve të efikasitetit) në kontrollin e gjinisë së mushkonjave Anophele, pra gjinisë bartëse të plazmodiumit të malaries, për luftimin e të cilave filloi pjojekti në 2013, si dhe gjinisë së pranishme në shumë zona bregdetare të Shqipërisë.**

Gjinia Anopheles dhe kontrolli I tyre janë pjesa më e rëndësishme e DST, e saktësuar mirë në specifikimet teknike të tenderit”, ku listohen llojet e larvave për tu kontrolluar në të gjitha zonat bregdetare të vendit (inspektimi I nevojshëm në çdo grup).

Thjesht duam tju kujtojmë rrezikun e gjinisë Anopheles, duke marrë të dhëna nga faqja e internetit e OBSH-së që thotë se në vitin 2021 janë diagnostikuar 240 milionë raste në mbarë botën, me 620,000 vdekje dhe prej tyre rreth 450,000 fëmijë nën moshën 5 vjeç.

Për më tepër ka edhe dy informacione të tjera të rëndësishme në dosje dhe etiketë që ngrenë dy çështje themelore:

Dozat e përdorimit, për të marrë të njëjtin rezultat dozimi I produkteve të markës Aquabac janë 6 deri në 8 herë më të mëdha në varësi të formulimit sesa ato të produktit konkurrent Vectobac. Duke lënë mënjanë koston e rritur, mbi të gjitha duhet llogaritur ndikimi në mjedis, edhe kjo është një temë për tu marrë seriozisht pasi flitet për tu përdorur tonelata më shumë product për të patur të njëjtin rezultat (përfunduar efektivitetin në anofele), tonelata që do të lëshohen në natyrë, me ndikimin e tyre negative. Për çdo 1 ton Vectobac EG do të duhet të përdoret 8 ton Aquabac 3000 DF.

Kohëzgjatja e efikasitetit: Testet e kryera pas pesë, shtatë dhe pesëmbëdhjetë ditësh në ujërat me nivele të larta të lëndëve organike, (të tilla si ujërat e lagunave dhe kënetave shqiptare), nuk tregojnë një kohëzgjatje të efikasitetit (aktivitetit luftues).

Sa më sipër oferta e këtij OE duhet të skualifikohet pasi produkti Bacillus Thuringensis Israeliensis H14 BMP144 (I ofertuar nga OE Egian Med shpk):

- **nuk renditet në listë e produktet të lëjuara për regjistrim dhe importin në Shqipëri.**
- **Nuk plotëson kërkesat e specifikimeve teknike të tenderit, sepse nuk kontrollon gjininë më të rrezikshme të mushkonjave në botë, anopheles, të cilat janë arsyeja e këtij projekti, ka dozim të rritur që shkakton ndotje të ambientit, dhe nuk plotëson specifikimet teknike për kohëzgjatjen e aktivitetit luftues.**

Për sa parashtruar kërkojmë të vihet në dispozicion dosja e aplikimit në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale për pajisjen e operatorit Egian Med Shpk me autorizim importi për lëndët biocide. Kështu do të tregohet qartësisht se në rastin më të mirë kemi të bëjmë me paligjshmëri në lëshimin e këtij autorizimi dhe në rastin më të keq mosplotësimi I specifikimeve teknike, rreziku për të dalë nga tregu si product Aquabac e mosrealizim të kontratës dhe për më shumë kërkesa e dëmshpërblimit ndaj autoriteteve shqiptare të dëmshpërblimit ndaj autoriteteve shqiptare të dëmshpërblimit nga një kompani multinationale si Sumitomo.

Për çdo paqartësi kërkohet gjithashtu zhvillimin e një takimi ballafaques midis përfaqësuesve të shoqërisë tonë dhe specialistëve të fushës.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.5. Në shtojcën e publikuar për modifikimin e dokumentave të tenderit, për Lotin 5, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

➤ **Në Shtojcën 8 “Formular I Kritereve Të Përzgjedhjes/Kualifikimit” seksioni 2.1 “Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomik” në Dokumenteve të Tenderit:**

SHTOHET

1. *Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes Liçencë per kategorine II.8.B “Shërbime ndërhyrëse higjieno-shëndetësore”, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit. Operatori ekonomik pjesemarrës duhet te jete i licensuar sipas dispozitave perkatëse ligjore dhe nen ligjore.*

Shënim:

Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afatëve të ankimimit ofertuesi fitues duhet të paraqesë Licencën e kerkuar prane AK.

2. *Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatën ose dokumentin e rregjistrimit vetëm në rastin e produkteve biocide në një prej vendeve e percaktuara ne Ligjin 95/2015 “Për shërbimet dhe produktet biocide ne shëndetin publik”.*
3. *Operatori ekonomik duhet te provojë që është i autorizuar nga prodhuesit ose nga distributorët e autorizuar nga prodhuesit, për lëndët biocide që do të kryhet shërbimi objekt prokurimi. Në rast se do të paraqitet kjo e fundit, duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit te Autorizuar dhe Prodhuesit. Autorizimi duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: telefon, e-mail, Ëëbsite kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij.*
4. *Operatori ekonomik duhet te paraqesë etiketat/katalogët/skedat teknike dhe Dokumentin e te dhënave të Sigurisë për të gjitha produktet biocide ose jo biocide (barriera fizike etj.) në gjuhën shqip dhe anglisht.*
5. *Operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë se do të sigurojë shërbimin ËEB GIS me editim nga interneti për ndërtimin e hartave dixhitale sipas përcaktimeve në specifikimet teknike.*

III.1.6. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (S.P.E.) për plotësimin e kriterit të mësipërm, operatori ekonomik ankimues “Egjan Med” SHPK ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Deklaratë mbi përmbushjen e kritereve kumulative
- Dokument i lëshuar nga Agjencia e Mbrojtjes së Mjedisit të Shteteve të Bashkuara, EPA (United States Environmental Protection Agency) Washington, D.C. 20460, datë

16.02.2021, në të cilin, ndër të tjera citohet: “[...] ..vërtetohet se produkti pesticid i listuar më poshtë është që nga data e kësaj letre, një produkt i regjistruar sipas Aktit Federal të Insekticideve, Fungicideve dhe Rodenticideve (FIFRA), i ndryshuar, dhe si i tillë, produkti mund të shitet dhe tregtohet në Shtetet e Bashkuara të Amerikës si i autorizuar dhe i kufizuar nga FIFRA. Një kopje e vërtetë dhe e saktë e etiketës së produktit të miratuar nga EPA është bashkangjitur për të shoqëruar këtë letër.

Regjistrimi i këtij produkti me EPA tregon gjithashtu se regjistruesi i listuar më poshtë është përgjegjës për të siguruar përputhjen e plotë me të gjitha ligjet e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, ose juridiksionin qeverisës, në lidhje me shitjen, ruajtjen dhe/ose asgjësimin e produktit. Më tej, marësi i kësaj letre njoftohet se regjistrimi i referuar dhe/ose etiketa shoqëruese mund të ndryshojnë pas datës së kësaj letre. EPA nuk merr përsipër asnjë përgjegjësi për të njoftuar marrësit (d.m.th., Turqinë) të kësaj letre për cdo ndryshim në statusin e regjistrimit dhe/ose etiketës së produktit për produktin e listuar më poshtë.

EPA ka lëshuar numrin e regjistrimit për produktin e listuar më poshtë për:

BECKER MICROBIAL PRODUCTS, INC.

EPA Numrin e Regjistrimit: 62637-3

Emri i Produktit: BMP 144 (200 G)” dokument ky i nënshkruar nga EPA, I përkthyer dhe I noterizuar.

- Dokument i lëshuar nga Agjencia e Mbrojtjes së Mjedisit të Shteteve të Bashkuara, EPA (United States Environmental Protection Agency) Ëashington, D.C. 20460, datë 16.02.2021, në të cilin, ndër të tjera citohet: “[...] ..vërtetohet se produkti pesticid i listuar më poshtë është që nga data e kësaj letre, një produkt i regjistruar sipas Aktit Federal të Insekticideve, Fungicideve dhe Rodenticideve (FIFRA), i ndryshuar, dhe si i tillë, produkti mund të shitet dhe tregtohet në Shtetet e Bashkuara të Amerikës si i autorizuar dhe i kufizuar nga FIFRA. Një kopje e vërtetë dhe e saktë e etiketës së produktit të miratuar nga EPA është bashkangjitur për të shoqëruar këtë letër.

Regjistrimi i këtij produkti me EPA tregon gjithashtu se regjistruesi i listuar më poshtë është përgjegjës për të siguruar përputhjen e plotë me të gjitha ligjet e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, ose juridiksionin qeverisës, në lidhje me shitjen, ruajtjen dhe/ose asgjësimin e produktit. Më tej, marësi i kësaj letre njoftohet se regjistrimi i referuar dhe/ose etiketa shoqëruese mund të ndryshojnë pas datës së kësaj letre. EPA nuk merr përsipër asnjë përgjegjësi për të njoftuar marrësit (d.m.th., Turqinë) të kësaj letre për cdo ndryshim në statusin e regjistrimit dhe/ose etiketës së produktit për produktin e listuar më poshtë.

EPA ka lëshuar numrin e regjistrimit për produktin e listuar më poshtë për:

BECKER MICROBIAL PRODUCTS, INC.

11146 N.Ë.69TH PLACE PARKLAND, FL 33076

EPA Numrin e Regjistrimit: 62637-14

Emri i Produktit: BMP 144 DF 3000” dokument ky i nënshkruar nga EPA, I përkthyer dhe I noterizuar.

- Letër autorizimi datë 11.04.2023, lëshuar nga kompania Becker Microbial Products Inc me përmbajtje: “Ne, Becker Microbial Products Inc., zyrtar tona në adresë 11146 NË 69th Place, Parkland, FL 33076, USA, prodhues të produkteve bio-larvicide të bazuara në përbërësin aktiv *Bacillus thuringiensis israelensis* dhe pronar regjistrimi të produkteve të

listuara më poshtë dhe përbërësve aktivë në SHBA, pas vlerësimit të EPA (Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit):

1. “BMP144 (200G)” Emri alternativ i markës “AQUABAC® 200G”, përbërës aktiv *Bacillus thuringiensis israelensis H14* shtame BMP144, 2,86% ë/ë
 - Numri i regjistrimit të EPA: 62637-3
 - Linku i regjistrimit të EPA: [...]
 2. “BMP144 DF3000” Emri alternativ i markës “AQUABAC® DF3000”, përbërës aktiv *Bacillus thuringiensis israelensis H14* lloji BMP144, 43,00% ë/ë
 - Numri i regjistrimit të EPA: 62637-14
 - Linku i regjistrimit të EPA: [...]
- Produktet dhe aktivet e së cilës shpërndahen dhe regjistrohen gjithashtu nga kompania CERA S.A.S Francë (kod TVSH FR 09 448 623 835, adresa; 16 rue de St-Petersbourg, 75008 Paris France) sipas rregullores së BE-së për produktet biocide (BPR (EU) N° 528/2012) dhe vlerësimi i Autoriteteve Kompetente Evropiane (ECHA, Agjencia Evropiane Kimike dhe ANSES, Agjencia Kombëtare për Sigurinë e Ushqimit, Mjedisit dhe Shëndetit në Punë) vlerësimi:
1. “Aquabac® 200G”, përbërës aktiv *Bacillus thuringiensis israelensis H14* shtamet AM65-52, 86% W/W
 - Linku i regjistrimit të ECHA:
 2. “Aquabac® DF 3000”, përbërës aktiv *Bacillus thuringiensis israelensis* shtame H14 AM65-43,00% W/W
 - Linku i regjistrimit të ECHA:
 3. Lidhja ECHA për regjistrimin aktiv të përbërësve: <https://echa.europa.eu/fr/information-on-chemicals/active-substance-suppliers>

Me këtë shkresë autorizojmë shoqërinë EGIANMED shpk të organizuar dhe krijuar sipas ligjeve të Shqipërisë (Numër Identifikimi NIPT: L71715003C. me seli: Rr.e Kavajës, Qendra Godina Condor, Kulla D, Kati 4, Tiranë, Shqipëri; Tel: _____; Cel: _____, E-mail: xxxxxxx@gmail.com), për të përdorur fletët tona të të dhënave, si MSDS, pSDS, etiketa, etj., për marrjen e autorizimit për komercializimin e produkteve biocide të listuara në përputhje me ligjin për Shërbimet dhe Produktet Biocide në Shëndetin Publik të Shqipërisë dhe VKM-në e tij (vendimet e këshillit të ministrave), në tregun e Shqipërisë, si distributor ekskluziv i CERA-s për këtë territor”, dokument ky i nënshkruar nga kompania Becker Microbial Products Inc, i përkthyer dhe i noterizuar.

Bashkëlidhur dokumentit të mësipërm, është paraqitur dokumenti i lëshuar nga Agjencia e Mbrojtjes së Mjedisit të Shteteve të Bashkuara, EPA (United States Environmental Protection Agency) Washington, D.C. 20460, datë 16.02.2021, në të cilin, ndër të tjera citohet: “[...] ..vërtetohet se produkti pesticid i listuar më poshtë është që nga data e kësaj letrë, një produkt i regjistruar sipas Aktit Federal të Insekticideve, Fungicideve dhe Rodenticideve (FIFRA), i ndryshuar, dhe si i tillë, produkti mund të shitet dhe tregtohet në Shtetet e Bashkuara të Amerikës si i autorizuar dhe i kufizuar nga FIFRA. Një kopje e vërtetë dhe e saktë e etiketës së produktit të miratuar nga EPA është bashkangjitur për të shoqëruar këtë letër.

Regjistrimi i këtij produkti me EPA tregon gjithashtu se regjistruesi i listuar më poshtë është përgjegjës për të siguruar përputhjen e plotë me të gjitha ligjet e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, ose juridiksionin qeverisës, në lidhje me shitjen, ruajtjen dhe/ose asgjësimin e produktit. Më tej, marësi i kësaj letre njoftohet se regjistrimi i referuar dhe/ose etiketa shoqëruese mund të ndryshojnë pas datës së kësaj letre. EPA nuk merr përsipër asnjë përgjegjësi për të njoftuar marrësit (d.m.th., Turqinë) të kësaj letre për cdo ndryshim në statusin e regjistrimit dhe/ose etiketës së produktit për produktin e listuar më poshtë.

EPA ka lëshuar numrin e regjistrimit për produktin e listuar më poshtë për:

BECKER MICROBIAL PRODUCTS, INC.

EPA Numrin e Regjistrimit: 62637-3

Emri i Produktit: BMP 144 (200 G)” dokument ky i nënshkruar nga EPA, i përkthyer dhe i noterizuar.

- Letër autorizimi datë 11.04.2023, lëshuar nga kompania Becker Microbial Products Inc me përmbajtje: “Ne, Becker Microbial Products Inc., zyrtar tona në adresë 11146 NË 69th Place, Parkland, FL 33076, USA, prodhues të produkteve bio-larvicide të bazuara në përbërësin aktiv *Bacillus thuringiensis israelensis* dhe pronar regjistrimi të produkteve të listuara më poshtë dhe përbërësve aktivë në SHBA, pas vlerësimit të EPA (Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit):

1. “BMP144 (200G)” Emri alternativ i markës “AQUABAC® 200G”, përbërës aktiv *Bacillus thuringiensis israelensis* H14 shtame BMP144, 2,86% ë/ë

- Numri i regjistrimit të EPA: 62637-3

- Linku i regjistrimit të EPA: [...]

2. “BMP144 DF3000” Emri alternativ i markës “AQUABAC® DF3000”, përbërës aktiv *Bacillus thuringiensis israelensis* H14 lloji BMP144, 43,00% ë/ë

- Numri i regjistrimit të EPA: 62637-14

- Linku i regjistrimit të EPA: [...]

Produktet dhe aktivet e së cilës shpërndahen dhe regjistrohen gjithashtu nga kompania CERA S.A.S Francë (kod TVSH FR 09 448 623 835, adresa; 16 rue de St-Petersbourg, 75008 Paris France) sipas rregullores së BE-së për produktet biocide (BPR (EU) N° 528/2012) dhe vlerësimi i Autoriteteve Kompetente Evropiane (ECHA, Agjencia Europiane Kimike dhe ANSES, Agjencia Kombëtare për Sigurinë e Ushqimit, Mjedisit dhe Shëndetit në Punë) vlerësimi:

1. “Aquabac® 200G”, përbërës aktiv *Bacillus thuringiensis israelensis* H14 shtamet AM65-52, 86% Ë/Ë

- Linku i regjistrimit të ECHA:

2. “Aquabac® DF 3000”, përbërës aktiv *Bacillus thuringiensis israelensis* shtame H14 AM65-43,00% Ë/Ë

- Linku i regjistrimit të ECHA:

3. Lidhja ECHA për regjistrimin aktiv të përbërësve: <https://echa.europa.eu/fr/information-on-chemicals/active-substance-suppliers>

Me këtë shkresë autorizojmë shoqërinë EGIANMED shpk të organizuar dhe krijuar sipas ligjeve të Shqipërisë (Numër Identifikimi NIPT: L71715003C. me seli: Rr.e Kavajës, Qendra

Godina Condor, Kulla D, Kati 4, Tiranë, Shqipëri; Tel _____; Cel: _____, E-mail: xxxxxxx@gmail.com), për të përdorur fletët tona të të dhënave, si MSDS, pSDS, etiketa, etj., për marrjen e autorizimit për komercializimin e produkteve biocide të listuara në përputhje me ligjin për Shërbimet dhe Produktet Biocide në Shëndetin Publik të Shqipërisë dhe VKM-në e tij (vendimet e këshillit të ministrave), në tregun e Shqipërisë, si distributor ekskluziv i CERA-s për këtë territor”, dokument ky i nënshkruar nga kompania Becker Microbial Products Inc, i përkthyer dhe i noterizuar.

- Bashkëlidhur dokumentit të mësipërm, është paraqitur dokumenti i lëshuar nga Agjencia e Mbrojtjes së Mjedisit të Shteteve të Bashkuara, EPA (United States Environmental Protection Agency) Washington, D.C. 20460, datë 16.02.2021, në të cilin, ndër të tjera citohet: “[...] ..vërtetohet se produkti pesticid i listuar më poshtë është që nga data e kësaj letre, një produkt i regjistruar sipas Aktit Federal të Insekticideve, Fungicideve dhe Rodenticideve (FIFRA), i ndryshuar, dhe si i tillë, produkti mund të shitet dhe tregtohet në Shtetet e Bashkuara të Amerikës si i autorizuar dhe i kufizuar nga FIFRA. Një kopje e vërtetë dhe e saktë e etiketës së produktit të miratuar nga EPA është bashkangjitur për të shoqëruar këtë letër.

Regjistrimi i këtij produkti me EPA tregon gjithashtu se regjistruesi i listuar më poshtë është përgjegjës për të siguruar përputhjen e plotë me të gjitha ligjet e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, ose juridiksionin qeverisës, në lidhje me shitjen, ruajtjen dhe/ose asgjësimin e produktit. Më tej, marësi i kësaj letre njoftohet se regjistrimi i referuar dhe/ose etiketa shoqëruese mund të ndryshojnë pas datës së kësaj letre. EPA nuk merr përsipër asnjë përgjegjësi për të njoftuar marrësit (d.m.th., Turqinë) të kësaj letre për cdo ndryshim në statusin e regjistrimit dhe/ose etiketës së produktit për produktin e listuar më poshtë.

EPA ka lëshuar numrin e regjistrimit për produktin e listuar më poshtë për:

BECKER MICROBIAL PRODUCTS, INC.

11146 N.Ë.69TH PLACE PARKLAND, FL 33076

EPA Numrin e Regjistrimit: 62637-14

Emri i Produktit: BMP 144 DF 3000” dokument ky i nënshkruar nga EPA, I përkthyer dhe I noterizuar.

- Etiketa për produktin “AQUABAC® (200G) me përmbajtje:
“**Active Ingredient:** *Bacillus Thuringiensis israelensis serotype H14 Strain BMP 144 (technically equivalent to strain AM65-52) solids, spores and insecticidal toxins.....2.86 %*
[...]
No. of Authorization of the Biocidal Product: 62637-3
Manufacturer/Producer: Becker Microbials Products, Inc., 11146 NË 69th Place, Parkland, FL 33076, Tel.: +1 954-345-9321.
Authorization Holder: EGIANMED shpk, Rr. E Kavajës, Godina Condor Center, Kulla D, Kati 4, Tirana, Albania; Tel.: +35542333999, Mobile: +355692060671, E-mail: xxxxxxxx@gmail.com”.

Etiketa për produktin “AQUABAC® DF3000 me përmbajtje:

“*Biolarvicide – Eater Dispersible Granule*

Active Ingredient: *Bacillus Thuringiensis israelensis* Strain BMP 144 (technically equivalent to strain AM65-52) solids, spores and insecticidal toxins.....43.0 %

[...]

No. of Authorization of the Biocidal Product: 62637-14

Manufacturer/Producer: Becker Microbials Products, Inc., 11146 NĚ 69th Place, Parkland, FL 33076, Tel.: +1 954-345-9321.

Authorization Holder: EGIANMED shpk, Rr. E Kavajës, Godina Condor Center, Kulla D, Kati 4, Tirana, Albania; Tel.: +35542333999, Mobile: +355692060671, E-mail: xxxxxxxx@gmail.com". (dokumenti është përkthyer edhe në gjuhën shqipe);

- Dokumenti i të dhënave të Sigurisë (Safety Data Sheet) – AQUABAC (200 G), ku paraqiten specifikimet teknike të produktit, dokumenti është i përkthyer dhe i noterizuar;
- Dokumenti i të dhënave të Sigurisë (Safety Data Sheet) – AQUABAC® DF3000, ku paraqiten specifikimet teknike të produktit, dokumenti është i përkthyer dhe i noterizuar;
- Dokumenti, datë 03.04.2023 (për të interesuarit Shqipëri) “*Deklarata mbi efektin e mbetjeve/jetëgjatësinë, efikasitetin kundër anofeleve dhe frekuencave të aplikimit të formulimeve të Aquabac*”, lëshuar nga Kompania Becker Microbials Products, Inc., 11146 NĚ 69th Place, Parkland, FL 33076. (dokumenti është përkthyer edhe në gjuhën shqipe).
- Akt i Autorizimit të Produktit Biocid, Nr.1, datë 17.01.2023 për autorizimin e vendosjes në treg dhe përdorimin e produktit biocid në Republikën e Shqipërisë, të produktit AQUABAC 200 G, lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
- Akt i Autorizimit të Produktit Biocid, Nr.2, datë 17.01.2023 për autorizimin e vendosjes në treg dhe përdorimin e produktit biocid në Republikën e Shqipërisë, të produktit AQUABAC DF3000, lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

.....

- Letër autorizimi për Mosquitorex nga fabrikuesi/prodhuesi për përdorimin e produkteve në Shqipëri, datë 15.05.2023, lëshuar nga kompania NEËPHARM SRL me përmbajtje: “[...] Ne, NEËPHARM S.R.L., me vendodhje ne Via Tremarende 22, 35010 S. Giustina in Colle (PD), ITALY, Tel.: +39 049 9302876, E-mail: info@neepharm.it, prodhues dhe pronare te regjistruar i MOSQUITOREX, produkt i cili nuk eshte BIOCID, me veprim fizik-mekanik per kontrollin e mushkonjave te vogla dhe te larvave (krijon nje shtrese mbi ujin e trajtuar), me ane te kesaj letre zyrtare, ne autorizojme importimin dhe perdorimin e MOSQUITOREX nga kompania EGIAN MED sh.p.k (Numer Identifikimi NIPT. L71715003C, me adrese kryesore: Rr. e Kavajes, Godina Condor Center, Kulla D, Kati4, Tirana, Albania; Tel.: +35542333999, Mobile: +355692060671, E-mail: xxxxxxxx@gmail.com). Kjo letër autorizimi zyrtare i jep te drejten kompanisë EGIAN MED të përdorë fletët tona të të dhënave, si IDS, etiketa, etj, për të importuar, përdorur, shitur dhe tregtuar produktin e listuar më sipër në tregun e Shqipërisë, si distributor i këtij territori.” (dokumenti është paraqitur original dhe i përkthyer);
- Etiketa Mosquitorex (I përkthyer dhe I noterizuar)

- Deklaratë mbi veprimin e produktit MOSQUITOREX, datë 29.04.2022, lëshuar nga prodhuesi NEWPHARM SRL (dokumenti është paraqitur original dhe I përkthyer);
- Katalog Insecticides and Larvicides Mosquitorex®, (dokumenti është paraqitur original dhe I përkthyer);
- Dokumenti i informacionit të Sigurisë (Safety Information Sheet) – MOSQUITOREX, ku paraqiten specifikimet teknike të produktit, (dokumenti është paraqitur original dhe i përkthyer);
- Fletë informative (Information Sheet) – MOSQUITOREX, ku paraqiten specifikimet teknike të produktit, (dokumenti është paraqitur original dhe i përkthyer);

III.1.7. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.1.8. KPP nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, konstaton, se autoriteti kontraktor në shtojcën për modifikimin e tyre, “Për kapacitetin teknik ka përcaktuar”, se “2. *Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatën ose dokumentin e rregjistrimit vetëm në rastin e produkteve biocide në një prej vendeve e përcaktuara në Ligjin 95/2015 “Për shërbimet dhe produktet biocide në shëndetin publik”.* 3. *Operatori ekonomik duhet të provojë që është i autorizuar nga prodhuesit ose nga distributorët e autorizuar nga prodhuesit, për lëndët biocide që do të kryhet shërbimi objekt prokurimi. Në rast se do të paraqitet kjo e fundit, duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbaje të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, Ëëbsite kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.* 4. *Operatori ekonomik duhet të paraqesë etiketat/katalogët/skedat teknike dhe Dokumentin e të dhënave të Sigurisë për të gjitha produktet biocide ose jo biocide (barriera fizike etj.) në gjuhën shqip dhe anglisht.”.*

Sa më sipër, nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, për skualifikimin e operatorit ekonomik “Egian Med” SHPK, KPP konstaton, se pretendimet e ankimuesit, së pari lidhen me ligjshmërinë dhe vërtetësinë e dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Egian Med” SHPK për përmbushjen e kriterëve të kualifikimit.

Konkretisht, nga shqyrtimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik “Egian Med” SHPK, konstatohet, se ky i fundit ka paraqitur Letër autorizimi datë 11.04.2023, të lëshuar nga kompania Becker Microbial Products Inc me adresë 11146 NË 69th Place, Parkland, FL 33076, USA e cila për në Europë autorizon kompaninë CERA në Francë dhe në Shqipëri autorizon kompaninë “Egian Med” SHPK për tregtimin e produkteve të saj, me përmbajtje si më poshtë: “AQUABAC® 200G” dhe “AQUABAC® DF3000” “BMP144 (200G)”, Emri alternativ i markës “AQUABAC® 200G”, përbërës aktiv *Bacillus thuringiensis israelensis H14* shtame BMP144, 2,86% ë/ë

- Numri i regjistrimit të EPA: 62637-3

- Linku i regjistrimit të EPA: [...]

“BMP144 DF3000” Emri alternativ i markës “AQUABAC® DF3000”, përbërës aktiv *Bacillus thuringiensis israelensis H14* lloji BMP144, 43,00% ë/ë

- Numri i regjistrimit të EPA: 62637-14

- Linku i regjistrimit të EPA: [...]

Produktet dhe aktivet e së cilës shpërndahen dhe regjistrohen gjithashtu nga kompania CERA S.A.S Francë (kod TVSH FR 09 448 623 835, adresa; 16 rue de St-Petersbourg, 75008 Paris France) sipas rregullores së BE-së për produktet biocide (BPR (EU) N° 528/2012) dhe vlerësimi i Autoriteteve Kompetente Evropiane (ECHA, Agjencia Evropiane Kimike dhe ANSES, Agjencia Kombëtare për Sigurinë e Ushqimit, Mjedisit dhe Shëndetit në Punë) vlerësimi:

1. “Aquabac® 200G”, përbërës aktiv *Bacillus thuringiensis israelensis H14* shtamet AM65-52, 86% Ë/Ë

- Linku i regjistrimit të ECHA:

2. “Aquabac® DF 3000”, përbërës aktiv *Bacillus thuringiensis israelensis* shtame H14 AM65-43,00% Ë/Ë

- Linku i regjistrimit të ECHA:

3. Lidhja ECHA për regjistrimin aktiv të përbërësve: <https://echa.europa.eu/fr/information-on-chemicals/active-substance-suppliers>

Me këtë shkresë autorizojmë shoqërinë EGIANMED shpk të organizuar dhe krijuar sipas ligjeve të Shqipërisë (Numër Identifikimi NIPT: L71715003C. me seli: Rr.e Kavajës, Qendra Godina Condor, Kulla D, Kati 4, Tiranë, Shqi përi; Tel: _____; Cel: _____, E-mail: xxxxxxx@gmail.com), për të përdorur fletët tona të të dhënave, si MSDS, pSDS, etiketa, etj., për marrjen e autorizimit për komercializimin e produkteve biocide të listuara në përputhje me ligjin për Shërbimet dhe Produktet Biocide në Shëndetin Publik të Shqipërisë dhe VKM-në e tij (vendimet e këshillit të ministrave), në tregun e Shqipërisë, si distributor ekskluziv i CERA-s për këtë territor”.

Gjithashtu, operatori ekonomik “Egian Med” SHPK ka dorëzuar dy dokumente të lëshuara dhe nënshkruara nga Agjencia e Mbrojtjes së Mjedisit të Shteteve të Bashkuara, EPA (United States Environmental Protection Agency) Washington, D.C. 20460, datë 16.02.2021, ku deklarohet

se produkti i BMP 144 (200 G) dhe BMP 144 DF 3000 të kompanisë BECKER MICROBIAL PRODUCTS, INC janë të regjistruar në EPA me numër regjistrimi përkatësisht 62637-3 dhe 62637-14.

Referuar dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik “Egian Med” SHPK, rezulton, se këto produkte janë autorizuar për tregtimin e tyre në Republikën e Shqipërisë nëpërmjet Akt i Autorizimit të Produktit Biocid, Nr.1, datë 17.01.2023 për autorizimin e vendosjes në treg dhe përdorimin e produktit biocid në Republikën e Shqipërisë, të produktit AQUABAC 200 G, lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si dhe Akt i Autorizimit të Produktit Biocid, Nr.2, datë 17.01.2023 për autorizimin e vendosjes në treg dhe përdorimin e produktit biocid në Republikën e Shqipërisë, të produktit AQUABAC DF3000, lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Së fundmi, operatori ekonomik “Egian Med” SHPK ka dorëzuar etiketat e produkteve “AQUABAC® (200G) (*Bacillus Thuringiensis israelensis serotype H14 Strain BMP 144 (technically equivalent to strain AM65-52) solids, spores and insecticidal toxins.....2.86 %*), dhe AQUABAC® DF3000 (*Bacillus Thuringiensis israelensis Strain BMP 144 (technically equivalent to strain AM65-52) solids, spores and insecticidal toxins.....43.0 %*), ku citohet si prodhuese kompania Becker Microbials Products, Inc., 11146 NW 69th Place, Parkland, FL 33076, dhe kompania e autorizuar EGIANMED shpk, Rr. E Kavajës, Godina Condor Center, Kulla D, Kati 4, Tirana, Albania;

III.1.9. Sa më sipër pasqyruar, KPP nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, mbi pavlefshmërinë e etiketave të paraqitura, për shkak se ato janë të falsifikuara, duke qenë se këto dy produkte “AQUABAC® (200G) dhe AQUABAC® DF3000, janë autorizuar nga shteti shqiptar për tregtimin e tyre në Republikën e Shqipërisë, përkatësisht sipas Akt i Autorizimit të Produktit Biocid, Nr.1, datë 17.01.2023 dhe Akt i Autorizimit të Produktit Biocid, Nr.2, datë 17.01.2023, KPP me anë të shkresës nr. nr.1580/8 prot., datë 30.08.2023 me objekt “Kërkesë për informacion”, i është drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale duke kërkuar ndër të tjera informacion se: 1. *Cila është procedura që është ndjekur për regjistrimin e produkteve biocide Aquabac 200G dhe Aquabac DF3000 në Republikën e Shqipërisë?* 2. *Ju lutemi na vini në dispozicion të gjithë procedurën e verifikimit së bashku me të gjitha komunikimet, që ju keni kryer me Kompaninë Becker Microbial Products Inc, në bazë të kërkesës së autoritetit kontraktor Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara dhe operatorit ekonomik “NRG” SHPK, për produktet Aquabac 200G dhe Aquabac DF3000.* 3. *Gjithashtu, kërkojmë nga ana juaj të na vini në dispozicion, dosjen e aplikimit për autorizim për produktet biocide Aquabac 200G dhe Aquabac DF 3000, të shoqërisë “Egian Med” SHPK, të paraqitur pranë institucionit tuaj, për të cilin ju keni lëshuar dokumentat “Akt i Autorizimit të Produktit Biocid”, Nr.1, datë 17.01.2023 dhe “Akt i Autorizimit të Produktit Biocid”, Nr.2 datë 17.01.2023.*”

III.1.10. Me anë të shkresës nr.2686/4 prot., datë 01.09.2023, protokolluar pranë institucionit tonë me nr.1580/9 prot., datë 06.09.2023 Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik dosjen e plotë me dokumentacionin për

dhënien e autorizimit për vendosjen në treg në Republikën e Shqipërisë të produkteve biocide Aquabac 200G dhe Aquabac DF3000, nga operatori ekonomik “Egian Med” SHPK, shoqëri e regjistruar në Republikën e Shqipërisë, ku ndër të tjera konstatohet se pjesë e dosjes së aplikimit janë paraqitur të njëjta etiketa për produktet Aquabac 200G dhe Aquabac DF3000, siç janë dorëzuar në procedurën e prokurimit, ku citohet se “AQUABAC® (200G) dhe AQUABAC® DF3000 janë teknikisht ekuivalent me shtamin AM65-52.

III.1.11. Ndërkohë që, operatori ekonomik “NRG” SHPK në ankesën e tij ndër të tjera pretendon se “[...] Ekuivalenca e shtamit të *Bacillus Thuringensis Israeliensis* AM65-52 nuk është e vlefshme me BMP 144, pasi EPA (Agjencia e Mbrojtjes së Mjedisit) në SHBA si përgjegjëse për regjistrimin/miratimin e biocideve, ka pasqyruar në të gjitha dokumentet e miratuara dhe publikuara nga vet ajo të tilla si: Çertifikatat e regjistrimit (që zoterohen nga kompania amerikane Becker Microbial Products), etiketat, skedat e sigurisë, skedat teknike, dokumentacioni tekniko-shkencor flasin qartë se shtami BMP144 i Aquabac I *Bacillus Thuringensis Israeliensis* njihet si një shtam i ndryshëm nga çdo lloj tjetër. Ky diversitet del qartë dhe njihet edhe nga OBSH, e cila shprehet se **dy Shtamet BMP144 dhe AM65-52 janë të ndryshëm dhe nuk pranohet asnje lloj ekuivalence**. Pra, nëse procedura e lëshimit të Autorizimit të importit nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është bërë në bazë të Çertifikatës së regjistrimit të lëshuar nga EPA në SHBA të produkteve Aquabac, duhet të anulohet urgjentisht dhe duhet të vazhdojmë të kuptojmë se kush e ka lejuar këtë shkëlqje Ligji, pasi *Bacillus Thuringensis Israeliensis* **BMP144 nuk figuron në listën e përbërësve aktivë të regjistruara në Republikën e Shqipërisë si PT18 (Lloji i produktit)** dhe nuk mund të konsiderohet ekuivalencë përderisa SHBA nuk pranon.

Akoma më keq është nëse regjistrimi amerikan i Aquabac **përzihet qëllimisht** me ato evropiane të Aquabac (regjistrim që zotërohet nga kompania franceze CERA) për të shfrytëzuar ekuivalencën të cilën e konsideron vetëm ECHA (Agjencia Europiane e Kimikateve) dhe që është një ekuivalencë e limituar që pasqyrohet në të meta të rëndësishme në efikasitetin e produkteve të regjistruar nga CERA. Nga ana shkencore dhe ligjore kjo nuk është e pranueshme se po flasim për një regjistrim në SHBA që me të drejtë nuk njihet dhe nuk pranon ekuivalencën, dhe konsideron mjedisin dhe tippet e larvave të mushkonjave në SHBA dhe që për më shumë nuk është në listën e lëndëve biocide të miratuara në Shqipëri.

Për ta shpjeguar më mirë nga ana shkencore sjellim shembullin e Covid-19 ku të gjithë kemi qënë dëshmitarë sesa në vitet e fundit të pandemisë nga një shtam fillestar mikroorganizmi kemi kaluar në variacione të ndryshëm, me diferencë sinjifikante me zona të ndryshme të botës. Në fakt, koncepti se pse OBSH e konsideron çdo shtam jo ekuivalent dhe përcakton një numër specifik për secilin, e tregon qartë shembulli i mëposhtëm:

Le ta mendojmë "shtamin" si diçka e "natyrës" kundrejt "ushqimit". Megjithëse të gjithë jemi *Homo Sapiens*, historia jonë njerëzore dhe mjedisi diktuan ndryshimet që shohim midis njerëzve. Nuk është vetëm gjenetika, por mjedisi në të cilin gjenetika vepron dhe rritet (për shembull prodhues të ndryshëm microbial / larvicide). Në fakt, edhe kur materiali gjenetik është identik (si në rastin e binjakëve identikë), nëse njëri binjak rritet në Çikago dhe tjetri në Shqipëri, ata do të jenë dy njeirëz shumë të ndryshëm pavarësisht se ndajnë të njëjtin kod gjenetik. E njëjta gjë vlen edhe për mikroorganizmat. Autoritetet rregullatore anembanë botës

(duke përfshirë Organizatën Botërore të Shëndetësisë) e njohin këtë fakt biologjik dhe për këtë arsye përcaktojnë numra "mjedisor" (numurin e shtamit) për secilin prodhues microbial."

Pra sa më sipër, referuar pretendimeve të operatorit ekonomik ankimes, dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik nga operatori ekonomik "Egian Med" SHPK, si dhe dokumentacionit të dosjes së aplikimit për pajisjen me autorizim importi për vendosjen në treg të produkteve biocide, të dorëzuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, konstatohet, se operatori ekonomik "Egian Med" SHPK vërteton, se tregton produktet AQUABAC® (200G) dhe AQUABAC® DF3000, të autorizuara nga kompania Becker Microbials Products në Amerikë, si dhe ka dorëzuar të gjithë dokumentacionin përkatës së regjistrimit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

III.1.12. KPP, me qëllim shqyrtimin me objektivitet të të gjitha fakteve dhe rrethanave, nisur nga pretendimet e ankimesit, si dhe dokumentacioni i dorëzuar nga operatori ekonomik "Egian Med" SHPK, duke qenë se produktet AQUABAC® (200G) dhe AQUABAC® DF3000 janë miratuar nga Agjencia e Mbrojtjes së Mjedisit të Shteteve të Bashkuara, EPA (United States Environmental Protection Agency) Washington, me anë të shkresës nr. 1580/10 prot., datë 19.09.2023 iu drejtua Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shqipëri, duke i kërkuar informacion mbi regjistrimin e këtyre produkteve në Shtetin Amerikan, si dhe mbi vlefshmërinë dhe origjinalitetin e etiketave të paraqitura për këto produkte. Me qëllim sqarimin e të gjithë rrethanave të çështjes dhe për një trajtim të drejtë, të barabartë dhe transparent Komisioni i Prokurimit Publik i drejtoi shtatë pyetje institucioneve përgjegjëse në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, përmes Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Pyetjet u drejtuan institucionit përgjegjës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, për shkak se referuar dokumentacionit të administruar në fashikullin e shqyrtimit administrativ, si atë të dorëzuar pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ashtu edhe në procedurën e prokurimit, rezulton se dokumentacioni i dorëzuar nga operatori ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit objekt - ankimi është dokumentacion i dorëzuar nga prodhuesi, shoqëri e regjistruar në regjistrat tregtarë amerikan, në Parkland Florida. Ndërkohë, shoqëria CERA, e regjistruar në regjistrat tregtarë Francez referuar dokumentacionit, konkretisht letrës së autorizimit lëshuar nga prodhuesi Becker, pjesë e dosjes së aplikimit për licencim nga ministria përgjegjëse rezulton si distributore pasi deklarohet se *produktet dhe aktivitetet e së cilës shpërndahen dhe regjistrohen gjithashtu nga kompania CERA SAS Francë TVSH FR 09448623835.*

Ndërkohë, referuar dokumentacionit të dorëzuar në procedurën e prokurimit nga operatori ekonomik "Egian Med" SHPK, por edhe në dosjen e licencimit të vënë në dispozicion nga Ministria përgjegjëse rezulton, se etiketa e produkteve është lëshuar nga prodhuesi Becker Microbials Products për Mbajtësin e Autorizimit "Egian Med" SHPK.

Pra, referuar dokumentacionit të administruar pjesë e fashikullit të shqyrtimit administrativ nuk rezulton që dokumentacioni të jetë lëshuar nga shoqëria CERA SAS Francë, por drejtëdrejtë nga prodhuesi, shoqëri e cila i nënshtrohet legjislacionit federal në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ndaj, KPP, në këto kushte i drejtojë 7 pyetje Agjencisë së Mbrojtjes së Mjedisit si më poshtë vijon:

1. *Cili është legjislacioni në Shtetet e Bashkuara të Amerikës për regjistrimin e produkteve biocide? Cili është institucioni/et përgjegjës/e i cili regjistron këto produkte dhe lëshon autorizim/ miratimin për tregëtim ose dokumentacion ekuivalent me këtë?*

2. A është produkti AQUABAC® 200G i regjistruar pranë EPA (Agjencia e Mbrojtjes së Mjedisit) në Shtetet e Bashkuara të Amerikës me nr. Regjistrimi të EPA 62637-3?
3. Cila është etiketa e regjistruar pranë EPA në shtetet e Bashkuara të Amerikës për produktin AQUABAC® 200G?
4. A është produkti AQUABAC® DF3000 i regjistruar pranë EPA (Agjencia e Mbrojtjes së Mjedisit) në Shtetet e Bashkuara të Amerikës me nr. Regjistrimi të EPA 62637-14?
5. Cila është etiketa e regjistruar pranë EPA në shtetet e Bashkuara të Amerikës për produktin AQUABAC® DF3000?
6. Referuar legjislacionit në fuqi në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në rast të ndryshimit të përmbajtjes së etiketës, a duhet këto të fundit të regjistrohen në EPA?
7. A janë etiketat për produktet AQUABAC® 200G dhe AQUABAC® DF3000 bashkëngjitur kësaj shkrese të regjistruara/ miratuara në EPA në datën 10.12.2022 datë e aplikimit pranë institucioneve shqiptare të shoqërisë “Egian Med” SHPK për paisjen me autorizim importi për lëndët DDD (dezinfektuese, deratizuese, dezinfektuese dhe/ose lëndët për trajtimin e ujit të pijshëm) ?

III.1.13. Në datën 26.09.2023, në rrugë elektronike, Komisioni u informua nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës mbi trajtimin e kërkesës nga Agjencia e Mbrojtjes së Mjedisit me përmbajtje si më poshtë vijon:

"Ju lutemi të gjeni më poshtë përgjigjet e EPA-së lidhur me pyetjet që na keni drejtuar. Përgjigjet e EPA-së për pyetjet tuaja janë të shënuara me ngjyrë të kuqe më poshtë, për lehtësi referimi. Shpresoj që këto përgjigje të jenë me dobi për ju.

[...]

Nga EPA-ja:

Ju lutemi të vini re se kjo çështje i është referuar edhe Zyrës sonë të Ekzekutimit dhe Sigurimit të Përmbushjes, duke qenë se ka pasur pretendime të pamiratuara për këto etiketa të veçanta të dy insekticideve të Becker Microbial Products. Me poshtë po ju japim përgjigje pyetjeve të Komisionit të Prokurimit Publik:

1.Çfarë legjislacioni ka për regjistrimin e biocideve në Shtetet e Bashkuara (Shënim: Adresat ku mund të gjejmë informacionin mjaftojnë. Fundi i Shënimit)? Cili është emri i institucionit/institucioneve përgjegjëse për regjistrimin e këtyre produkteve (emri dhe adresa e internetit e institucionit/agjencisë mjafton)? Cili është emri i institucionit që lëshon autorizimet (ose dokument të barasvlerëshëm) për produktet që hidhen në treg (emri dhe adresa e internetit e institucionit mjafton)?

- *Në kuadër të Aktit Federal për Insekticidet, Fungicidet dhe Helmet kundër Breytësve (FIFRA), EPA normon lëndët që përdoren si pesticide (40 CFR § 152.15). Pesticidi është (1) çdo lëndë (ose përzierje lëndësh) me qëllim parandalimin, shkatërrimin, largimin, ose zbutjen e dëmtuesve; (2) çdo lëndë (ose përzierje lëndësh) që përdoren si rregullator bimësh, si zhveshës gjethesh, ose tharës; dhe (3) çdo stabilizues azoti. Përpara se një pesticid të shitet ose të shpërndahet në SHBA, ai duhet të regjistrohet nga EPA-ja.*

2. A është i regjistruar AQUABAC®200G nga EPA-ja në Shtetet e Bashkuara me numër regjistrimi EPA 62637-3? Ju lutemi na siguroni adresën e internetit për regjistrimin.

3. Çfarë etikete është regjistruar me EPA-në në Shtetet e Bashkuara për produktin AQUABAC®200G? Ju lutemi na siguroni adresën e internetit ku mund të gjejmë etiketën.

- Në përgjigje të pyetjeve 2 dhe 3, po, produkti është aktualisht i regjistruar me EPA-në. Etiketa kryesore më e fundit e pranuar mund të gjendet duke kërkuar Sistemin tonë publik të Produkteve Pesticide dhe Etiketave (PPLS) me numër regjistrimi EPA 62637-3 (jepet adresa e internetit për etiketën kryesore më të fundit të pranuar). Do të vini re se emri kryesor tregtar është BMP 144 (200G), megjithatë, për qartësi Aquabac (200G) është emër tregtar alternativ i pranueshëm.

- Etiketa përfundimtare në treg lejohet të jetë pak më ndryshe nga etiketa kryesore e pranuar (p.sh. etiketa përfundimtare tregtare mund të përfshijë një pjesë të çka përfshihet në etiketën kryesore të pranuar).

- Megjithatë, me sa jam në dijeni, EPA nuk ka miratuar pretendimin e barasvlershmërisë së variantit në deklaratën e përbërësve për insekticidin BMP 144 (200G) të Becker Microbial Products. Kështu, etiketa e produktit Aquabac (200G) që na keni vënë në dispozicion nuk është kopje e vërtetë dhe e saktë e etiketës së produktit të miratuar nga EPA-ja.

4. A është regjistruar AQUABAC® DF3000 me EPA-në me numër regjistrimi EPA 62637-14? Ju lutemi na siguroni adresën e internetit për regjistrimin.

5. Çfarë etikete është regjistruar me EPA-në në Shtetet e Bashkuara për produktin AQUABAC®DF3000? Ju lutemi na siguroni adresën e internetit ku mund të gjejmë etiketën.

- Në përgjigje të pyetjeve 4 dhe 5, produkti aktualisht i regjistruar me EPA-në si Regjistrim EPA # 62637-14 është i miratuar me emër parësor tregtar "BMP 144 DF 3000" (emri alternativ tregtar "AQUABAC ËDG 3000"). Si në rastin e produktit të mësipërm, mund ta gjeni duke kërkuar PPLS-në me numër regjistrimi 62637-14 (jepet adresa e internetit për etiketën kryesore më të fundit të pranuar).

- Në këtë rast, Aquabac DF3000 nuk duket të jetë emër alternativ tregtar i miratuar sipër dokumentacionit tonë. Megjithatë, ata mund të mos përdorin të njëjtin emër në SHBA dhe miratimi përkatës është proces i thjeshtë.

- Edhe në këtë rast, EPA nuk ka miratuar pretendimin e barasvlershmërisë së variantit në deklaratën e përbërësve për insekticidin BMP 144 DF 3000 të Becker Microbial Products. Kështu, etiketa e produktit Aquabac DF3000 që na keni vënë në dispozicion nuk është kopje e vërtetë dhe e saktë e etiketës së produktit të miratuar nga EPA-ja.

6. Bazuar në legjislacionin në fuqi në Shtetet e Bashkuara, nëse përmbajtja e etiketës ndryshon, a duhet shoqëria të regjistrojë këtë ndryshim me EPA-në?

- Po, zakonisht nëse regjistruesi dëshiron të bëjë ndryshime në etiketë ose formulim, ata duhet të njoftojnë EPA-në lidhur me ndryshimet e propozuara. Vetëm disa ndryshime shumë të vogla mund të bëhen pa njoftuar EPA-në. Megjithatë, shumica dërrmuese e ndryshimeve të propozuara kërkojnë që regjistruesi t'i nënshtrohet procesit të njoftimit ose ndryshimit të EPA-së.

7. A janë regjistruar dhe miratuar ETIKETAT e bashkëngjitura të produkteve AQUABAC®200G dhe AQUABAC® DF3000 nga EPA më 10 dhjetor 2022, datë në të cilën këto dokumente janë dorëzuar nga një shoqëri shqiptare në autoritetet shqiptare për përfitim e autorizimit për import? NËSE PO, ju lutemi na dërgoni adresën e internetit ku mund të gjejmë këto etiketa.

- *Megjithëse Regjistrimi i EPA-së # 62637-3 dhe Regjistrimi i EPA # 62637-14 janë produkte të regjistruara (etiketat kryesore më të fundit të miratuara për secilin mund t'i shihni në adresat e internetit më sipër), etiketat në fjalë përfshijnë pretendime barasvlershmërie që nuk janë miratuar.”*

III.1.14. Në bazë të nenit 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, e drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit. Ndaj, në kushtet kur dokumentacioni i operatorit ekonomik “Egian Med” SHPK i nënshtrohet ligjit të një shteti të huaj, Komisioni kërkoi informacion mbi rregullimin ligjor të regjistrimit të lëndëve biocide në Shtet e Bashkuara të Amerikës. Referuar kthimit të përgjigjes së Agjencisë së Mbrojtjes së Mjedisit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, rezulton se *“Në kuadër të Aktit Federal për Insekticidet, Fungicidet dhe Helmet kundër Brejtësve (FIFRA), EPA normon lëndët që përdoren si pesticide (40 CFR § 152.15). Pesticidi është (1) çdo lëndë (ose përzierje lëndësh) me qëllim parandalimin, shkatërrimin, largimin, ose zbutjen e dëmtuesve; (2) çdo lëndë (ose përzierje lëndësh) që përdoren si rregullator bimësh, si zhveshës gjethesh, ose tharës; dhe (3) çdo stabilizues azoti. Përpara se një pesticid të shitet ose të shpërndahet në SHBA, ai duhet të regjistrohet nga EPA-ja.”* Pra referuar kthim - përgjigjes, lëndët pesticide para shpërndarjes në SHBA regjistrohen pranë EPA. Kjo pyetje e drejtuar nga Komisioni i Prokurimit Publik lidhet me vërtetimin e kriterit të posaçëm të kualifikimit të vendosur në shtojcën e dokumenteve të procedurës së prokurimit ku parashikohet se: *“Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatën ose dokumentin e rregjistrimit vetëm në rastin e produkteve biocide në një prej vendeve e percaktuara ne Ligjin 95/2015 “Për shërbimet dhe produktet biocide në shëndetin publik”.* Ndërkohë në nenin 8 pika 4 të ligjit nr.95/2015 *“Për shërbimet dhe produktet biocide në shëndetin publik”* parashikohet se *“4. Autorizimi për vendosjen në treg të produkteve biocide lëshohet për: a) produkte biocide të prodhuara në vend; b) produkte biocide të autorizuara në njërin nga vendet e Bashkimit European, në Zvicër, SHBA, Kanada, Japoni, Turqi, Izrael dhe Australi; c) produktet biocide të prodhuara dhe të autorizuara në vendet e Ballkanit.”* Në rastin konkret, produkti në fjalë i nënshtrohet rastit të paragrafit b të pikës 4 të nenit 8.

Pra, rregullat federale kërkojnë që produkti biocid para shpërndarjes në SHBA duhet të jetë i regjistruar. Pas informacionit mbi rregullimin e përgjithshëm, Komisioni i drejtoi Agjencisë së Mbrojtjes së Mjedisit në SHBA edhe dy pyetje konkrete në lidhje me produktet e dorëzuara nga shoqëria Egian Med ShPK në procedurën e prokurimit publik. Konkretisht është drejtuar pyetja me nr. 2, 3, 4 dhe 5 si më poshtë vijon: 2. *A është i regjistruar AQUABAC®200G nga EPA-ja në Shtetet e Bashkuara me numër regjistrimi EPA 62637-3? Ju lutemi na siguroni adresën e internetit për regjistrimin.*

3. *Çfarë etikete është regjistruar me EPA-në në Shtetet e Bashkuara për produktin AQUABAC®200G? Ju lutemi na siguroni adresën e internetit ku mund të gjejmë etiketën.*

4. *A është regjistruar AQUABAC® DF3000 me EPA-në me numër regjistrimi EPA 62637-14? Ju lutemi na siguroni adresën e internetit për regjistrimin.*

5. *Çfarë etikete është regjistruar me EPA-në në Shtetet e Bashkuara për produktin AQUABAC®DF3000? Ju lutemi na siguroni adresën e internetit ku mund të gjejmë etiketën.*

Në trajtimin e kërkesës, Agjencia e Mbrojtjes së Mjedisit (shkurt EPA- si ankronim Environmental Protection Agency) shprehet se:

Në përgjigje të pyetjeve 2 dhe 3, po, produkti është aktualisht i regjistruar me EPA-në. Etiketa kryesore më e fundit e pranuar mund të gjendet duke kërkuar Sistemin tonë publik të Produkteve Pesticide dhe Etiketave (PPLS) me numër regjistrimi EPA 62637-3 (jepet adresa e internetit për etiketën kryesore më të fundit të pranuar). Do të vini re se emri kryesor tregtar është BMP 144 (200G), megjithatë, për qartësi Aquabac (200G) është emër tregtar alternativ i pranueshëm.

- *Etiketa përfundimtare në treg lejohet të jetë pak më ndryshe nga etiketa kryesore e pranuar (p.sh. etiketa përfundimtare tregtare mund të përfshijë një pjesë të çka përfshihet në etiketën kryesore të pranuar).*

- ***Megjithatë, me sa jam në dijeni, EPA nuk ka miratuar pretendimin e barasvlershmërisë së variantit në deklaratën e përbërësve për insekticidin BMP 144 (200G) të Becker Microbial Products. Kështu, etiketa e produktit Aquabac (200G) që na keni vënë në dispozicion nuk është kopje e vërtetë dhe e saktë e etiketës së produktit të miratuar nga EPA-ja.***

Në përgjigje të pyetjeve 4 dhe 5, produkti aktualisht i regjistruar me EPA-në si Regjistrim EPA # 62637-14 është i miratuar me emër parësor tregtar "BMP 144 DF 3000" (emri alternativ tregtar "AQUABAC ËDG 3000"). Si në rastin e produktit të mësipërm, mund ta gjeni duke kërkuar PPLS-në me numër regjistrimi 62637-14 (jepet adresa e internetit për etiketën kryesore më të fundit të pranuar).

- *Në këtë rast, Aquabac DF3000 nuk duket të jetë emër alternativ tregtar i miratuar sipër dokumentacionit tonë. Megjithatë, ata mund të mos përdorin të njëjtin emër në SHBA dhe miratimi përkatës është proces i thjeshtë.*

- ***Edhe në këtë rast, EPA nuk ka miratuar pretendimin e barasvlershmërisë së variantit në deklaratën e përbërësve për insekticidin BMP 144 DF 3000 të Becker Microbial Products. Kështu, etiketa e produktit Aquabac DF3000 që na keni vënë në dispozicion nuk është kopje e vërtetë dhe e saktë e etiketës së produktit të miratuar nga EPA-ja.***

III.1.15. Pra, referuar trajtimit të kërkesës së mësipërme, Agjencia e Mbrojtjes së Mjedisit sqaron, se është detyrim ligjor regjistrimi i etiketave të produkteve biocide pranë kësaj agjencie dhe se kjo agjenci e cila është edhe institucioni përgjegjës për regjistrimin e produkteve biocide në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, pra vendit të lëshimit të etiketës e cila është dorëzuar edhe si përmbushje e kriterëve të vecanta të kualifikimit në procedurën e prokurimit objekt - ankimi (konkretisht kriterin. *Operatori ekonomik duhet të paraqesë etiketat/katalogët/skedat teknike dhe Dokumentin e te dhënave të Sigurisë për të gjitha produktet biocide ose jo biocide (barriera fizike etj.) në gjuhën shqip dhe anglisht*), por edhe si pjesë integrale e dosjes së aplikimit për autorizim të produktit biocid.

Gjithashtu, KPP kërkoi sqarime përmes pyetjes me numër rendor 6 nëse “Bazuar në legjislacionin në fuqi në Shtetet e Bashkuara, nëse përmbajtja e etiketës ndryshon, a duhet shoqëria të regjistrojë këtë ndryshim me EPA-në?” Referuar trajtimit të kërkesës rezultoi se: *Po, zakonisht nëse regjistruesi dëshiron të bëjë ndryshime në etiketë ose formulim, ata duhet të njoftojnë EPA-në lidhur me ndryshimet e propozuara. Vetëm disa ndryshime shumë të vogla mund të bëhen pa njoftuar EPA-në. Megjithatë, shumica dërrmuese e ndryshimeve të*

propozuara kërkojnë që regjistruesi t'i nënshtrohet procesit të njoftimit ose ndryshimit të EPA-së.

Pra, në rast të ndryshimeve të përmbajtjes së etikës, prodhuesi i nënshtrohet një procesi të njoftimit ose ndryshimit në institucionin përgjegjës EPA.

Së fundmi, Komisioni vlerësoji të verifikojë edhe dokumentin e dorëzuar (etiketë e produkteve) në përmbushje të kriteve të veçanta të kualifikimit, por edhe si dokumentacion i dorëzuar nga operatori ekonomik “Egian Med” ShPK në rast se ky i fundit është i regjistruar në EPA. Në kthim përgjigje Agjencia e Mbrojtjes së Mjedisit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës deklaroi se: *Megjithëse Regjistrimi i EPA-së # 62637-3 dhe Regjistrimi i EPA # 62637-14 janë produkte të regjistruara (etiketat kryesore më të fundit të miratuara për secilin mund t'i shihni në adresat e internetit më sipër), etiketat në fjalë përfshijnë pretendime barasvlershmërie që nuk janë miratuar.”*

III.1.16. Referuar fakteve dhe provave si edhe dokumentacionit të administruar në fashikullin e shqyrtimit administrativ, rezulton se operatori ekonomik Egian Med ShPK ka marrë pjesë në procedurën e prokurimit objekt – ankimi, duke paraqitur etiketat e një produkti të regjistruar në regjistrat publikë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Gjithashtu, rezulton e provuar se dokumentacioni në lidhje me etiketat e dorëzuara nuk rezulton të jetë lëshuar nga distributori i shoqërisë CERA SAS, por nga vetë prodhuesi i cili është një shoqëri e regjistruar në regjistrat publikë amerikanë. Si rrjedhojë dokumentacioni i lëshuar nga kjo shoqëri i nënshtrohet legjislacionit federal. KPP kërkoi informacion nga institucioni përgjegjës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, verifikim i kryer përmes Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shqipëri. Nga trajtimi i kërkesës nga Agjencia e Mbrojtjes së Mjedisit në mënyrë të përmbledhur rezulton se:

- a) legjislacioni federal detyron shoqëritë tregtare amerikane të regjistrojnë produktet biocide pranë Agjencisë së Mbrojtjes së Mjedisit (EPA).
- b) Së bashku me regjistrimin regjistrohen edhe të dhënat e etiketës dhe në rast të ndryshimeve të etiketës këto të fundit i nënshtrohen procesit të njoftimit.
- c) Produktet biocide të prodhuesit Becker Microbials Products në Amerikë me emërtim Aquabac 200 G dhe Aquabac 3000DF dhe me emërtim janë të regjistruar në regjistrat e EPA, por etiketa e regjistruar nuk është e njëjtë me atë të dorëzuar në procedurën e prokurimit, pasi *etiketat në fjalë përfshijnë pretendime barasvlershmërie që sipas EPA nuk janë miratuar.”*

III.1.17. Sa më sipër, nga shqyrtimi i dokumentave të tendertit, konstajmë, se një ndër kërkesat për kualifikim është paraqitja e etiketave origjinale të produktit Biocid. Nisur nga pretendimet e ankimuesit, Komisioni referuar verifikimeve të kryera nga institucionet publike të shtetit Amerikan, ku ndër të tjera theksohet se “*EPA nuk ka miratuar pretendimin e barasvlershmërisë së variantit në deklaratën e përbërësve për insekticidin BMP 144 (200G) të Becker Microbial Products. Kështu, etiketa e produktit Aquabac (200G) që na keni vënë në dispozicion nuk është kopje e vërtetë dhe e saktë e etiketës së produktit të miratuar nga EPA-ja. [...] dhe EPA nuk ka miratuar pretendimin e barasvlershmërisë së variantit në deklaratën e përbërësve për insekticidin BMP 144 DF 3000 të Becker Microbial Products. Kështu, etiketa e produktit*

Aquabac DF3000 që na keni vënë në dispozicion nuk është kopje e vërtetë dhe e saktë e etiketës së produktit të miratuar nga EPA-ja”.

III.1.18. Pra, sa më sipër, konstatohet se institucionet përgjegjëse në shtetin amerikan, të cilat lëshojnë etiketa për produktet e kërkuara, deklarojnë se produktet Aquabac (200G) Aquabac DF3000 në etiketat e regjistruara në këto regjistra, nuk shprehen mbi ekuivalencën me shtamin AM65-52. KPP nënvizon faktin, se në rastin konkret qëllimi përfundimtar i autoritetit kontraktor është kryerja e shërbimit të dezinfektimit në zonat bregdetare dhe urbane. Referuar procedurës konkrete objekt-shqyrtimi, konstatohet, se blerja e mallit nga subjektet të cilat ofrojnë shërbimin objekt-prokurimi, ka një rregullim të posaçëm ligjor dhe kryhet sipas disa procedurave specifike, duke u shoqëruar me dokumentacion përkatës, për vendosjen e tyre në treg (Ligji 95/2015 “Për shërbimet dhe produktet biocide në shëndetin publik” dhe rregullat në zbatim të tij). Gjithashtu, operatori ekonomik “Egian Med” ShPK ka dorëzuar edhe Aktin e Autorizimit nr. 1 dhe nr.2 datë 17.01.2023 lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ku pjesë e dokumentacionit referuar kreut III të VKM 933, datë 25.11.2020 “Për përcaktimin e rregullave për kriteret e vlerësimit të Produkteve biocide dhe të procedurës së dhënies së Autorizimit të vendosjes së tyre në treg”, pika 1 gërma ‘ë’ “Etiketën përkatëse të produktit biocid, në përputhje me përcaktimet e vendimit nr. 487, datë 29.6.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për klasifikimin e produkteve biocide”;

Pra dokumentacioni i dorëzuar nga operatori ekonomik “Egian Med” ShPK nuk është i njëjtë me dokumentacionin e dorëzuar për të njëjtin produkt në vendin e origjinës. Gjithashtu, nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, KPP-së i është vënë në dispozicion edhe një komunikim elektronik, ku Ministria e Shëndetësisë në datë 20 korrik 2023 ka pyetur me anë të emailit prodhuesin. Ky i fundit ka deklaruar se cituar ndër të tjera (përkthyer në shqip nga Komisioni i Prokurimit Publik) citojme “...tjetra është etiketa shqiptare (përgatitur në bazë të kërkesave të autoriteti kontraktor) për produkte që ka vendosur në tregun shqiptar”.

Pra, vetë prodhuesi pranon, se për tregun shqiptar ka dorëzuar një etiketë të posaçme (përgatitur në përputhje me kërkesat e autoritetit përgjegjës) për produktet që do të vendosen në tregun vendas. Ndërkohë, vetë ligji për produktet biocide pranon regjistrimin në tregun vendas të atyre produkte biocide të autorizuara në njërin nga vendet e Bashkimit Europian, në Zvicër, SHBA, Kanada, Japoni, Turqi, Izrael dhe Australi. Pra ligji nuk autorizon asnjë autoritet kompetent në Shqipëri sipas emailit të prodhuesit që të kërkojë akte të ndryshme nga ato që parashikon vetë ligji, ndërkohë ligji kërkon që produkti të jetë regjistruar në njërin nga vendet e listuara, përfshirë pra edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Në rastin konkret, KPP nënvizon faktin se në rastin konkret kemi të bëjmë me një shërbim specifik me risk të posaçëm për ndikim jo vetëm në jetën dhe shëndetin por edhe në mjedisin. Ndaj ligjvënësi përcakton në nenin 17 të ligjit 95/2015 “Për shërbimet dhe produktet biocide në shëndetin publik”, se përdoruesit e produkteve biocide, gjatë ofrimit të shërbimeve biocide në shëndetin publik, kanë këto përgjegjësi: a) të mos rrezikojnë jetën e tyre, jetën e të tjerëve dhe të mos shkaktojnë ndikime të dëmshme në shëndetin e njeriut, kafshëve dhe në mjedis.

Sa më sipër, analizuar, KPP vlerëson, se dokumentacioni i dorëzuar nga operatori ekonomik “Egian Med” ShPK në përmbushje të kriterëve të veçanta të kualifikimit, jo vetëm që çënon integritetin dhe ruajtjen e besimit të publikut në procedurat e prokurimit, por përbën një

dokumentacion të lëshuar jo në përputhje me legjislacionin në fuqi në vendin e origjinës si një dokumentacion i rremë për qëllime kualifikimi.

Së fundmi, sa më sipër arsyetuar, gjykojmë se ky rast duhet referuar për hetim pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si institucion përgjegjës në shtetin shqiptar, i cili ka lëshuar autorizimet për vendosjen në treg të produkteve biocide Aquabac (200G) dhe Aquabac DF3000, për sa kohë dokumentacioni i dyshuar i rremë (si më sipër argumentuar) është pjesë e dosjes së aplikimit nga operatori ekonomik “Egian Med” SHPK, për pajisjen me këto autorizime nga MSHMS.

Gjithashtu, referuar çështjeve të mësipërme, KPP gjykon, se ky rast duhet t’i referohet Agjencisë së Prokurimit Publik për nisjen e hetimit administrativ bazuar në nenin 23 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, për sa kohë rezulton, se një operator ekonomik ka paraqitur në një procedurë prokurimi dokumentacion të rremë për qëllime kualifikimi.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “NRG” SHPK për parregullsi të procedurës së prokurimit, *“Konsideruar sa më sipër, arrijmë në konkluzionin që profesionaliteti dhe njohurite ë fushës dhe ato juridike të anëtarëve të KVO lënë shumë për të dëshiruar, apo në të kundërt kanë mbyllur sytë qëllimish. Specialistët e ISHP që hartuan specifikimet teknike sipas VKM nr 933 datë 25.11.2020 E.R dhe Z.S qëllimisht nuk e kishin përcaktuar shtamin e produktit bti në dokumentat e tenderit madje nuk kishin vendosur asnjë kriter kualifikimi teknik për produktin. themi qëllimisht pasi vetëm në këtë mënyrë do të favorizonin duke marrë guximin të kualifikonin OE Egian Med shpk dhe pse produkti I tij është I pavlefshëm pasi nuk është në listen e përbërësve aktivë të miratuar në Republikën e Shqipërisë. Jo më kot është E.R që përgatit specifikimet teknike të tenderit dhe merr pjesë gjithashtu në grupin që lëshon Autorizim importi. Të dy këta punonjës të ISHP në bashkëpunim me njëri tjetrin kanë shpërdoruar detyrën duke ndihmuar OE Egian Med të regjistrojë produktet Aquabac dhe për këto veprime shoqëria jonë do të kërkojë përgjegjësitë penale pranë institucioneve kompetente [...].*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Me anë të shkresës nr. 714/1 prot., datë 25.07.2023, protokolluar pranë KPP-së me nr.1610/7 prot., datë 28.07.2023, Instituti i Shëndetit Publik na vendos në dijeni se: *“[...] Sqarojmë se z.R nuk është pjesë përbërëse e Komisionit për Autorizimin e Produkteve Biocide. Bazuar ne VKM nr.933, datë 25.11.2020, Instituti I Shëndetit Publik nuk ka të drejtë vendimmarrje për dhënie e Autorizimeve të Produkteve Biocide, por I jep mendim MSHMS në bazë të një vlerësimi që kryhet nga specialistet përkatës për çdo produukt biocid. Ky mendim më pas shqyrtohet nga Komisioni për Autorizimin e Produkteve Biocide në MSHMS. Z. E.R nuk kryen vlerësimin e PB insecticide (PT 18) në kuadër të procedurës së autorizimit të produkteve biocide. Në lidhje me specifikimet teknike për këtë procedurë, nuk ka patur kërkesa për sqarime apo ankimime lidhur me këto specifikime pas publikimit të procedurës. Në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt Shërbim dezinfektimi në zonat bregdetare dhe urbane, të kryer nga Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara, Z. Rnuk është pjesë e Komisionit të Vlerësimit të Ofertavr për këtë procedurë.”*

III.2.2. Neni 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikon se:
Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik”.*

Neni 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikon se:

- 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën”.*

Neni 18 “Mbrojtja e integritetit të procedurës dhe masat e përgjithshme për parandalimin e korrupsionit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikon se: “*1. Prokurimi publik duhet të zhvillohet në mënyrë transparente me paanshmëri dhe pa asnjë trajtim preferencial. Procedurat e prokurimit duhet të kërkojnë standardet më të larta të etikës dhe besimit publik. Në çdo rast duhet të shmangët rreptësisht çdo konflikt interesi ose edhe shfaqja e një konflikti interesi, në marrëdhëniet e titullarit të autoritetit kontraktor, punonjësit të angazhuar në procesin e prokurimit dhe operatorit ekonomik, sipas legjislacionit në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike. 2. Punonjësit e autoritetit ose entit kontraktor, të angazhuar në përgatitjen e dokumenteve të tenderit nuk mund të jenë ofertues ose anëtarë në një grup ofertuesish në procedurën e prokurimit. 3. Autoriteti ose enti kontraktor është i detyruar të marrë të gjitha masat e nevojshme në procesin e planifikimit, në procedurën e prokurimit publik dhe në zbatimin e kontratës, me qëllim zbulimin në kohë të korrupsionit dhe eliminimin e pasojave të dëmshme të korrupsionit. 4. Çdo zyrtar i angazhuar në procesin e prokurimit nga autoriteti ose enti kontraktor dhe çdo palë e interesuar që ka informacione për korrupsionin është i detyruar të informojë organet kompetente. 5. Operatorët ekonomikë me veprimet e tyre nuk duhet të shkelin parimet e konkurrencës, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi”.*

Neni 21 Autoriteti ose enti kontraktor të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikon se: “*1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti*

kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi”.

III.2.3. Në nenin 108 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë” parashikohet se: *“Neni 108 Akti administrativ absolutisht i pavlefshëm Akti administrativ është absolutisht i pavlefshëm në rastet e mëposhtme:*

a) kur vjen në kundërshtim të hapur dhe flagrant me një dispozitë urdhëruese të këtij Kodi dhe legjislacionit në fuqi lidhur me:

i) kompetencën e organit publik;

ii) procedurën e nxjerrjes së tij; ose

iii) formën ose elementë të tjerë të detyrueshëm të aktit;

b) është nxjerrë nëpërmjet mashtrimit, kanosjes, mitmarrjes, konfliktit të interesit, falsifikimit apo një veprimi tjetër që përbën vepër penale;

c) ekzekutimi i aktit mund të shkaktojë një veprim të dënueshëm, sipas legjislacionit penal;

ç) në çdo rast tjetër të parashikuar shpre-himisht në ligj”.

III.2.4. Një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Gjithashtu, referuar dispozitave ligjore të sipërcituara, ligji parashikon për herë të parë në një nen të posaçëm, mbrojtjen e integritetit të procedurës. Gjithashtu, autoriteti ose enti kontraktor është i detyruar marrë të gjitha masat e nevojshme në procesin e planifikimit në procedurën e prokurimit publik dhe në zbatimin e kontratës, me qëllim zbulimin në kohë të korrupsionit apo konfliktit të interesit dhe eliminimin e pasojave të dëmshme të arrdhura si rrjedhojë apo pasojë të këtyre konstatimeve. Me qëllim, shmangien e konfliktit të interesit në procesin e prokurimit, ligji nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” parashikon detyrimin e autoriteteve për marrjen e masave të përshtatshme për të parandaluar, identifikuar dhe korrigjuar rastet e konfliktit, si dhe për të shmangur shtrembërimin e konkurrencës, e për të garantuar trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomikë.

KPP referuar pretendimeve të ankimuesit, për sa kohë ky i fundit gjykon, se procedura e prokurimit është zhvilluar në shkelje të ligjit, KPP në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 618, datë 20.10.2021 “Për krijimin, organizimin, e funksionimin e rrjetit të koordinatorëve kundër korrupsionit” gjykon, se ky rast duhet t’iu referohet të tjera institucioneve të posaçme, konkretisht Rrjetit të Koordinatorëve Kundër Korrupsionit.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “NRG” SHPK për skualifikimin e operatorit ekonomik “Egian Med” SHPK me argumentin, se *“Në dokumentat e tenderit është kërkuar: **Shënim:** Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike- financiare (nënpika 1 e seksionit 2.2 të kriterëve të veçanta për*

kualifikim0 si dhe kapacitetet teknike (nënpika 1) të kriterëve të veçanta për kualifikim), sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku. Në këtë rast, operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të paraqesë një deklaratë ku të listohen dokumentet e paraqitura në përmbushje të kriterëve kumulative për Lotin konkret. Në rast se dokumentacioni I deklaruar dhe I dorëzuar në përmbushje të kriterëve kumulative nuk plotëson kapacitetet ekonomik-financiare dhe kapacitetet teknike për të gjitha lotet ku operatori ekonomik ka ofertuar, do të kualifikohet vetëm në atë lot ku oferta e tij është ekonomikisht më e favorshme. Nga klasifikimi I ofertave rezulton se OE “Egjan Med” SHPK ka marrë pjesë në procedurën e prokurimit me:

- Nr. REF-66559-04-19-2023, me objekt Loti 4- me objekt “Shërbim Dezinsektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Qarku Durrës”, me fond limit 15.479.671 lekë pa TVSH.
- Nr. REF- 66562-04-19-2023, me objekt Loti 5 – me objekt: “Shërbim Dezinsektimi zonat bregdetare dhe urbane, Qarku Fier”, me fond limit 21.673.080 lekë pa TVSH.
- Nr. REF-66564-04-19-2023, me objekt Loti 6- me objekt: “Shërbim Dezinsektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Qarku Vlorë”, me fond limit 46.165.933 lekë pa TVSH.

Duke qënë se ky OE ka ofertuar në më shumë se një lot duhet të paraqiste në ofertë një deklaratë ku të listoheshin dokumentet e paraqitura në përmbushje të kriterëve kumulative për lotin konkret, deklaratë e cila është paraqitur nga ky OE në secilin lot ku ka ofertuar.

Në dokumentat e tenderit parashikohet se **“Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim”**.

Sa më sipër oferta e këtij OE duhet të skualifikohet për mospërmbushjen e këtij kriteri kualifikimi.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në dokumentet e tenderit, shtojca 8, “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, për Lotin 5, “Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë”, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

[...]

Shënim: Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike – financiare (nënpika 1 e seksionit 2.2, të kriterëve të veçanta për kualifikim) si dhe kapacitetet teknike (nënpikat 1), të kriterëve të veçanta për kualifikim), sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku. Në këtë rast, operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të paraqesë një deklaratë ku të listohen dokumentet e paraqitura në përmbushje të kriterëve kumulative për Lotin konkret. Në rast se dokumentacioni i deklaruar dhe i dorëzuar në përmbushje të kriterëve kumulative nuk plotëson kapacitetet ekonomike - financiare dhe kapacitetet teknike për të gjitha Lotet ku operatori ekonomik ka ofertuar, do të kualifikohet vetëm në atë Lot ku oferta e tij është ekonomikisht më e favorshme.

III.3.2. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (S.P.E.) për plotësimin e kriterit të mësipërm, operatori ekonomik ankimues “Egjan Med” SHPK ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Deklaratë mbi përmbushjen e kriterëve kumulative, datë 12.06.2023, ku ndër të tjera citohet: “[...] Shoqëria “Egjan Med” SHPK ka paraqitur ofertën e saj për 3 Lote të Procedurës së hapur mbi kufirin e lartë monetar” Marrëveshje kuadër me disa operatorë ekonomikë ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara me REF-66549-04-19-2023 e konkretisht:

- *Loti 4 – me objekt: “Shërbim Dezinsektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Qarku Durrës” – në të cilin merr pjesë si bashkim operatorësh ekonomik;*
 - *Loti 5 – me objekt: “Shërbim Dezinsektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Qarku Fier”*
 - *Loti 6 – me objekt “Shërbim Dezinsektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Qarku Vlorë”*
- *Shoqëria plotëson në kumulativ kriterin në lidhje me xhiron vjetore, pasi vetëm për vitin 2020 shoqëria “Egian Med” SHPK ka mbi 80,000,000 Lekë xhiro të realizuar nga 32,127,474 lekë të kërkuar në DT.*
 - *“Egian Med” SHPK, ka realizuar dhe ka hedhur tek te 3 Lotet e mësipërme fatura tatimore dhe vërtetime për realizimin e shërbimeve të ngjashme të realizuara në 3 vitet e fundit nga datae publikimit më tepër se vlera minimale e kërkuar nga AK.*
 - *Janë hedhur tek 3 lotet në SPE të gjitha faturat dhe vërtetimet e ngjashme të realizuara në periudhën nga data 20.04.2020 deri më datë 19.04.2023.”*

III.3.3. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.3.4. Sa më sipër, referuar kriterit të mësipërm të kualifikimit, konstatohet se autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht që *“Shënim: Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike – financiare (nënpika 1 e seksionit 2.2, të kriterëve të veçanta për kualifikim) si dhe kapacitetet teknike (nënpikat 1), të kriterëve të veçanta për kualifikim), sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku. Në këtë rast, operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të paraqesë një deklaratë ku të listohen dokumentet e paraqitura në përmbushje të kriterëve kumulative për Lotin konkret.*

Në rast se dokumentacioni i deklaruar dhe i dorëzuar në përmbushje të kriterëve kumulative nuk plotëson kapacitetet ekonomike - financiare dhe kapacitetet teknike për të gjitha Lotet ku operatori ekonomik ka ofertuar, do të kualifikohet vetëm në atë Lot ku oferta e tij është ekonomikisht më e favorshme". Pra, sa më sipër, autoriteti kontraktor kërkon që, në rastin kur operatori ekonomik ofertues merr pjesë në më shumë se një Lot, atëherë ky i fundit duhet të paraqesë një deklaratë ku të listojë dokumentet e paraqitura në përmbushje të kriterëve kumulative për Lotin konkret.

III.3.5. Komisionit të Prokurimit Publik pas shqyrtimit në tërësi të dokumentacionit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi i rezulton, se procedura në fjalë është procedurë e ndarë në lote. Gjithashtu, nga verifikimi i loteve të publikuara si dhe databazës së regjistrit të ankesave rezulton, se operatori ekonomik ankimues "Egian Med" SHPK rezulton pjesëmarrës (ofertues) në Lotin 4, Lotin 5 dhe Lotin 6,

Pra sa më sipër, operatori ekonomik "Egian Med" SHPK, duke qenë së është pjesëmarrës në tre lote të kësaj procedure prokurimi, ka dorëzuar një deklaratë, ku deklaron lotet në të cilat merr pjesë, si dhe ka deklaruar në mënyrë të përgjithshme dokumentacionin e dorëzuar në lidhje me to, në përmbushje të kriterëve kumulative. Në rastin konkret, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik "Egian Med" SHPK, konstatohet se ky i fundit ka dorëzuar dokumentin "Deklaratë mbi përmbushjen e kriterëve kumulative" datë 12.06.2023, në përmbushje të kriterëve të kualifikimit, ndërkohë që numri i punonjësve është deklaruar në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues "NRG" SHPK për skualifikimin e operatorit ekonomik "Egian Med" SHPK me argumentin, se "Në dokumentet e tenderit është kërkuar:

1.Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 39 % e vlerës së fondit limit të këtij loti. Këto shërbime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë;

- Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimet e lëshuara nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara.*
- Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen data, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara.*

Vlera e fondit limit të 3 loteve ku ka ofertuar ky OE është 80.318.684 lekë pa TVSh. Bazuar në kriterin e mësipërm të kualifikimit ky OE duhet të paraqiste dëshmi për shërbime të mëparshme të ngjashme në vlerën jo më pak se 31 324 286.76 lekë pa TVSH.

Ky OE ka dështuar në plotësimin e këtij kriteri kualifikimi pasi nuk ka paraqitur dëshmi për shërbime të ngjashme në vlerën minimale prej 31 324 286.76 lekë pa TVSH.

Provë e qartë që vërteton pretendimet tona është refuzimi I ofertës së këtij OE të paraqitur në Lotin 4 – me objekt: “Shërbim dezinfektimi në zonat bregdetar dhe urbane, Qarku Durrës”.

Sa më sipër oferta e këtij operatori ekonomik duhet të skualifikohet për mospërbushjen e këtij kriteri kualifikimi.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.4.1. Në dokumentet e tenderit, shtojca 8, “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, për Lotin 5, “Kapacitetin teknik”, pika 2.3.1, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më pak se 39% e vlerës së fondit limit të Lotit 5**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara.
- b) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara.

Shënim: Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike – financiare (nënpika 1 e seksionit 2.2, të kriterëve të veçanta për kualifikim) si dhe kapacitetet teknike (nënpikat 1), të kriterëve të veçanta për kualifikim), sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku. Në këtë rast, operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të paraqesë një deklaratë ku të listohen dokumentet e paraqitura në përmbushje të kriterëve kumulative për Lotin konkret. Në rast se dokumentacioni i deklaruar dhe i dorëzuar në përmbushje të kriterëve kumulative nuk plotëson kapacitetet ekonomike - financiare dhe kapacitetet teknike për të gjitha Lotet ku operatori ekonomik ka ofertuar, do të kualifikohet vetëm në atë Lot ku oferta e tij është ekonomikisht më e favorshme.

III.4.2. Në shtojcën e publikuar nga autoriteti kontraktor për modifikimin e dokumentave të tenderit, për Lotin 5, **“Në Shtojcën 8 “Formular I Kriterëve Të Përzgjedhjes/Kualifikimit” seksioni 2.3 “Kapaciteti teknik” në Dokumenteve të Tenderit”**, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

ISHTE

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të Kontratës, në vlerën jo

më pak se 39% e vlerës së fondit limit të këtij loti. Këto shërbime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si me poshtë:

- Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimet e lëshuara nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, **ose/dhe** faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasinë e shërbimeve të realizuara.
- Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasinë e shërbimeve të realizuara.

- **BËHET**

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të Kontratës, në vlerën jo më pak se 39% e vlerës së fondit limit të këtij loti. Këto shërbime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si me poshtë:

- Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimet e lëshuara nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, **ose** faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasinë e shërbimeve të realizuara.
- Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasinë e shërbimeve të realizuara.

III.4.2. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (S.P.E.) për plotësimin e kriterit të mësipërm, operatori ekonomik ankimes “Egjan Med” SHPK ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Vërtetim realizim kontrate gjatë vitit 2020, me nr.2874 prot., datë 06.07.2022, lëshuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, për realizimin e kontratës me vlerë 99.840 lekë pa Tvsh.
- Vërtetim realizim kontrate nr.468 prot., datë 14.07.2022, lëshuar nga Qendra Shëndetësore e Specialiteteve Nr.1 Tiranë, për realizimin e kontratës me objekt “Dezinfektim, Dezinspektim dhe Deratizim dhe i ambjenteve Shëndetësore të Specialiteteve nr.1”, për vitin 2020 me vlerë 94 800 dhe për vitin 2021 me vlerë 94 920 pa tvsh.
- Vërtetim realizim kontrate nr.95 prot., datë 18.07.2022, lëshuar nga Qendra Shëndetësore Farkë Tiranë, për realizimin e kontratës me objekt shërbimin e Dezinfektim, Deratizim dhe Dezinspektim të ambjenteve të Qendrës Farkë”, me vlerë 99 780, sipas faturës nr.97 datë 20.03.2020
- Vërtetim realizim kontrate nr.4151 prot., datë 17.06.2022, lëshuar nga Bashkia Kukës, për realizimin e kontratës nr.127 datë 01.10.2021 me objekt “Shërbim i dezinfektimit të institucioneve arsimore (DDD)”, me vlerë 289 916.67 pa tvsh.

- Vërtetim realizim kontrate nr.770 prot., datë 21.07.2022, lëshuar nga Instituti “Hurry Fultz” Tiranë, për realizimin e kontratës me objekt shërbimin e *Dezinfektimit, dhe Deratizimit dhe Dezinfektimit*, për vitin 2019 me vlerë 120 000 pa tvsh dhe për vitin 2020 me vlerë 120 000 pa tvsh sipas faturës tatimore nr.217 datë 11.05.2020.
- Vërtetim realizim kontrate nr.198 prot., datë 13.07.2022, lëshuar nga Qendra Shëndetësore Nr.7 Tiranë, për realizimin e kontratës me objekt shërbimin e *Dezinfektimit, Deratizimit dhe Dezinfektimit*, për vitin 2020:
 - ne vlera 99 960 lekë pa tvsh sipas faturës tatimore nr.121 datë 26.03.2020
 - ne vlera 98 294 lekë pa tvsh sipas faturës tatimore nr.1141 datë 11.08.2020
 - ne vlera 98 294 lekë pa tvsh sipas faturës tatimore nr.7024 datë 12.10.2020
 dhe për vitin 2021:
 - me vlerë 99 700 pa tvsh sipas faturës tatimore nr.56 datë 18.05.2021
- Vërtetim realizim kontrate nr.46 prot., datë 18.07.2022, lëshuar nga Shtëpia e të Moshuarve Kavajë, për realizimin e kontratës me objekt shërbimin e *Dezinfektimit, Deratizimit dhe Dezinfektimit*, për vitin 2020:
 - ne vlera 99 000 lekë pa tvsh sipas faturës tatimore nr.348 datë 18.06.2020
 - ne vlera 99 600 lekë pa tvsh sipas faturës tatimore nr.06 datë 20.01.2020
 dhe për vitin 2022:
 - me vlerë 99 600 pa tvsh sipas faturës tatimore nr.10 datë 25.01.2022
- Vërtetim realizim kontrate nr.1145 prot., datë 17.05.2022, lëshuar Drejtoria e Spitalit Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë, për realizimin e kontratës me objekt “Shërbimin e *Dezinfektimit 3D*” ne vlera 358 799 lekë me tvsh sipas faturës tatimore nr.469 datë 05.03.2020
- Vërtetim realizim kontrate nr.269/10 prot., datë 20.11.2020, lëshuar nga Agjencia për Administrimin e Tregjeve, për realizimin e kontratës me objekt “Dizinfektimin e hapësirave publike të tregjeve publike, në kuadër të masave kundër përhapjes së Covid19” me vlerë 689 000 pa tvsh.
- Vërtetim realizim kontrate nr.38/18 prot., datë 15.06.2022, lëshuar nga Spitali Universitar Shefqet Ndroqi, për realizimin e kontratës me objekt “Deratizim *Dezinsektim, dhe dezinfektim*” me vlerë 320 000 pa tvsh, përgjatë vitit 2021;
- Vërtetim realizim kontrate nr.1785/1 prot., datë 20.06.2022, lëshuar nga Universiteti i Tiranës, për realizimin e kontratës me objekt “Shërbime dezinfektimi për mbrojtje nga Covid-19” me vlerë 953 552 me tvsh, sipas minikontratës nr 2451/59 datë 06.12.2021;
- Vërtetim realizim kontrate nr.391 prot., datë 22.07.2022, lëshuar nga Qendra Shëndetësore Nr.8 Tiranë, për realizimin e kontratës me objekt shërbimin e *Dezinfektimit, Deratizimit dhe Dezinfektimit të ambienteve të Qendra Shëndetësore Nr.8 si dhe blerjen e medikamenteve*”, për vitin 2020:
 - ne vlera 16 720 lekë pa tvsh sipas faturës tatimore nr.32/1 datë 12.03.2020
 - ne vlera 81 000 lekë pa tvsh sipas faturës tatimore nr.52 datë 20.03.2020
 - ne vlera 43 368 lekë pa tvsh sipas faturës tatimore nr.164 datë 08.04.2020
 dhe për vitin 2021:
 - me vlerë 98 755 pa tvsh sipas faturës tatimore nr.49 datë 11.05.2021

- Vërtetim realizim kontrate nr.6802/1 prot., datë 01.11.2022, lëshuar nga Bashkia Bulqizë, për realizimin e kontratës me objekt “Klor lëng dhe Klor pluhur” me vlerë 99890 pa tvsh, sipas faturës nr 39 datë 17.03.2020;
- Vërtetim realizim kontrate nr.266 prot., datë 13.07.2022, lëshuar nga Qendra Shëndetësore Nr.3, për realizimin e kontratës me objekt “Shërbim dezinfektimi DDD” me vlerë 98 940 lekë pa tvsh, sipas faturës nr 38 datë 26.04.2021; dhe gjatë vitit 2022 në vlerën 99 250 lekë pa tvsh sipas faturës nr 42 datë 15.04.2022;
- Vërtetim realizim kontrate nr.17391/1 prot., datë 30.06.2022, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, për realizimin e shërbimit me objekt “Shërbim dezinfektim antiviral, antibakterial” me vlerë 72 000 pa tvsh, sipas faturës nr 114 datë 25.03.2020; me objekt “Shërbim dezinfektimi” me vlerën 99200 lekë pa tvsh sipas faturës nr.7044 datë 26.10.2020; me objekt “Shërbim dezinfektimi ddd” me vlerën 41660 lekë pa tvsh sipas faturës nr.147/2021 datë 27.09.2021; (bashkëlidhur faturat);
- Vërtetim realizim kontrate nr.264 prot., datë 13.07.2022, lëshuar nga Qendra Shëndetësore Nr.9, për realizimin e kontratës me objekt “Shërbimin e dezinfektimit, deratizimit dhe dezinfektimit të ambienteve” me vlerë 98 600 lekë pa tvsh, sipas faturës nr 47/1 datë 18.03.2020; dhe gjatë vitit 2021 në vlerën 99 450 lekë pa tvsh sipas faturës nr 106 datë 09.08.2021;
- Vërtetim realizim kontrate nr.123/1 prot., datë 07.07.2022, lëshuar nga Qendra Shëndetësore Shkozë, për realizimin e shërbimit dezinfektimit DDD të ambienteve, me vlerë 58 200 lekë pa tvsh, sipas faturës nr 227 datë 18.05.2020; dhe gjatë vitit 2021 në vlerën 46 080 lekë pa tvsh sipas faturës nr 61 datë 28.05.2021;
- Vërtetim realizim kontrate nr.116 prot., datë 30.06.2022, lëshuar nga Qendra Shëndetësore Shijak, për realizimin e shërbimit me objekt “Shërbimin e dezinfektimit, dezinfektimit dhe deratizimit të ambienteve” me vlerë 49 370 lekë pa tvsh, sipas faturës nr 7039 datë 22.10.2020; dhe gjatë vitit 2021 në vlerën 49 370 lekë pa tvsh sipas faturës nr 169 datë 18.10.2021
- Vërtetim realizim kontrate nr.482 prot., datë 30.06.2022, lëshuar nga Qendra Shëndetësore nr 10, për realizimin e shërbimit me objekt “Shërbimin e dezinfektimit, dezinfektimit dhe deratizimit të ambienteve” për vitin 2020 me vlerë 99 000 lekë pa tvsh; për vitin 2021 në vlerën 99 510 lekë pa tvsh; për vitin 2022 me vlerë 99 800 lekë pa tvsh;
- Vërtetim realizim kontrate nr.56 prot., datë 15.07.2022, lëshuar nga Qendra Shëndetësore Dajt, për realizimin e shërbimit me objekt “Shërbimin e dezinfektimit, dezinfektimit dhe deratizimit” për vitin 2020 me vlerë 45 600 lekë pa tvsh, sipas faturës nr 250 datë 26.05.2020, në vlerën 24 500 pa tvsh sipas faturës nr.1127 datë 01.08.2020; dhe gjatë vitit 2021 në vlerën 28 950 lekë pa tvsh sipas faturës nr 66 datë 03.06.2021;
- Vërtetim realizim kontrate nr.189 prot., datë 12.07.2022, lëshuar nga Qendra Shëndetësore Fushë Krujë, për realizimin e shërbimit me objekt “Shërbimin e dezinfektimit, deratizimit dhe dezinfektimit” për vitin 2020 me vlerë 83 300 lekë pa tvsh, sipas faturës nr 22 datë 11.03.2020; për vitin 2021 në vlerën 82 920 pa tvsh sipas faturës nr.50 datë 08.05.2021; dhe gjatë vitit 2022 në vlerën 83 220 lekë pa tvsh sipas faturës nr 50 datë 20.04.2022;
- Vërtetim realizim kontrate nr.119 prot., datë 13.07.2022, lëshuar nga Qendra Shëndetësore Kodër Kamëz, për realizimin e shërbimit me objekt “Shërbimin e dezinfektimit,

- dezinfektimit dhe deratizimit” për vitin 2020 me vlerë 83 100 lekë pa tvsh, sipas faturës nr 49 datë 18.03.2020, në vlerën 99 900 pa tvsh sipas faturës nr.4080 datë 30.12.2020, në vlerën 79 200 pa tvsh sipas faturës nr.7082 datë 05.12.2020; dhe gjatë vitit 2021 në vlerën 99 600 lekë pa tvsh sipas faturës nr 58 datë 22.05.2021;
- Vërtetim realizim kontrate nr.219 prot., datë 28.06.2022, lëshuar nga Qendra Shëndetësore Nr.4, për realizimin e shërbimit me objekt “Shërbimin e dezinfektimit DDD” për vitin 2020 me vlerë 99 300 lekë pa tvsh, sipas faturës nr 149 datë 07.04.2020; gjatë vitit 2021 në vlerën 99 400 lekë pa tvsh sipas faturës nr 41 datë 29.04.2021; dhe për vitin 2022 në vlerën 99 400 lekë pa tvsh sipas faturës nr 49 datë 19.04.2021;
 - Vërtetim realizim shërbimi nr.283 prot., datë 02.07.2022, lëshuar nga Qendra Shëndetësore Nr.6, për realizimin e shërbimit me objekt “Shërbimin e dezinfektimit DDD” për vitin 2020 me vlerë 93 000 lekë pa tvsh, sipas faturës nr 84/1 datë 18.03.2020, me vlerë 93 000 lekë pa tvsh, sipas faturës nr 1140 datë 11.08.2020, me vlerë 93 000 lekë pa tvsh, sipas faturës nr 7023 datë 12.10.2020; gjatë vitit 2021 në vlerën 99 600 lekë pa tvsh sipas faturës nr 53 datë 10.05.2021; dhe për vitin 2022 në vlerën 99 600 lekë pa tvsh sipas faturës nr 28 datë 15.03.2021;
 - Vërtetim realizim shërbimi nr.68 prot., datë 12.07.2022, lëshuar nga Qendra Shëndetësore Sauk, për realizimin e shërbimit me objekt “Shërbimin e dezinfektimit të ambienteve” me vlerë 93 000 lekë pa tvsh;
 - Vërtetim realizim shërbimi nr.265/6 prot., datë 07.03.2022, lëshuar nga AKEP, për realizimin e shërbimit me objekt “Shpenzime për dizinfektimin e ambienteve të punës në institucionin AKEP” me vlerë 418.800 lekë me tvsh;
 - Vërtetim realizim shërbimi nr.991/1 prot., datë 08.03.2022, lëshuar nga Autoriteti i Mediave Audiovizive, për realizimin e kontratës me objekt “Shërbim i dezinfektimit të ambienteve të AMA-s për parandalimin e përhapjes së COVID-19 për vitin 2021” me vlerë 777.600 lekë me tvsh;
 - Vërtetim realizim kontrate nr.157 prot., datë 24.02.2022, lëshuar nga Drejtoria e Shërbimit Spitalor Krujë, për realizimin e shërbimit me objekt “Dezinfektim Deratizim dhe dezinfektim” me vlerë 347 800 lekë me tvsh;
 - Vërtetim realizim shërbimi nr.480 prot., datë 25.05.2022, lëshuar nga Spitali Rajonal Lezhë, për realizimin e shërbimit me objekt “Shërbim Dezinfektim Deratizim dhe dezinfektim” për vitin 2021 me vlerë 690 000 lekë pa tvsh;
 - Vërtetim realizim shërbimi nr.593/1 prot., datë 14.07.2022, lëshuar nga Rezidenca studentore universitare nr.1 sha, për realizimin e shërbimit me objekt “Dezinfektim i godinave dhe administratës me Virocid” me vlerë 100 000 lekë pa tvsh, sipas faturës tatimore nr. 70 datë 04.03.2020
 - Vërtetim realizim shërbimi nr.140/1 prot., datë 29.06.2022, lëshuar nga Shërbimi Informativ i Shtetit, për realizimin e kontratës me objekt “Deratizim, dezinfektim dhe dezinfektim i ambienteve të SHISH” me vlerë 202 800 lekë me tvsh;
 - Formular vlerësimi, lëshuar nga Shkolla e Mesme Hoteleri Turizëm Tiranë, për realizimin e kontratës me objekt “Shërbim i dezinfektimit”, fillim i kontratës në datë 20.03.2020 dhe mbarimi në datë 30.12.2020, me vlerë 149 500 lekë pa tvsh;

- Formular vlerësimi, lëshuar nga Shkolla e Mesme Hoteleri Turizëm Tiranë, për realizimin e kontratës me objekt “Shërbim i dezinfektimit”, fillim i kontratës në datë 17.01.2022 dhe mbarimi në datë 31.03.2022, me vlerë 99 000 lekë pa tvsh;
- Vërtetim realizim shërbimi datë 30.06.2022, lëshuar nga Qendra Spitalore Xhaferr Kongoli Elbasan, për realizimin e kontratës me objekt “Shërbim dezinfektimi i ambienteve spitalore” me vlerë 118 800 lekë për kontratën e lidhur në datë 28.02.2020.
- Vërtetim realizim shërbimi nr.2818/1 prot., datë 26.07.2022, lëshuar nga Autoriteti i Mediave Audiovizive, për realizimin e kontratës me objekt “Shërbim i dezinfektimit të ambienteve të AMA-s për parandalimin e përhapjes së COVID-19 për periudhën Gusht – Dhjetor 2020” me vlerë 334 800 lekë me tvsh;
- Formular vlerësimi, lëshuar nga Bashkia Sarandë, për realizimin e kontratës me objekt “Shërbim i dezinfektimit DDD”, fillim i kontratës në datë 05.08.2020 dhe mbarimi në datë 04.08.2021, me vlerë 1 430 943 lekë me tvsh
- Vërtetim realizim shërbimi nr.1107 prot., datë 22.07.2022, lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Kukës , për realizimin e shërbimit të dezinfektimit për vitin 2020, në vlerën 118 800 me tvsh sipas Urdhër prokurimit nr.08 datë 24.04.2020, në vlerën 28 800 me Tvsh sipas Urdhër prokurimit nr.23 datë 18.08.2020, në vlerën 51 420 me Tvsh sipas Urdhër prokurimit nr.29 datë 07.12.2020
- Vërtetim realizim shërbimi nr.1212 prot., datë 30.07.2022, lëshuar nga Federata Shqiptare e Futbollit, për realizimin e shërbimit të dezinfektimit deratizimit dhe dezinfektimit të ambienteve të Federatës Shqiptare të futbollit gjatë vitit 2021 dhe vitit 2022. Për vitin 2021 në vlerë 488 760 lekë me tvsh dhe për vitin 2022 në vlerë 46 800 lekë me Tvsh.
- Vërtetim realizim shërbimi nr.1229/1 prot., datë 17.06.2022, lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe shërbimeve Shoqërore, për realizimin e shërbimit me objekt “DDD – Dezinfektues, dezinfektues Deratizues” për vitin 2021, me vlerë 283 351 lekë pa tvsh;
- Vërtetim realizim shërbimi nr.2006/1 prot., datë 17.06.2022, lëshuar nga Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, për realizimin e shërbimit dezinfektimit dhe higjienizimit sipas dy kontratave (në vërtetim realizimi nuk janë pasqyruar vlera e shërbimit);
- Vërtetim realizim shërbimi nr.2515 prot., datë 23.06.2022, lëshuar nga Bashkia Gramsh, për realizimin e shërbimit dezinfektimit të ambienteve të shkolave për vitin 2021, sipas faturës bashkelidhur me nr.175/2021 datë 27.10.2021 me vlerë 199 000 lekë pa tvsh;
- Vërtetim realizim shërbimi nr.12982/1 prot., datë 04.07.2022, lëshuar nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, për realizimin e shërbimit dezinfektimit datë 06.04.2020 me vlerë 61 650 pa tvsh, datë 11.04.2020 me vlerë 61 650 lekë pa tvsh, datë 02.06.2020 me vlerë 61 650 pa tvsh, datë 19.06.2020 me vlerë 51 375 lekë pa tvsh, datë 20.07.2020 me vlerë 61 650 lekë pa tvsh;
- Vërtetim realizim shërbimi nr.51/13 prot., datë 12.02.2021, lëshuar nga Agjencia për Administrimin e Tregjeve, për realizimin e shërbimit dezinfektimit për vitin 2021, me vlerë 778 000 lekë pa tvsh;
- Vërtetim realizim shërbimi nr.526/1 prot., datë 17.06.2022, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale, për realizimin e shërbimit me objekt “Blerje materiale për pastrim dhe dezinfektim, sterilizim i mjediseve të DPPI”, dezinfektimit për vitin 2021, me vlerë 302 080 lekë pa tvsh;

- Vërtetim realizim shërbimi nr.1180/1 prot., datë 06.07.2022, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme Detare, për realizimin e shërbimit me objekt “Sherbim dezinfektim”, sipas faturës tatimore me nr. 185/1, datë 26.04.2020 me vlerë 99 200 lekë pa tvsh;
- Vërtetim realizim shërbimi nr.657/1 prot., datë 06.07.2022, lëshuar nga Drejtoria Spitalore Kavajë, për realizimin e shërbimit me objekt “Sherbim dezinfektim”, me vlerë 99 550 lekë pa tvsh;
- Vërtetim realizim shërbimi nr.286/1 prot., datë 05.07.2022, lëshuar nga Enti Rregullator i Sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura, për realizimin e shërbimit me objekt “Sherbim dezinfektim”, për vitin 2019 me vlerë 98 509 lekë pa tvsh, dhe për vitin 2020 me vlerë totale 299 268 lekë pa tvsh;
- Vërtetim realizim shërbimi nr.3598/1 prot., datë 06.07.2022, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, për realizimin e shërbimit me objekt “Sherbim dezinfektim”, me vlerë 199 000 lekë pa tvsh (nuk pasqyrohet data e realizimit të shërbimit);
- Vërtetim realizim shërbimi nr.11686/1 prot., datë 20.06.2022, lëshuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, për realizimin e shërbimit me objekt “Sherbim dezinfektim”, datë 13.03.2020 me vlerë 800 000 lekë pa tvsh dhe datë 20.08.2021 me vlerë 139 000 lekë pa tvsh;
- Vërtetim realizim shërbimi nr.579 prot., datë 16.06.2022, lëshuar nga Drejtoria Spitalore Sarandë, për realizimin e shërbimit me objekt “Sherbim dezinfektim DDD”, me vlerë 800 lekë pa tvsh, sipas kontratës nr. 439 datë 24.03.2020;

Nr	NR FATURE	DATA
1	1	04.01.2021
2	1	13.01.2022
3	1	07.01.2023
4	2	13.01.2022
5	2	16.01.2023
6	3	15.01.2022
7	3	23.01.2023
8	4	21.01.2021
9	4	15.01.2022
10	4	24.01.2023
11	5	21.01.2021
12	5	19.01.2022
13	5	02.02.2023
14	6	28.01.2021
15	6	19.01.2022
16	6	06.02.2023
17	7	19.01.2022
18	7	06.02.2023
19	8	11.02.2021
20	8	24.01.2022

21	8	10.02.2023
22	9	24.01.2022
23	9	13.02.2023
24	10	16.02.2021
25	10	30.01.2021
26	10	25.01.2022
27	10	14.02.2023
28	11	30.01.2021
29	11	25.01.2022
30	11	15.02.2023
31	12	01.02.2022
32	12	15.02.2023
33	13	01.02.2021
34	13	01.02.2022
35	13	20.02.2023
36	14	01.02.2021
37	14	24.02.2021
38	14	01.02.2022
39	14	01.03.2023
40	15	21.02.2022
41	16	01.02.2021
42	16	23.02.2022
43	16	01.03.2023
44	18	03.03.2021
45	18	02.03.2022
46	18	03.03.2023
47	19	02.02.2021
48	19	02.03.2022
49	20	08.02.2021
50	20	02.03.2022
51	21	08.02.2021
52	21	24.03.2021
53	21	02.03.2022
54	21	10.03.2023
55	22	02.03.2022
56	22	13.03.2023
57	23	08.02.2021
58	23	02.03.2022
59	23	20.03.2023
60	24	08.02.2021
61	24	02.03.2022
62	24	20.03.2023

63	25	28.02.2021
64	25	03.03.2022
65	25	21.03.2023
66	26	28.08.2021
67	26	23.03.2023
68	27	28.02.2021
69	27	27.03.2023
70	28	15.03.2022
71	28	27.03.2023
72	29	16.03.2022
73	29	27.03.2023
74	30	28.02.2021
75	30	27.03.2023
76	31	28.02.2021
77	31	28.03.2023
78	32	28.02.2021
79	32	29.03.2022
80	33	01.03.2021
81	33	31.03.2022
82	33	30.03.2023
83	34	04.04.2023
84	35	05.03.2021
85	35	04.04.2022
86	35	05.04.2023
87	36	06.03.2021
88	36	07.04.2023
89	37	08.03.2021
90	37	07.04.2022
91	37	07.04.2023
92	38	08.04.2023
93	39	17.03.2020
94	39	09.03.2021
95	39	11.04.2022
96	39	12.04.2023
97	42	15.04.2022
98	43	12.03.2021
99	44	22.03.2021
100	44	19.04.2022
101	45	22.03.2021
102	45	19.04.2022
103	46	26.03.2021
104	46	19.04.2022
105	47	26.03.2021

106	47	19.04.2022
107	48	19.04.2022
108	49	06.05.2021
109	49	30.03.2021
110	49	19.04.2022
111	50	06.05.2021
112	50	20.04.2022
113	52	30.03.2021
114	52	05.05.2022
115	53	10.05.2021
116	53	06.05.2022
117	54	30.03.2021
118	56	18.05.2021
119	57	10.05.2022
120	58	22.05.2021
121	58	10.05.2022
122	59	22.05.2021
123	59	13.05.2022
124	61	28.05.2021
125	61	16.05.2022
126	62	31.05.2021
127	62	20.05.2022
128	63	31.05.2021
129	63	20.05.2022
130	64	23.05.2022
131	66	03.06.2021
132	67	26.05.2022
133	68	25.05.2021
134	68	28.05.2021
135	68	27.05.2022
136	69	28.05.2021
137	69	30.05.2022
138	70	25.05.2021

139	70	28.05.2021
140	71	21.06.2021
141	72	31.05.2021
142	74	31.05.2022
143	75	01.06.2021
144	75	31.05.2022
145	76	17.06.2021
146	76	31.05.2022
147	77	35.06.2021
148	80	30.06.2021
149	80	07.06.2022
150	81	30.06.2021
151	82	13.06.2022
152	83	30.06.2021
153	83	16.06.2022
154	85	18.06.2022
155	86	20.06.2022
156	87	20.06.2022
157	88	21.06.2022
158	89	21.06.2022
159	90	22.06.2022
160	91	22.06.2022
161	92	29.06.2022
162	93	30.06.2022
163	94	30.06.2022
164	95	05.07.2022
165	97	07.07.2022
166	98	07.07.2022
167	100	15.07.2022
168	101	18.07.2022
169	102	18.07.2022
170	103	03.08.2021
171	103	20.07.2022

172	104	03.08.2021
173	105	03.08.2021
174	106	09.08.2021
175	106	25.07.2022
176	107	09.08.2021
177	107	09.08.2021
178	107	25.07.2022
179	108	09.08.2021
180	108	25.07.2022
181	109	10.08.2021
182	109	29.07.2022
183	112	31.07.2022
184	114	03.09.2021
185	114	08.09.2021
186	114	31.07.2022
187	115	31.07.2022
188	116	02.08.2022
189	117	26.08.2021
190	117	03.08.2022
191	118	31.08.2021
192	119	31.08.2021
193	120	31.08.2021
194	120	08.08.2022
195	121	31.08.2021
196	121	10.08.2022
197	122	31.08.2021
198	122	11.08.2022
199	123	31.08.2021
200	123	12.08.2022
201	124	31.08.2021
202	124	12.08.2022
203	125	31.08.2021
204	126	31.08.2021

205	126	16.08.2022
206	127	31.08.2021
207	127	16.08.2022
208	128	16.08.2022
209	129	03.09.2021
210	129	16.08.2022
211	130	01.09.2021
212	132	22.08.2022
213	133	16.09.2021
214	133	30.08.2022
215	134	06.09.2021
216	134	30.08.2022
217	135	06.10.2021
218	135	30.08.2022
219	136	09.09.2021
220	136	30.08.2022
221	137	09.09.2021
222	137	30.08.2022
223	138	14.09.2021
224	138	30.08.2022
225	142	30.08.2022
226	143	07.09.2022
227	144	07.09.2022
228	145	09.09.2022
229	146	09.09.2022
230	147	27.09.2021
231	147	09.09.2022
232	149	19.09.2022
233	150	06.10.2021
234	150	20.09.2022
235	151	06.10.2021
236	151	27.09.2022
237	152	06.10.2021

238	153	06.10.2021
239	153	29.09.2022
240	155	05.10.2021
241	157	10.10.2022
242	158	10.10.2022
243	161	12.10.2021
244	162	12.10.2021
245	162	22.10.2022
246	163	29.10.2022
247	165	01.11.2022
248	166	07.11.2022
249	167	15.10.2021
250	167	08.11.2022
251	168	15.10.2021
252	168	09.11.2022
253	169	18.10.2021
254	169	09.11.2022
255	170	19.10.2021
256	170	14.11.2022
257	172	20.10.2021
258	173	20.10.2021
259	173	30.11.2022
260	174	22.10.2021
261	175	27.10.2021
262	175	01.12.2022
263	176	27.10.2021
264	177	29.10.2021
265	178	02.12.2022
266	179	29.10.2021
267	180	29.10.2021
268	183	03.12.2022
269	184	05.12.2022
270	185	5/12/2022

271	188	09.12.2022
272	189	12.12.2022
273	190	14/12/2022
274	193	17.12.2022
275	194	17.12.2022
276	195	17.12.2022
277	196	17.12.2022
278	197	17.12.2022
279	198	17.12.2022
280	199	21.12.2022
281	200	21.12.2022
282	203	04.05.2020
283	204	04.05.2020
284	204	23.12.2022
285	205	04.05.2020
286	206	04.05.2020
287	208	04.05.2020
288	208	24.12.2022
289	209	04.05.2020
290	209	27.12.2022
291	211	05.05.2020
292	211	27.12.2022
293	212	07.05.2020
294	212	05.05.2020
295	213	28.12.2022
296	214	07.05.2020
297	214	28.12.2022
298	215	08.05.2020
299	215	08.05.2020
300	215	19.12.2022
301	216	29.12.2022
302	217	11.05.2020
303	217	29.12.2022

304	218	29/12/2022
305	219	11.05.2020
306	219	30.12.2022
307	220	30.12.2022
308	221	13.05.2020
309	221	30/12/2022
310	222	15.05.2020
311	224	18.05.2020
312	225	18.05.2020
313	227	12.05.2020
314	248	26.05.2020
315	250	26.05.2020
316	253	28.05.2020
317	254	30.05.2020
318	255	30.05.2020
319	256	30.05.2020
320	257	30.05.2020
321	258	30.05.2020
322	259	30.05.2020
323	260	30.05.2020
324	261	30.05.2020
325	269	02.06.2020
326	348	18.06.2020
327	352	15.06.2020
328	353	17.06.2020
329	354	19.06.2020
330	355	20.06.2020
331	356	22.06.2020
332	357	22.06.2020
333	358	22.06.2020
334	1102	01.07.2020
335	1103	01.07.2020
336	1106	20.07.2020

337	1107	21.07.2020
338	1110	23.07.2020
339	1111	24.07.2020
340	1114	27.07.2020
341	1115	27.07.2020
342	1116	27.07.2020
343	1117	27.07.2020
344	1120	29.07.2020
345	1121	29.07.2020
346	1122	29.07.2020
347	1123	29.07.2020
348	1124	30.07.2020
349	1125	30.07.2020
350	1127	01.08.2020
351	1128	03.08.2020
352	1129	04.8.2020
353	1130	05.08.2020
354	1131	05.08.2020
355	1132	05.08.2020
356	1133	05.08.2020
357	1137	10.08.2020
358	1138	10.08.2020
359	1140	11.08.2020
360	1141	11.08.2020
361	1143	12.08.2020
362	1146	14.08.2020
363	1147	14.08.2020
364	1148	15.08.2020
365	1149	17.08.2020
366	1150	18.08.2020
367	1151	01.08.2020
368	1152	01.08.2020

369	1153	18.08.2020
370	1163	28.08.2020
371	1164	28.08.2020
372	1165	31.08.2020
373	1166	31.08.2020
374	1167	31.08.2020
375	1168	31.08.2020
376	1169	31.08.2020
377	1171	31.08.2020
378	1172	31.08.2020
379	4009	30.10.2020
380	4011	30.10.2020
381	4013	31.10.2020
382	4014	31.10.2020
383	4015	31.10.2020
384	4053	17.12.2020
385	4054	17.12.2020
386	4056	18.12.2020
387	4057	21.12.2020
388	4059	21.12.2020
389	4060	21.12.2020
390	4065	24.12.2020
391	4068	24.12.2020
392	4071	28.12.2020
393	4073	29.12.2020
394	4074	29.12.2020
395	4077	30.12.2020
396	4080	30.12.2020
397	4082	31.12.2020
398	4083	31.12.2020
399	4084	31.12.2020
400	4085	31.12.2020

401	4086	31.12.2020
402	4087	31.12.2020
403	4088	31.12.2020
404	6110	02.06.2020
405	6111	02.06.2020
406	6112	02.06.2020
407	6120	29.06.2020
408	6121	29.06.2020
409	6122	29.06.2020
410	6123	29.06.2020
411	6125	29.06.2020
412	6126	9.06.2020
413	6127	29.06.2020
414	6128	29.06.2020
415	6133	02.07.2020
416	6134	03.07.2020
417	6135	03.07.2020
418	6136	03.07.2020
419	6137	04.07.2020
420	6138	04.07.2020
421	6139	06.07.2020
422	6141	06.07.2020
423	6142	06.07.2020
424	6143	06.07.2020
425	6146	08.07.2020
426	6148	14.07.2020
427	6149	18.07.2020
428	7001	31.08.2020
429	7011	01.10.2020
430	7012	02.10.2020
431	7016	08.10.2020
432	7017	09.10.2020

433	7019	22.10.2020
434	7022	13.10.2020
435	7023	12.10.2020
436	7024	12.10.2020
437	7038	22.10.2020
438	7039	22.10.2020
439	7040	23.10.2020
440	7044	26.10.2020
441	7046	26.10.2020
442	7050	27.10.2020
443	7076	01.12.2020
444	7077	01.12.2020
445	7080	06.12.2020
446	7081	05.12.2020
447	7082	05.12.2020
448	7088	08.12.2020
449	7089	08.12.2020
450	7090	08.12.2020
451	7093	09.12.2020
452	203/1	04.05.2020
453	208/1	04.05.2020
454	220/1	11.05.2020
455	221/1	14.05.2020
456	48/1	30.03.2021

III.4.3. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Ndërkohe në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”*

III.4.4. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikon shprehimisht se: *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

III.4.5. Neni 39 “Ndarja e kontratave në lote”, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë të japë një kontratë në formën e loteve të veçanta, duke përcaktuar madhësinë dhe objektin e këtyre loteve.

Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.

2. Autoriteti ose enti kontraktor përcakton në njoftimin e kontratës, në ftesën për shprehje interesi ose kur thirrja për konkurrim bëhet përmes njoftimit për ekzistencën e një sistemi kualifikimi, në ftesën për ofertë ose për të negociuar, nëse ofertat mund të dorëzohen për një, për disa ose për të gjitha lotet.

Edhe kur ofertat mund të dorëzohen për disa ose të gjitha lotet, autoriteti ose enti kontraktor mund të kufizojë numrin e loteve që mund t'i jepen një ofertuesi, nëse numri maksimal i loteve për ofertues deklarohet në njoftimin e kontratës, në ftesën për shprehje interesi, në ftesën për ofertë ose në ftesën për të negociuar.

Kur zbatimi i kriterëve për shpalljen e kontratës fituese do të bënte që një ofertues të shpallej fitues i më shumë loteve sesa numri maksimal, autoriteti ose enti kontraktor përcakton në dokumentet e tenderit kriteret objektive dhe jodiskriminuese ose rregullat që synojnë të zbatohen për të përcaktuar lotet që do të jepen.

3. Kur të njëjtit ofertues mund t'i jepet më shumë se një lot, autoriteti ose enti kontraktor mund të japë kontrata që kombinojnë disa ose të gjitha lotet, pasi të kenë specifikuar në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi mundësinë për ta bërë këtë, dhe lotet ose grupet e loteve që mund të kombinohen.

III.4.6. Neni 41, pika 3, “Kërkesa të vecanta për kontratat e shërbimeve”, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

3. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

III.4.7. Në nenin 42 “Kontrata për punë/mall/shërbim e ndarë në lote” të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote sa herë kjo është e mundur. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve.

2. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit.

Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.

3. Kur kontratat për punë/mall/shërbim ndahet në lote, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin lot. Kërkesat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit.

4. Autoriteti/enti kontraktor përcakton në njoftimin e kontratës, në ftesën për shprehje interesi ose, kur thirrja për konkurrim bëhet përmes njoftimit për ekzistencën e një sistemi kualifikimi, në ftesën për ofertë ose për të negociuar, nëse ofertat mund të dorëzohen për një, për disa, ose për të gjitha lotet.

5. Autoriteti/enti kontraktor mund të kufizojë numrin e loteve që mund t'i jepen një ofertuesi, me kusht që numri maksimal i loteve për ofertues të deklarohet në njoftimin e kontratës, në ftesën për shprehje interesi, në ftesën për ofertë ose në ftesën për të negociuar.

6. Kur zbatimi i kriterëve për shpalljen e kontratës fituese do të bënte që një ofertues të shpallej fitues i më shumë loteve se sa numri maksimal, autoriteti/enti kontraktor përcakton në dokumentet e tenderit kriteret objektive dhe jodiskriminuese ose rregullat që synojnë të zbatohen për të përcaktuar lotet që do të jepen. Këto kriterë duhet të jenë në përputhje me LPP-në dhe me ato të përcaktuara në nenin 91 të këtyre rregullave.

7. Kur të njëjtit ofertues mund t'i jepet më shumë se një lot, autoriteti/enti kontraktor mund të japë kontrata që kombinojnë disa ose të gjitha lotet, vetëm nëse ka specifikuar më parë, në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi, mundësinë për ta bërë këtë, dhe lotet ose grupet e loteve që mund të kombinohen.

8. Autoriteti/enti kontraktor mund të përcaktojë kërkesat minimale që u kërkohen operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

9. Në çdo rast, lotet janë të organizuara si procedura të veçanta brenda një procedure. Fillimi dhe përfundimi i njërit lot nuk ndikon në lotin tjetër të procedurës.

III.4.8. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.4.9. Në nenin 77 pika 4 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” është parashikuar se: *“4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”*, KPP vlerëson se së pari, norma juridike duhet të interpretohet e më pas të gjykohet, kjo për të analizuar në thelb ratio legis, kuptimin e drejtë të saj. Kështu, ligjvënësi ka parashikuar diskrecionin e autoritetit kontraktor të kërimit të dëshmive për përvojën e mëparshme, me synim për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Pra e drejta e dhënë nga ligji lidhet ngushtësisht me garantimin e autoritetit kontraktor, se operatori ekonomik disponon dëshmi të përvojës së mëparshme për të realizuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Komisionit të Prokurimit Publik pas shqyrtimit në tërësi të dokumentacionit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi i rezulton, se procedura në fjalë është procedurë e ndarë në lote. Gjithashtu, nga verifikimi i loteve të publikuara, si dhe databazës së regjistrimit të ankesave rezulton, se operatori ekonomik ankimues “Egian Med” SHPK rezulton pjesëmarrës (ofertues) në tre Lote, në Lotin 4, në Lotin 5 dhe në Lotin 6, ku në Lotin 5 dhe 6 rezulton i kualifikuar dhe në Lotin 4 i skualifikuar. Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se operatori ekonomik ankimues “NRG” shpk, rezulton se ka paraqitur ankesë për lotet 4, 5 dhe 6 të procedurës së mësipërme të prokurimit, për rrjedhojë Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim dokumentacionin e dorëzuar nga operatori ekonomik “Egian Med” shpk në të tre lotet, ku ky i fundit ka marrë pjesë në kuadër të përmbushjes së kriterëve të vecanta të kualifikimit, dëshmisë së eksperiencës së ngjashme.

III.4.10. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, KPP konstaton, se autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit duhet të paraqesin *““Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të Kontratës, në vlerën jo më pak se 39% e vlerës së fondit limit të këtij loti. Këto shërbime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si me poshtë:*

- *Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimet e lëshuara nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasitë e shërbimeve të realizuara.*
- *Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të*

legjislacionit në fuqi dhe të deklaruar në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasitë e shërbimeve të realizuara.”

Gjithashtu, në kriteret e veçanta të kualifikimit autoriteti kontraktor ka përcaktuar shënimin “Shënim: Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike – financiare (nënpika 1 e seksionit 2.2, të kriterëve të veçanta për kualifikim) si dhe kapacitetet teknike (nënpikat 1), të kriterëve të veçanta për kualifikim), sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku. Në këtë rast, operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të paraqesë një deklaratë ku të listohen dokumentet e paraqitura në përmbushje të kriterëve kumulative për Lotin konkret. Në rast se dokumentacioni i deklaruar dhe i dorëzuar në përmbushje të kriterëve kumulative nuk plotëson kapacitetet ekonomike - financiare dhe kapacitetet teknike për të gjitha Lotet ku operatori ekonomik ka ofertuar, do të kualifikohet vetëm në atë Lot ku oferta e tij është ekonomikisht më e favorshme”.

III.4.11. Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, referuar dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Egian Med” SHPK në sistemin e prokurimeve elektronike, rezulton, se ky i fundit në të tre Lotet e ofertuar për këtë procedurë (Loti 4, Loti 5 dhe Loti 6) ka dorëzuar të njëjtin dokumentacionin në lidhje me eksperiencën e ngjashme, si për Lotin 4 edhe për Lotin 5, edhe për Lotin 6 objekt - shqyrtimi, ndërkohë që autoriteti kontraktor në dokumentet standarde të tenderit ka përcaktuar se “Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike – financiare (nënpika 1 e seksionit 2.2, të kriterëve të veçanta për kualifikim) si dhe kapacitetet teknike (nënpikat 1), të kriterëve të veçanta për kualifikim), sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku. Në këtë rast, operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të paraqesë një deklaratë ku të listohen dokumentet e paraqitura në përmbushje të kriterëve kumulative për Lotin konkret. Në rast se dokumentacioni i deklaruar dhe i dorëzuar në përmbushje të kriterëve kumulative nuk plotëson kapacitetet ekonomike - financiare dhe kapacitetet teknike për të gjitha Lotet ku operatori ekonomik ka ofertuar, do të kualifikohet vetëm në atë Lot ku oferta e tij është ekonomikisht më e favorshme.”

III.4.12. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “Egian Med” SHPK, konstatohet se ky i fundit për të përmbushur kriterin e mësipërm ka paraqitur Vërtetime realizim të kontratave më institucione shtetërore, si dhe Fatura Tatimore ku vërteton se ka kryer shërbime të mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimit me disa institucione shtetërore dhe subjekte private. Nisur nga kriteri i kualifikimit, vlera e zërave të ngjashëm duhet përlllogaritur duke mbajtur në konsideratë vlerën e të tre loteve ku operatori ekonomik "Egian Med" SHPK është pjesëmarrës. Vlen të theksojmë se në Lotin 4, operatori ekonomik "Egian Med" SHPK ka marrë pjesë si bashkim operatorësh, ndaj dhe përlllogaritja e vlerës së kontratave të ngjashme për atë lot do të përlllogaritet në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në atë lot nga operatori ekonomik "Egian Med" SHPK. Pra sa më sipër, duke qenë se operatori ekonomik "Egian Med" SHPK nga verifikimi në SPE konstatohet që ka paraqitur të njëjtin dokumentacion në lidhje me eksperiencën e e ngjashme, për Lotet ku ka marrë pjesë, KPP nga përlllogaritja e zërave të ngjashëm në dokumentacionin e paraqitur, referuar vërtetimeve të realizimit me subjektet shtetërore (duke mos përfshirë në përlllogaritje ato shërbime të cilat janë

kryer përpara periudhës tre vjecare nga momenti i publikimit të procedurës, datë 20.04.2023) si dhe faturave e paraqitura nga operatori ekonomik “Egian Med” SHPK (duke mos përfshirë në përlllogaritje ato fatura të cilat janë lëshuar përpara periudhës trevjeçare nga momenti i publikimit të procedurës, datë 20.04.2023), konstaton se këto të fundit tejkalojnë vlerën e kërkuar nga autoriteti kontraktor, ku në këtë rast referuar shënimit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor “*Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike – financiare (nënpika 1 e seksionit 2.2, të kriterëve të veçanta për kualifikim) si dhe kapacitetet teknike (nënpikat 1), të kriterëve të veçanta për kualifikim), sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku*”, duhet përlllogaritur në vlerën jo më pak se 39% e vlerës së loteve ku operatori ekonomik ka marrë pjesë.

Sa më sipër, operatori ekonomik “Egian Med” SHPK, përmbush kriterin në lidhje me eksperiencën e ngjashme në vlerën e kërkuar në kriteret e kualifikimit.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.5. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “NRG” SHPK për skualifikimin e operatorit ekonomik “Egian Med” SHPK me argumentin, se “*Në dokumentat e tenderit është kërkuar:*

1.Operatori ekonomik për kryerjen e shërbimit, objekt prokurimi duhet të ketë të punësuar staf si më poshtë:

a) 1 (një) drejtues Teknik, për drejtuesin Teknik të paraqitet:

- kontratë punë përkatëse

-Diplomë me profil agronom/shëndet publik/biologji/kimi.

b) Minimalisht 4 (katër) punonjës, për punonjësin të paraqitet:

- kontratë pune përkatëse

Numri I punonjësve për lotin objektin ankimimi është 4 (katër).

Por ky OE ashtu sikurse e theksuam edhe më sipër ka marrë pjesë në lotin me:

- Nr. Ref-66559-04-19-2023, me objekt Loti 4- me objekt: “Shërbim dezinfektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Qarku Durrës”, me fond limit 15.479.671 lekë pa TVSH ku kërkohen 2 (dy) punonjës shërbimi.

- Nr. REF-66562-04-19-2023, me objekt Loti 5- me objekt: “Shërbim dezinfektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Qarku Fier”, me fond limit 21.673.080 lekë pa TVSH ku kërkohen 2 (dy) punonjës shërbimi.

Pra kriteri kumulativ është që ky OE duhet të ketë minimum 8 (tetë) punonjës shërbimi. Duke qënë se si kriter kualifikimi është kërkuar staf për kryerjen e shërbimit, operatorët ekonomikë kishin detyrimin të paraqisnin kontratat e punës në mënyrë kumulative për aq punonjës sa kërkoheshin për lotet ki kishin ofertuar por edhe dokumentet provues (listëpagesat e muajit të fundit me kodin përkatës për punonjës shërbimi DDD ose dëshmi përkatëse për Teknik DDD). Nuk mund të quhet e vlefshme vetëm kontrata e punës me një punonjës kur nuk provohet se ai është punonjës shërbimi DDD.

Në objektin e veprimtarisë së tij OE “Egian Med” shpk ka disa aktivitete të tjera përveç shërbimit DDD por kjo nuk do të thotë që të kualifikohet duke paraqitur kontrata fictive punonjësish që nuk kanë të bëjnë me shërbimin – objekt prokurimi.

Ajo që provon se këta punonjës janë vërtetë punonjës shërbimi DDD e vërteton ose dëshmia/certifikata e specializimit si Teknik DDD ose listëpagesa e muajit të fundit me kodin korrespondues të punonjësit të shërbimit Teknik DDD.

Ky OE ka dështuar në paraqitjen e dokumentacionit provues për disponimin e 8 (tetë) punonjësve shërbimi të pajisur me certifikatë DDD ose të siguruar në listëpagesën e muajit të fundit me kodin përkatës si Teknik shërbimi DDD.

Sa më sipër oferta e këtij OE duhet të skualifikohet për mospërbushjen e këtij kriteri kualifikimi., Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.5.1. Në dokumentet e tenderit, shtojca “8, “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, për Lotin 5, “Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë”, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

[...]

Shënim: Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike – financiare (nënpika 1 e seksionit 2.2, të kriterëve të veçanta për kualifikim) si dhe kapacitetet teknike (nënpikat 1), të kriterëve të veçanta për kualifikim), sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku. Në këtë rast, operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të paraqesë një deklaratë ku të listohen dokumentet e paraqitura në përmbushje të kriterëve kumulative për Lotin konkret. Në rast se dokumentacioni i deklaruar dhe i dorëzuar në përmbushje të kriterëve kumulative nuk plotëson kapacitetet ekonomike - financiare dhe kapacitetet teknike për të gjitha Lotet ku operatori ekonomik ka ofertuar, do të kualifikohet vetëm në atë Lot ku oferta e tij është ekonomikisht më e favorshme.

III.5.2. Në shtojcën për modifikimin e dokumentave të tenderit, “Shtojcë Nr.1, datë 01.06.2023”, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

LOTI 4

➤ **SHTOHET:**

1. Operatori ekonomik për kryerjen e shërbimit, objekt prokurimi duhet të ketë te punesuar staf si me poshte:

a) **1 (një) Drejtues Teknik.** Për drejtuesin teknik te paraqitet:

- Kontrate pune me profil Agronom/Shëndet Publik/Biologji/Kimi.

b) **Minimalisht 2 (dy) punonjës.** Për punonjësin të paraqitet:

- Kontrate pune perkatese.

LOTI 5

➤ **SHTOHET:**

1. Operatori ekonomik për kryerjen e shërbimit, objekt prokurimi duhet të ketë te punesuar staf si me poshte:

a) **1 (një) Drejtues Teknik.** Për drejtuesin teknik te paraqitet:

- Kontrate pune me profil Agronom/Shëndet Publik/Biologji/Kimi.

- **Minimalisht 2 (dy) punonjës.** Për punonjësin të paraqitet:

- Kontrate pune perkatese.

- ***LOTI 6***

➤ **SHTOHET:**

6. Operatori ekonomik për kryerjen e shërbimit, objekt prokurimi duhet të ketë te punesuar staf si me poshte:

a) **1 (një) Drejtues Teknik.** Për drejtuesin teknik te paraqitet:

- Kontrate pune me profil Agronom/Shëndet Publik/Biologji/Kimi.

b) **Minimalisht 4 (katër) punonjës.** Për punonjësit te paraqitet:

- Kontrate pune perkatese.

III.5.3. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (S.P.E.) për plotësimin e kriterit të mësipërm, operatori ekonomik ankimues “Egian Med” SHPK ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ku ka deklaruar se disponon 1 drejtues teknik dhe 8 punonjës dezinfektimi.

- Deklaratë për përmbushjen e kriterëve kumulative;

III.5.4. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.5.5. Sa më sipër, referuar kriterit të mësipërm të kualifikimit, konstatohet se autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht, që *“Shënim: Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike –financiare (nënpika 1 e seksionit 2.2, të kriterëve të veçanta për kualifikim) si dhe kapacitetet teknike (nënpikat 1), të kriterëve të veçanta për kualifikim), sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku. Në këtë rast, operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të paraqesë një deklaratë ku të listohen dokumentet e paraqitura në përmbushje të kriterëve kumulative për Lotin konkret. Në rast se dokumentacioni i deklaruar dhe i dorëzuar në përmbushje të kriterëve kumulative nuk plotëson kapacitetet ekonomike -financiare dhe kapacitetet teknike për të gjitha Lotet ku operatori ekonomik ka ofertuar, do të kualifikohet vetëm në atë Lot ku oferta e tij është ekonomisht më e favorshme”*. Pra, sa më sipër, autoriteti kontraktor kërkon që, në rastin kur operatori ekonomik ofertues merr pjesë në më shumë se një Lot, atëherë ky i fundit duhet të paraqesë një deklaratë ku të listojë dokumentet e paraqitura në përmbushje të kriterëve kumulative për Lotin konkret.

III.5.6. Komisionit të Prokurimit Publik pas shqyrtimit në tërësi të dokumentacionit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi i rezultoi, se procedura në fjalë është procedurë e ndarë në lote. Gjithashtu, nga verifikimi i loteve të publikuara si dhe databazës së regjistrit të ankesave rezultoi, se operatori ekonomik ankimues “Egian Med” SHPK rezultoi pjesëmarrës në Lotin 4, në Lotin 5 dhe në Lotin 6.

Pra sa më sipër, operatori ekonomik “Egian Med” SHPK, duke qenë së është pjesëmarrës në tre lote të kësaj procedure prokurimi, duhet të deklarojë se disponon 1 drejtues teknik dhe 6 punonjës, në përmbushje të kriterit kumulativ. Në rastin konkret, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik “Egian Med” SHPK, konstatohet se ky i fundit ka dorëzuar Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ku ka listuar punonjësit që disponon për kryerjen e shërbimit, duke deklaruar 1 drejtues teknik dhe 8 punonjës, duke përmbushur kështu numrin e punonjësve për të tre lotet ku është pjesëmarrës. Vlen të theksojmë, se nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimues në lidhje me 8 punonjësit, nga verifikimi i dokumentave të tenderit, konstatohet se autoriteti kontraktor nuk ka kërkuar ndonjë kualifikim specifik për këta punonjës.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “NRG” SHPK, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-66562-04-19-2023, me objekt: Loti 5 “*Shërbim Dezinsektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Qarku Fier*”, me fond limit 21.673.080 lekë (pa Tvsh), zhvilluar në datë 13.06.2023 nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për kualifikimin e operatorit ekonomik “Egian Med” SHPK, dhe të korrigojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e skualifikuar këtë operatorë ekonomik.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. T’i propozojë Agjencisë së Prokurimit Publik nisjen e hetimit administrativ në lidhje me konstatimet në arsyetimin e vendimit të mësipërm dhe t’i dërgohet kopje e akteve të dosjes objekt - shqyrtimi.
5. T’i propozojë Rrjetit të Koordinatorëve Kundër Korrupsionit nisjen e hetimit administrativ në lidhje me konstatimet në arsyetimin e vendimit të mësipërm.
6. T’i propozojë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nisjen e hetimit administrativ në lidhje me konstatimet në arsyetimin e vendimit të mësipërm.
7. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “NRG” SHPK.
8. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
9. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Rrjetit të Koordinatorëve Kundër Korrupsionit.
10. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
11. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri